



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në  
“Informatikë Ekonomike”  
Universiteti “EPOKA”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc.Dr. Ezmolda Barolli

Prof.Asoc.Dr. Rezarta Shkurti

Qershor 2021

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Për Programin e studimit Bachelor në "Informatikë ekonomike"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "EPOKA"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrim - Biznesi (Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative)
3	Emërtimi i programit të studimit:	<b>Bachelor në Informatikë ekonomike</b>
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 175 datë 26.04.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASR Nr. 103, datë 09.03.2016
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	UMAS Nr.358, datë 25.09.2015 (Sipas VKA Nr. 52, datë 29.06.2015)
8	Cikli i studimit:	Cikli I
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	
13.1	<ul style="list-style-type: none"><li>Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):</li></ul>	-
13.2	<ul style="list-style-type: none"><li>Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):</li></ul>	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	23/6 (79% / 21%)
16	Numri i studentëve (për tre vite):	378 Studentë
17	Komente / të tjera:	

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti "EPOKA" është një institucion privat i arsimit të lartë në Shqipëri i themeluar në bazë të vendimit Nr. 281, datë 12.03.2008, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Akreditimi i parë institucional Universitetit "EPOKA" i është dhënë në zbatim të Urdhërit Nr. 260, datë 07.06.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë, bazuar në dispozitat e legjislacionit shqiptar të arsimit të lartë. Universiteti "EPOKA" ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.92, date 20.10.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 19.10.2021.

Në vitin 2016, Universiteti "EPOKA" për të siguruar përputhshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", ka hartuar një Statut të ri i cili është miratuar në bazë të Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 146, datë 31.03.2017 dhe më pas është implementuar nga organet kompetente të Universitetit.

Programi i studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike" në Universitetin "EPOKA" ofrohet nga Departamenti i Administrim Biznesit i cili është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative të këtij Institucioni.

Ky program studimi është licensuar bazuar në Urdhërin Nr. 175, datë 26.04.2012, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Më tej, në bazë të Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 358, datë 25.09.2015, ky program studimi u akreditua. Rekomandimet e dhëna në këtë proces të parë akreditimi të programit, dhe shkalla e përmbushjes së tyre analizohen nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm në faqen në vijim.


## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

### REKOMANDIMET:

- a) Institucioni të marrë masa për përmirësimin e nivelit të gjuhës angleze për një pjesë të studentëve që hasin vështirësi, përmes organizimit të kurseve të posaçme të gjuhës të nivelit të avancuar akademik.
- b) Institucioni të marrë masa për hartimin e një studimi më specifik për nevojat e tregut të punës për këtë program studimi.

### **Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni**

1. **GVJ vlerëson se rekomandimi i parë në lidhje me përmirësimin e nivelit të gjuhës angleze është përmbushur plotësisht** sepse studentët e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë të detyruar të frekuentojnë lëndën e anglishtes bazë English Core (ENG 107) e cila është lëndë e detyrueshme e vitit të parë të studimeve. Megjithatë, rekomandimi specifikon organizimin e kurseve të posaçme të nivelit të avancuar akademik. Gjithashtu, nga Plani Mësimor i Programit të Studimit vihet re se në vit të parë zhvillohet e detyrueshme edhe lënda e Anglishtes së Biznesit, Business English, (ENG 109). Pra, frekuentimi i detyrueshëm i këtyre dy lëndëve mundëson kapërcimin e vështirësive që studentë të caktuar mund të kenë në gjuhën angleze në hyrje të studimeve të tyre pranë këtij Institucioni.
2. **GVJ vlerëson se rekomandimi i dytë në lidhje me kryerjen e një studimi të plotë të nevojave të tregut punës është përmbushur plotësisht.** Referuar dokumentacionit në DVV, Institucioni ka kryer një studim të plotë në vitin 2017 (shtojca 1.1), i cili analizon nevojat dhe dinamikat e tregut, si dhe preferencat e studentëve. Për momentin ky rekomandim është i plotësuar, por GVJ sugjeron që në ardhmen të zgjerohet edhe me studimin e kërkesave dhe nevojave të punëdhënësve potenciale.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve", 2017, të ASCAL, Universiteti EPOKA, ka aplikuar për akreditimin periodik të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike".

ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Ezmolda Barolli, dhe Prof. Asoc. Rezarta Shkurti.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga Koordinatorin teknik i ASCAL, Znj. Renata Qatipi.

Pas komunikimit, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktuan datat dhe u realizua vizita në institucion, në 12 Prill 2021. Gjatë vizitës ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës. Stafit akademik dhe administrativ i Universitetit EPOKA u angazhua për t'iu përgjigjur kërkesave të grupit të jashtëm.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve dhe specialistes së ASCAL, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve /kriterëve për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.

Në fund paraqiten pikat e forta, pikat e dobëta, dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë për programin e studimit. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 28.05.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 46/8 Prot., datë 28.05.2021 "Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm", "Universiteti EPOKA" është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

"Universiteti EPOKA" përcjell përmes sistemit AMS dhe zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 55/8 Prot., datë 03.06.2021 "Komente në lidhje me Draft-RVJ të programit të studimit Bachelor në "Informatikë Ekonomike". Në këtë dokument institucioni ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet, sqaron si më poshtë:

Pas rishikimit të Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) falenderon ekspertet e jashtëm për punën serioze dhe komentet e tyre konstruktive dhe plot vlerë në këtë raport.

**Shkalla e përbushjes së rekomandimit 2 nga Institucioni**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*Për momentin ky rekomandim është i plotësuar, por GVJ sugjeron që në ardhmen të zgjerohet edhe me studimin e kërkesave dhe nevojave të punëdhënësve potencialë.*

### **Shpjegim i GVB për Komentet:**

Departamenti i Administrim Biznesit ka qene mjaft i vemendshëm për të grumbulluar informacion nëpërmjet tre strategjive: 1. Teknikes se vëzhgimit dhe intervistimit përgjatë panairit te karrieres qe zhvillohet cdo vit pranë universitetit EPOKA, ku anëtarë të departamentit kanë vizituar bizneset pjesëmarrëse në fushën e teknologjisë së informacionit dhe konsulencës duke analizuar kërkesat e tyre lidhur me burimet njerezore te nevojshme; 2. Strategjisë së pjesëmarrjes së grupeve studentore në gara te zhvilluara nga kompani të fushes

për të kuptuar se çfarë keto kompani kërkojnë dhe promovojnë; 3. Strategjisë së ftesave në leksione të hapura nga perfaqësues të biznesit për të kuptuar se çfarë nevojë kanë bizneset e tyre në fushën e informatikës së biznesit dhe me gjere. Departamenti i BUS falenderon GVJ-ne për sugjerimin.

**Përgjigje nga GVJ:** Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar si edhe në komentet e bëra nga Institucioni, vihet re se studimi i nevojave të punëmarrësve potencialë NUK është përfshirë formalisht në kërkimin e tregut, pavarësisht se mund të jetë duke u kryer në tre format e mësipërme. Bazuar në eksperiencat e mira të Institucionit, prandaj edhe GVJ po e sugjeron, pra që çfarë bëhet konkretisht, edhe të përfshihet formalisht në një raport për kërkimin e tregut ku të evidentohet si pjesë e vecantë, analiza e kërkesave dhe e nevojave të punëdhënësve potencialë. Këto të dhëna mund të jenë pranë Institucionit, por NUK gjenden në mënyrën dhe paraqitjen e kërkuar nga standardi.

**Komenti i GVB nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.**

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

**Standardi II.3 Kriteri 4**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV në pamje të parë vëren se Plani Mësimor (shtojca 2.1) NUK i përmban elementet e kërkuara. Megjithatë, në RVB (në tabelat 10 në shtojcat e tij), jepen të dhëna të kërkuara për të gjitha vitet akademike që nga 2015.*

### **Shpjegim i GVB për Komentet:**

Siç është përmendur edhe nga GVJ informacionet mbi Planin Mësimor me elementet e kërkuara janë në tabelën 10 në shtojca. Ju lutem bashkagjitur me këtë dokument (shikoni shtojcën 1, Plani Mësimor i programit Informatikë Biznesi)

**Përgjigje nga GVJ:** Plani Mësimor me elementet e nevojshme u siguroi vetëm më vonë pas vizitës në Institucion të GVJ dhe kërkesës specifike nga ana e tij. GVJ evidenton edhe njëherë që përgjegjësia e sigurimit të dokumentacionit të plotë dhe koherent, në përputhje me kërkesat ligjore dhe kriteret e standardeve është e GVB dhe duhet të ishte realizuar qysh në dorëzimin fillestar të dosjes së vlerësimit.

**Megjithatë, komenti i GVB merret parasysh dhe RVJ ndryshon dhe shtohet fraza, në standardin II.3 kriteri 4:** Pas vizitës së GVJ në Institucion, ky i fundit dorëzoi dhe u ngarkua në sistemin e ASCAL, Plani Mësimor me të gjithë elementet e kërkuara.

**Standardi II.4 Kriteri 4**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*Por, nisur edhe nga diskutimi me studentët e programit, GVJ sugjeron shtimin e gamës së lëndëve me zgjedhje të ofruara për studentët, në mënyrë që ata të përzgjedhin në bazë të interesave dhe prirjeve të tyre.*

### **Shpjegim i GVB për Komentet:**

Departamenti i Administrim Biznesit ku bën pjesë dhe programi i studimit të Informatikës Ekonomike, bën rishikime ose përmirësime të përvitshme të kurrikulës duke u bazuar në zhvillimet më të fundit të fushave përkatëse, sipas nevojave të tregut të punës si dhe në bazë të kërkesave ose interesave të studentëve. Këto ndryshime pasi aprovohen nga Komiteti Shkencor i departamentit propozohen në Dekanat dhe pastaj propozohen për në Komisionin e Kurrikulës për aprovim. Si shembull për sa më lart, gjatë vitit akademik 2019-2020 është bërë një studim konkret (ju lutem shikoni shtojcën 11 “Curricula feedback survey”), mbi nevojat e rishikimit të kurrikulës së ofruar në 3 programet e studimit të Departamentit të Administrim Biznesit mbi bazën e të cilit është përgatitur një propozim konkret për përmirësime të mundshme në kurrikulën e ofruar në këtë program studimi.

Adresa: “Rruga e Durrësit”. Nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

faqe 6

Universiteti Epoka u ofron studentëve një strukturë fleksibël në përzgjedhjen e lëndëve sipas prioriteteve të studenteve nëpërmjet 2 mënyrave:

1. Lëndëve me zgjedhje;
2. Lëndëve ekstrakurrikulare

Përsa i përket lëndëve ekstrakurrikulare, studentëve u lejoheq që të zgjedhin lëndë nga programe të tjera te Universitetit. Mund të përmendim 1 nga shumë rastet:

i. studentin e diplomuar në vitin 2018 me 186 ECTS, i cili ka marrë lëndën CRN 372 Artificial Intelligence e cila nuk ofrohet ne programin e studimit te studentit përketes por nga një program studimi tjetër në një fakultet tjetër. Kërkesa të tilla nga studentet, shqyrtohen nga Dekanati i Studentëve ne bashkërendim me departamentet përkatëse. Ju lutem shikoni bashkangjitur shtojcën 10 “Transkripti i Studentit”

**Përgjigje nga GVJ:** Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ nuk ndryshon opinionin e tij pasi ky opinion u formua nga intervistat me studentët e programit, sikurse edhe shprehemi ne Raport, dhe nuk bëhet fjalë vetëm për studentin e diplomuar në vitin 2018 që përmendet në pikën “i” më lart por ishin disa që shprehën interesa të ngjashme. Ky është opinion i ekspertëve të jashtëm, që u formua pas intervistave dhe nuk ndryshon.

**Komenti i GVB nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.**

**Standardi II.4 Kriteri 6**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*Nga shqyrtimi që GVJ i bëri programeve lëndore të dorëzuara si pjesë e DVV, konstatojmë që ky kriter i lidhur specifikisht me pasurimin e literaturës së detyruar dhe ndihmëse që të jetë e 5 viteve të fundit përbushet pjesërisht, pasi në disa raste u ndeshën edhe tekste të para pesë viteve.*

- *Statistics I & II, BUS 201 & BUS 202, e vitit 2011.*
- *Business Law, BUS 203, e viteve 2011 dhe 2013.*
- *Marketing I, BUS 221, e vitit 2011.*
- *Human Resource Management, BUS 335 e vitit 2011.*
- *Web Programming, CEN323, e vitit 2012*

*Sugjerojmë përditësim në literaturë të të gjitha lëndëve pasi që Institucioni disponon marrëveshje bashkëpunimi me shtëpi botuese prestigjioze të cilat kanë publikime cilësore të viteve të fundit për të njëjtët tituj dhe autorë.*

#### **Shpjegim i GVB për Komentet:**

Në përzgjedhjen e literaturës, personeli akademik përpiqet gjithmonë të jetë në koherencë me atë çka ofrohet së fundmi, por njëkohësisht t’iu ofrojë studentëve një material mësimor sa më të qartë e lehtësisht të kuptueshëm prej tyre, e në këtë kuadër, për një pjesë të lëndëve, pedagogët vazhdojnë të përdorin një literaturë ndoshta pak më të hershme se pesë vitet e fundit, por që i ndihmon studentët të përthithin më mirë lëndën në përputhje edhe me objektivat formuese të lëndës.

Gjithësesi, GVB e vlerëson këtë sugjerim dhe do të rishikojë literaturën e përdorur nga personeli akademik, për lëndëd e përmendura. Megjithatë theksojmë që literature në përgjithësi është e përditësuar nisur dhe nga fakti që literature akademike, bashkëkohore në gjuhën angleze përbën një nga pikat e forta të programit të studimit.

**Përgjigje nga GVJ:** Bazuar në dokumentacionin dhe shpjegimin e GVB, opinionin e GVJ nuk ndryshon. Sipas opinionit të GVJ duhet të jetë pikërisht GVB që bazuar në sugjerimet e dhëna në këtë raport, të angazhohet që Institucioni të përbushë këtë kriter për të ardhmen. Kjo është në përfitimin

maksimal të studentëve pasi kriteri dhe standardi kur janë hartuar, kanë pasur parasysh pikërisht praktikat më të mira në funksion të studentëve.

**Komenti i GVB nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.**

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

**Standardi III.6 Kriteri 3**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.*

*Procesi i organizimit të provimeve, monitorohet nga një Bord Provimesh, një strukturë kjo e ngritur në vitin 2019, për të garantuar vlerësimin sa më të saktë të studentëve. Shqyrtimi i procedurës së provimeve nga një Bord Provimesh është një formë që Institucioni synon të përdorë për të ulur riskun e provimeve. Megjithatë, fakti që provimet përgjithësisht nënshkruhen vetëm nga lektori i lëndës, bën që ky kriter të vlerësohet pjesërisht i përmbushur nga ana e GVJ.*

**Shpjegim i GVB për Komentet:**

Si pergjigje ndaj komentit të GVJ mund të themi që,

1. Universiteti Epoka ka ngritur Bordin e Provimeve, një strukturë e ngritur enkas për të sugjeruar përmirësime në procesin e provimeve dhe për të garantuar vlerësimin sa më të saktë të studentëve.
2. Cdo fakultet nominon Ekspertë Provimesh, të cilët në bashkëpunim me Bordin e Provimeve bëjnë rishikime të rastësishme të dosjeve të provimeve të ndryshme të cdo program studimi në mënyrë periodike duke përfshirë provimet Midterm dhe Final.
3. Cdo pedagog asistohet nga Stafi Akademik Mbështetës (Teaching Assistants) për të përgatitur, për të zbatuar, dhe për të korrigjuar provimet përkatëse të lëndëve të ndryshme. Ky fakt e shton transparencën dhe siguron një kontroll të dyfishtë të provimeve për një vlerësim sa më të saktë të studentëve.
4. Duke filluar nga viti akademik 2019-2020, Universiteti Epoka ka filluar implementimin e Anonimitetit të Provimeve, ku cdo studenti i alokohet një kod unik dhe i përkohshëm për cdo provim i cili garanton anonimitetin e tij ndaj korrigjuesit të provimeve përkatëse. Ky është një hap tjetër i ndërmarrë në kuadër të garantimit të vlerësimit sa më të saktë të studentëve
5. Në vazhdimësi si më lart, Universiteti Epoka ka një numër të limituar të studentëve për cdo program studimi si rrjedhojë nuk aplikon praktikën e katedrës për lëndë të ndryshme. Ky fakt dikton që lëndë të ndryshme të menaxhohen nga një numër i limituar pedagogësh dhe asistentësh.

**Përgjigje nga GVJ:** Bazuar në dokumentacionin dhe shpjegimet e dhëna nga GVB, opinioni i GVJ në lidhje me shkallën e përmbushjes së kriterit NUK ndryshon. Pavarësisht gjithë shpjegimeve, kriteri përmbushet pjesërisht pasi procesverbalet e vlerësimeve nënshkruhen nga vetëm një pedagog dhe jo nga dy dhe kjo është ajo që kriteri kërkon që ne si eksperte të shprehemi. Mund të jemi natyrisht të bindur se procesi i provimeve është cilësor, i besueshëm dhe i kontrolluar, por këtu po shprehemi specifikisht për komisionet e provimeve nëse janë me 1 apo 2 anëtarë, dhe ky fakt nuk ndryshon.

**Komenti i GVB nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.**

### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT



**Standardi IV.1 Kriteri 1**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*GVJ konstaton se sipas formularit “Full-time staff info form” apo “Part-time staff info form” kërkohet vetëm diploma e fundit e marrë nga anëtari i personelit. Këshillohet që dosja të përmbajë edhe diplomat e nivelit/niveleve të mëparshme të personelit akademik.*

*Dokumentacioni përditësohet çdo vit ose sipas ndryshimeve individuale të dokumentacionit që mund të paraqiste personeli gjatë vitit. Përsa i përket informacionit për angazhimin e personelit në çdo semestër dhe vit akademik informacioni vjen nga Departamenti i Administrim Biznesit pasi ai përcakton ngarkesën në bazë të dokumentit “Directive on the teaching load” të Universitetit Epoka. Ky informacion nuk ndodhet në dosjet e Zyrës së Burimeve Njerëzore.*

**Shpjegim i GVB për Komentet:**

Lidhur me komentin e GVJ-së, sqarojmë se “Full-time staff info form” apo “Part-time staff info form” janë forma që stafi i plotëson pasi është punësuar në Universitetin Epoka në kuadër të vetëdeklarimit të informacionit personal. Pjesa e dytë e formës përdoret për të pasqyruar dhe gjurmuar dokumentacionin në dosje për stafin përkatës. Ju lutem referojuni Shtojcës 2 dhe shtojcës 3.

Megjithëse në formatet e lartë përmendura theksohet se kërkohet vetëm diploma e fundit e fituar nga anëtari i personelit akademik, sjellim në vëmendje se aplikantëve u kërkohet, të paktën edhe diploma pararendëse, pra, diploma e masterit shkencor, nëse kriteri e kërkon që aplikanti duhet të ketë mbaruar doktoratën. Këto dokumente kërkohen edhe në kuadër të plotësimit të dokumentacionit për aplikimin njohjes dhe njësimin të diplomave, certifikatave dhe titujve akademikë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë.

Si përfundim, theksojmë se i mirëpresim sugjerimet e GVJ-së të cilat do të pasqyrohen edhe në formatet e përmendura në komentin e GVJ-së.

Për sa i përket komentit mbi informacionin për angazhimin e personelit në çdo semestër dhe vit akademik – “Ky informacion nuk ndodhet në dosjet e Zyrës së Burimeve Njerëzore”, sqarojmë se informacioni mbi ngarkesën mësimore të personelit akademik gjendet në dosje të veçantë në zyrën e Burimeve Njerëzore, me emërtimin “Course Appointment” për ç’do semestër dhe vit akademik, për të gjithë personelin akademik, sipas fakulteteve dhe departamenteve.

**Përgjigje nga GVJ:** Bazuar në dokumentacionin e sugjeruar nga GVB (shtojca 2 dhe 3) në shpjegimin për komentet në lidhje me Standardin IV.1 Kriteri 1 & 2, GVJ sugjeron që institucioni të vendosë një koherencë midis të gjitha formave që përdor për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të tij.

Përsa i përket shpjegimit mbi “informacionin për angazhimin e personelit në çdo semester dhe vit akademik”, GVB e ka keqkuptuar komentin, sepse sipas GVJ nuk ka mungesë informacioni në këtë rast por ka konstatuar Departamentin e Administrim Biznesit si burimin e një informacioni të tillë. Megjithatë në këtë shpjegim GVJ informohet që ky informacion ndodhet edhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore, në dosjen “Course Appointment”, e cila është e pa referuar në dokumentat e dorzuara.

**Komenti i GVB nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.**

**Standardi IV.1 Kriteri 4**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*GVJ konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik nuk ka një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. GVJ mendon se vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e rezultateve të*

*diplomës Bachelor dhe Master do të ishte shumë e rëndësishme për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit.*

### **Shpjegim i GVB për Komentet:**

Në vijim të komentit të GVJ-së lidhur me kriteret specifike për vlerësimin e aplikantëve për vende vakante në Universitetin Epoka, sqarojmë dhe theksojmë se në rregulloren “On Staff Recruitment”<sup>1</sup>, (shtojca 4) pika 6, pasqyrohen parimet e përgjithshme mbi të cilat bazohet procesi i rekrutimit. Në vijim të pikës 6.1, 6.2 shpjegohen hapat që ndiqen për shpalljen e vendeve vakante dhe përgatitjen e dokumentit që përmban kriteret specifike, duke përfshirë formën e aplikimit e cila përbën një dokument themelor në vlerësimin e kandidatëve për vendin vakant. Bashkëlidhur mund të gjeni edhe një kopje të formës së aplikimit, ku përfshihen kriteret specifike mbi të cilat realizohet vlerësimi i kandidatëve.

Theksojmë se, dokumentacioni që i kërkohet stafit të Universitetin Epoka, përcaktohet në momentin e parë që hapet thirrja për aplikime për vende vakante, ku departamenti përkatës, nëpërmjet Komitetit Shkencor të ngritur pranë tij, ka hapësirën e nevojshme për të përcaktuar kriteret specifike që një kandidat duhet të plotësojë. Bashkëlidhur me këtë dokument gjeni edhe një shembull të shpalljes së thirrjes për aplikime, ku pasqyrohet dokumentacioni që i kërkohet aplikantit dhe kriteret e tjera të nevojshme.

Lidhur me sugjerimin e GVJ-së për caktimin e kriterit të mesatares së rezultateve të kandidatit në Bachelor dhe Master, argumentojmë se, në vlerësimin e kandidatëve një ndër elementët kryesorë ku Komiteti Shkencor bazohet, është edhe kriteri i mesatares së rezultateve të arritura prej tyre në nivelet përkatëse të studimit, pavarësisht se mund të mos jetë e kërkuar shprehimisht. Për ta provuar këtë fakt, si evidencë mund t’i referoheni dokumentit për shpalljen e vendeve vakante<sup>2</sup>, ku ndër dokumentet që kërkohen është edhe lista e notave (transkripti). Ju lutem shikoni shtojcën 5.

Si përfundim, theksojmë se i mirëpresim sugjerimet e GVJ-së të cilat jemi të gatshëm t’i pasqyrojmë në të ardhmen. Megjithatë, nënvizojmë se praktika aktuale nuk na ka penguar për të rekrutuar personel akademik me cilësi të larta kualifikimi për vetë mundësitë që ofron tregu.

**Përgjigje nga GVJ:** Bazuar në dokumentacionin e sugjeruar nga GVB në shpjegimin për komentet në lidhje me Standardin IV.1 Kriteri 4, GVJ gjithashtu sugjeron që institucioni të vendosë një koherencë midis të gjitha dokumentave që përdor për thirrjen dhe vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të institucionit. GVJ konstaton se GVB e ka shkëputur këtë paragraf jashtë kontekstit të mendimit të GVJ, i cili në paragrafin pasardhës është shprehur për praktikën e mira të Departamentit të Administrimit Biznesit në rekrutimin sa më cilësor të stafit të tij.

**Komenti i GVB nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.**

**Standardi IV.4 Kriteri 4**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*Megjithatë gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV apo referencave në RVB për këtë kriter, GVJ nuk gjeti ndonjë dokument të një plani të detajuar të shtimit të zërave të bibliotekës apo periodicitetin e tij. Për këtë arsye GVJ sugjeron hartimin e një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet*

<sup>1</sup> [http://epoka.edu.al/mat/regulations/Regulation\\_Staff\\_Recruitment.pdf](http://epoka.edu.al/mat/regulations/Regulation_Staff_Recruitment.pdf)

<sup>2</sup> [http://epoka.edu.al/mat/hr/job\\_vacancy/2021\\_04\\_28\\_BUS\\_Dept\\_Lecturer\\_or\\_Assit\\_Lecturer\\_Business\\_Informati\\_cs\\_Vacancy.pdf](http://epoka.edu.al/mat/hr/job_vacancy/2021_04_28_BUS_Dept_Lecturer_or_Assit_Lecturer_Business_Informati_cs_Vacancy.pdf)  
[http://epoka.edu.al/mat/hr/job\\_vacancy/2021\\_04\\_26\\_BUS\\_Dept\\_Lecturer\\_or\\_Assit\\_Lecturer\\_Management\\_Vacancy.pdf](http://epoka.edu.al/mat/hr/job_vacancy/2021_04_26_BUS_Dept_Lecturer_or_Assit_Lecturer_Management_Vacancy.pdf)  
[http://epoka.edu.al/mat/hr/job\\_vacancy/2021\\_04\\_26\\_BUS\\_Dept\\_Lecturer\\_or\\_Assistant\\_Lecturer\\_Marketing\\_Vacancy.pdf](http://epoka.edu.al/mat/hr/job_vacancy/2021_04_26_BUS_Dept_Lecturer_or_Assistant_Lecturer_Marketing_Vacancy.pdf)  
[http://epoka.edu.al/mat/hr/job\\_vacancy/2021\\_04\\_26\\_BUS\\_Dept\\_Lecturer\\_Assit\\_Lecturer\\_Math\\_Stat\\_Accounting.pdf](http://epoka.edu.al/mat/hr/job_vacancy/2021_04_26_BUS_Dept_Lecturer_Assit_Lecturer_Math_Stat_Accounting.pdf)

me këtë program studimi, duke pasur parasysh edhe sugjerimin më herët në këtë raport për përditësimin me literature të 5 viteve të fundit.

#### **Shpjegim i GVB për Komentet:**

Si përgjigje ndaj komentit të GVJ mund të themi që Universiteti Epoka në përgjithësi dhe Departamenti i Administrim Biznesit në këtë rast, para cdo fillim viti akademik i kërkon pedagogëve përkatës një listë të teksteve akademike që atyre u duhen për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ky process inicohet nëpërmjet plotësimit të Formularit për Kërkesa Materiale (Material Request Form), për të cilin mund t'i referoheni shtojcës 14. Kërkesat pasi aprovohen nga Përgjegjësi i Departamentit dërgohet në Zyrën e Administratorit për zbatim.

Përdoren dhe mundësi financimi të ndryshme në kuadër të projekteve të shumta ndërkombëtare ku universiteti bën pjesë. Në këtë kuadër, mund të referojme shtojcën 12 si një shembull i blerjes të një fondi librash shumë të vyer të blerë në vitin 2020 për përdorim edhe të këtij program studimor. Theksojmë që të gjithë titujt e librave i përkasin botimeve të 2-3 viteve të fundit.

**Përgjigje nga GVJ:** Bazuar në dokumentacionin e sugjeruar nga GVB në shpjegimin për komentet në lidhje me Standardin IV.4 Kriteri 5 (korrigjojmë: jo Kriteri 4), GVJ rithekson se i ka marrë në konsideratë ato dokumenta që në fillim të shkrimit të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Të gjitha dokumentat e sipërpërmendura tregojnë procedura. Ajo që GVJ ka sugjeruar është hartimi i planit të detajuar, të ardhur nga analizat në mbledhjet e departamentit, mbi të cilat është bazuar vendimmarrja për blerjet e pasqyruara në shtojcën 12, plan të cilin nuk e gjejmë të referuar.

**Komenti i GVB nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.**

## **V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA NDAJ TYRE**

**Standardi V.3. Kriteri 3**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*Në lidhje me këtë kriter RVB referon Rregulloren e Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar (Shtojca 5.1) e cila nuk gjendet në DVV.*

#### **Shpjegim i GVB për Komentet:**

Bashkangjitur me këtë dokument është shtojca 6, Rregulloren e Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar.

**Standardi V.3. Kriteri 4**, në paragrafin si më poshtë vijon:


*Në lidhje me këtë kriter RVB referon Shtojcën 5.3.4 "Udhëzues Praktik I Studentit" e cila nuk gjendet në DVV.*

#### **Shpjegim i GVB për Komentet:**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm falenderon për evidentimin dhe kërkon ndjesë për lapsusin. Bashkangjitur me këtë document do të gjeni shtojcën 7 "Udhëzues Praktik i Studentit." Gjithsesi vlen për tu përmendur që "Udhëzues Praktik i Studentit." Është përfshirë në disa shtojca të tjera.

**Përgjigje nga GVJ:** GVJ merr në konsideratë dokumentacionin e sugjeruar nga GVB në shpjegimin për komentet në lidhje me Standardin V.3 Kriteri 3 (shtojca 6).

Përsa i përket dokumentit të sugjeruar nga GVB (Udhëzues Praktik i Studentit) në shpjegimin për komentet në lidhje me Standardin V.3 Kriteri 4, GVJ sugjeron që referimi të bëhet në gjuhën angleze meqë përkthimi në shqip është një përshtatje. Është e vërtetë që GVJ i është referuar këtij dokumenti në argumentimin për plotësimin e standardeve të tjera.



Megjithatë vlerësimi për përmbushjen e Standardit V.3 bazohet në një sërë argumentash, kështu që mendimi i GVJ për vlerësimin nuk ndryshon edhe pas shtimit të këtyre dy dokumentave.

**Komenti i GVB merret parasysh dhe RVJ ndryshon.**

**U shtua kjo fjali tek Standardi V.3 Kriteri 3:** Pas vizitës së GVJ në Institucion, ky i fundit dorëzoi dhe u ngarkua në sistemin e ASCAL, dokumenti „Career Planning Office Procedures“ në Shtojcën 6, të cilin GVJ e merr në konsideratë.

**U shtua kjo fjali tek Standardi V.3 Kriteri 4:** GVJ merr në konsideratë në shpjegimin e komenteve në lidhje me këtë kriter që dokumenti i referuar nga GVB në Shtojcën 5.3.4.4 „Udhëzues Praktik i Studentit“ është dokumenti „Smart Student Guide“. GVJ sugjeron që referimi të bëhet në gjuhën angleze meqë përkthimi në shqip është një përshtatje.

**Standardi V.4. Kriteri 5,** në paragrafin si më poshtë vijon:

*Sipas RVB Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar është njësi përgjegjëse për të siguruar bazën e të dhënave të saktë dhe të plotë të studentëve të diplomuar duke kontaktuar ata me telefon, përmes postës ose nga rrjetet sociale. Ajo zhvillon çdo vit Anketën e studentëve të diplomuar të Epokës dhe rezultatet e krijuara dërgohen në programin përkatës të studimit dhe publikohen në faqen zyrtare të zyrës. Megjithatë GVJ nuk evidentoi të dhëna të tilla në faqen e sugjeruar nga RVB: <http://cpao.epoka.edu.al/home-alumnistatistics-2018-1457-2596.html>*

**Shpjegim i GVB për Komentet:**

Të dhënat pasqyrohen çdo vit tek faqja kryesore e CPAO-s. Linku vijues do ju drejtojë tek webi i zyrës (<http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-2018-1457-2596.html>).

Ju lutem referojuni shtojcës 8 bashkangjitur me këtë dokument

**Përgjigje nga GVJ:** GVJ merr në konsideratë dokumentacionin e sugjeruar nga GVB në shpjegimin për komentet në lidhje me Standardin V.4 Kriteri 5, por konstaton se informacioni i paraqitur në një grafik të vetëm është shumë i kufizuar për t'u konsideruar si një bazë të dhënash e plotë dhe e saktë e studentëve të diplomuar.

**Komenti i GVB nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.**

**Standardi V.6. Kriteri 4,** në paragrafin si më poshtë vijon:

*Në faqen e web-it të kësaj zyre: <http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-2018-1457-2596.html#> ka informacion vetëm për shkallën e punësimit në % të studentëve në vitin 2019, dhe shpërndarjen e tyre në sektorë të ndryshëm publik apo privat. Në dokumentacionin e dorëzuar në DVV apo në RVB nuk ka asnjë referencë për ndonjë raport apo analizë të kryer nga kjo zyrë lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi.*

**Shpjegim i GVB për Komentet:**

Zyra për çdo vit bën një raport të tillë dhe në raportin e dorëzuar është e përshkruar kjo. Bashkangjitur po ju dërgoj dhe raportin që bën zyra për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Bashkangjitur me këtë dokument ju lutem shikoni shtojcën 9 “Update Alumni Report”

**Përgjigje nga GVJ:** GVJ merr në konsideratë dokumentacionin e sugjeruar nga GVB në shpjegimin për komentet në lidhje me Standardin V.6 Kriteri 4, por ky raport nuk përmban analizat e përmendura në RVJ.

**Komenti i GVB nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.**

## **VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

**Standardi VI. 4. Kriteri 2+3+4**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*Gjatë takimit me pedagogët, studentë dhe Përgjegjës të Departamentit të Administrim Biznesit, GVJ u informua se të gjithë pedagogët janë të angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtij programi studimi, duke përfshirë edhe mendimet, sugjerimet dhe nevojat e studentëve të tyre. Nga këto takime GVJ konstaton se ka një përfshirje aktive të anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ si dhe studentëve të këtij programi studimi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Megjithatë në RVB nuk ka ndonjë evidencë të qartë për përgjegjësitë dhe detyrat konkrete të individëve të tjerë (pedagogë, studentë) të angazhuar në sigurimin e cilësisë përveç atyre të organeve të përhershme të zgjedhura.*

### **Shpjegim i GVB për Komentet:**

Në vijim të konstatimit të GVJ që në RVB nuk ka ndonjë evidencë të qartë për përgjegjësitë dhe detyrat konkrete të individëve të tjerë (pedagogë, studentë) të angazhuar në sigurimin e cilësisë përveç atyre të organeve të përhershme të zgjedhura, GVB shprehet që strukturat që shërbejnë për sigurimin e brendshëm të cilësisë të cilët përbëhen nga pedagogë, staf administrativë dhe studentë kanë detyra të përcaktuara qartë në statut dhe në aktet e tjera rregullator të Universitetit EPOKA. (Articles No.16, Article 12, Article No.35, Article No.37 of Statute of EPOKA University, Article 3 and 4 of Statue of Student Council, Quality Assurance Handbook-point 2 and point 3 pp 18-20, point 4.1-4.4 pp 23-25)

**Përgjigje nga GVJ:** Bazuar në dokumentacionin e sugjeruar nga GVB në shpjegimin për komentet në lidhje me Standardin VI.4 Kriteri 2 & 3 & 4, GVJ rithekson konstatimin e mëparshëm të shprehur në RVJ.

**Komenti i GVB nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.**

**Standardi VI. 5. Kriteri 3**, në paragrafin si më poshtë vijon:

*Ashtu sikurse e kemi përmendur edhe në Standardin VI.2 të këtij raporti në RVB thuhet se rezultatet e vlerësimeve të realizuara në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë dokumentuar dhe janë paraqitur në Departamentet e Administrim Biznesit, Dekanat, Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Rektorat dhe në Senatin Akademik.*

*Megjithatë GVJ nuk gjen asnjë dokument apo referencë në RVB për raportet e sipërpërmendura. Referenca "Politika për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit në Shtojcën Nr. 6.3" që citohet në RVB ka të bëjë me strategjitë, politikat apo direktivat që lidhen me përmirësimin e performancës së programit të studimit. Ndërsa referenca "Plani i Veprimt në përgjigje të rekomandimeve nga ASCAL në Shtojcën Nr. 6.16" është e gabuar.*

### **Shpjegim i GVB për Komentet:**


GVB konfirmon që rezultatet e vlerësimeve të realizuara në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë dokumentuar dhe janë paraqitur në Departamentet e Administrim Biznesit, Dekanat, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, Rektorat dhe në Senatin Akademik. Në fund të çdo semestri akademik, Departamenti i Administrim Biznesit harton një raport për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në bazë të opinioneve të studentëve të gjeneruar nëpërmjet një pyetësoi ku studentët shprehen në lidhje me kënaqshmërinë e tyre për lëndën e ofruar dhe profesorin përkatës. Raporti shoqërohet dhe me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive të

evidentuara. (Ju lutem referojuni shtojcës 13, Department Report on Course Instructor Evaluation Survey and Action Plan). Raporti në fjalë vihet në dispozicion të organeve të tjera përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë për shqyrtim të mëtejshëm. Gjithashtu, Departamenti i Administrim Biznesit ka hartuar dhe një plan veprimi në kuadër të plotësimit të rekomandimeve të lëna nga akreditimi i mëparshëm (Shikoni shtojcën 15, Action Plan in Response to the Recommendations of Accreditation Board)

**Përgjigje nga GVJ:** GVJ merr në konsideratë dokumentacionin e sugjeruar nga GVB në shpjegimin për komentet në lidhje me Standardin VI.5 Kriteri 3, dhe konstaton se rezultatet e vlerësimeve të realizuara në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë dokumentuar dhe janë paraqitur në Departamentet e Administrim Biznesit.

**Komenti i GVB merret parasysh dhe RVJ ndryshon.**

**U shtua kjo fjali tek Standardi VI.5 Kriteri 3:** Pas vizitës së GVJ në Institucion, ky i fundit dorëzoi dhe u ngarkuan në sistemin e ASCAL, dokumentat "Department Report on Course Instructor Evaluation Survey and Action Plan" në Shtojcën 13 dhe „Action Plan in Response to the Recommendations of Accreditation Board” në Shtojcën 15, të cilat GVJ i merr në konsideratë. GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimeve të realizuara në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë dokumentuar dhe janë paraqitur në Departamentet e Administrim Biznesit.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Informatikë Ekonomike”,  
Universiteti EPOKA.**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, GVJ u njoh me dokumentacionin pjesë e Dosjes së Vetë Vlerësimit, DVV. Nga shqyrtimi i kësaj dosjeje u vu re se në Statutin e Universiteti “EPOKA, (14/12/2016, Ankesi 1.3 në DVV ose Aneksi 2.2 për Statutin në gjuhën shqipe), në pikën 3 deklarohet se misioni i përgjithshëm i këtij Institucioni është <i>“ofrimi i shërbimeve arsimore dhe kërkimore inovative dhe ndikuese në shërbim të vlerave bazë humane përmes prodhimit, zhvillimit dhe përcimit të njohurive si edhe dhënia e kontributit për përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë në përputhje me nevojat kombëtare dhe rajonale”</i>.</p> <p>Në kohën e hartimit të këtij Raporti (prill-maj 2021), Universiteti EPOKA ofron programe studimi në tre fusha: atë ekonomike, inxhinierike dhe sociale. Në këto programe studimi pritet të formohen studentë të ardhshëm të cilët të kontribuojnë për avancimin e njohurive dhe aplikimeve praktike të këtyre disiplinave në vendin tonë. Duke konsideruar se këto tre fusha përbëjnë prioritetet për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë, gjykojmë se ofrimi në përgjithësi i programeve të studimit në fushat ekonomike, inxhinierike dhe sociale mbështet interesat kombëtare të vendit.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Për të përcaktuar nëse programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i Universiteti Epoka është konform ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike dhe kulturore të kombit shqiptar, GVJ shqyrtoi në mnëryrë të vecantë Statutin. Statuti i Institucionit (neni 3) deklaron se qëllimi i përgjithshëm i Universitetit Epoka është përgatitja e individëve të kualifikuar, produktivë, të aftë, me etikë profesionale dhe të ndjeshëm kundrejt shoqërisë. Ndër objektivat e Institucionit (Statuti, neni 3) që burojnë nga ky qëllim i përgjithshëm listohen, ndër të tjera edhe: a) integrimi i mësimdhënies me kërkimin shkencor; b) kontributi në zhvillimin ekonomik të vendit; dhe c) kontributi për rritjen e standardeve demokratike dhe mirëqënien e shoqërisë dhe përgatitja e të rinjve për të kontribuar aktivisht në shoqëri.</p> <p>GVJ gjykon se bazuar në qëllimin dhe objektivat e tij të cilat janë shprehur në Statut, Institucioni ka në fokus ruajtjen e vlerave akademike (të shprehura në cilësi si: kërkimi shkencor i alternuar me mësimdhënien, kualifikimi, etika) dhe vlerave kulturore (të shprehura në kontributin dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri dhe rritjen e mirëqënies së kësaj të fundit).</p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e	<p>Përsëri referuar Statutit të Institucionit (neni 3) vihet re se ky i fundit deklaron se qëllimi i përgjithshëm i Universitetit Epoka është <i>përgatitja e individëve të kualifikuar, produktivë, të aftë, me etikë profesionale dhe të ndjeshëm kundrejt shoqërisë</i>“. Ndërkohë që Misioni i Institucionit ishte <i>“ofrimi i shërbimeve arsimore dhe kërkimore inovative dhe ndikuese në shërbim të vlerave bazë</i></p>

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p><i>humane përmes prodhimit, zhvillimit dhe përcimit të njohurive si edhe dhënia e kontributit për përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë në përputhje me nevojat kombëtare dhe rajonale“.</i></p> <p>GVJ vrojton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është i hartuar në përputhje me çfarë është shprehur në qëllimin e përgjithshëm dhe misionin e Institucionit sic deklarohen në Statutin e tij (neni 3).</p> <p>Fusha e programit të studimit gjithashtu përputhet me fushën e veprimtarisë së Institucionit (të cilat janë: Shkenca Inxhinierike, shkenca sociale dhe ekonomi).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, GVJ mbështetur në formimin e tij, njohurinë e tregut dhe ekonomisë shqiptare si edhe në bazë të dokumentacionit pjesë e DVV, mund të konkludojë se Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i Universitetit EPOKA ofrohet i mbështetur në një nevojë të tregut shqiptar, lokal dhe rajonal për specialistë ekonomie dhe biznesi të cilët të kenë gjithashtu edhe baza të forta në teknologjinë e informacionit. Ndërthurja e njohurive nga të dyja këto disiplina është bërë tashmë një kërkesë lehtësisht e verifikueshme e tregut, dhe angazhimi i Institucionit në hartimin dhe ofrimin e një Programi Studimi në këtë aspekt gjykohet nga ana e GVJ si një veprim i mirëmenduar strategjik nga ana e tij. Përgatitja e ekonomistëve me background të konsoliduar në teknologji informacioni nxit zhvillimin ekonomik të vendit si edhe ndihmon në ngritjen e partneriteteve lokale mes njësisive ekonomike vendase si edhe ato kombëtare.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b> <b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Ndër dokumentet më të rëndësishme, pjesë e DVV të dorëzuar nga Institucioni, dhe të shqyrtuara nga GVJ janë (1) Strategjia e Zhvillimit dhe Plani i Veprimit të Institucionit 2018-2022 (Aneksi 3.1 në DVV) dhe (2) Plani Strategjik për Departamentin e Administrim Biznesit 2017-2022 (Aneksi 1.5 në DVV). Në këto dokumenta përcaktohet strategjia e zhvillimit të institucionit në tërësi dhe e njësisive bazë të cilat janë përgjegjëse për programet e studimit.</p> <p>GVJ pasi shqyrtoi këto dy dokumenta konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike paraqitet në përputhje me qëllimet dhe objektivat e institucionit, të përcaktuara në “Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit EPOKA”.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Universiteti EPOKA, sic konstaton GVJ mbështetur në shqyrtimin e Statutit të Institucionit i cili është pjesë e DVV, ka identifikuar në mënyrë të qartë dhe transparente drejtimit prioritar akademike të tij, (pika 1, neni 3, Statuti i Institucionit) të cilat janë: <i>“inxhinieri kompjuterike, inxhinieri civile, arkitekturë, ekonomiks, bankë dhe financë, administrim biznesi, ligje, shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare si dhe shkencave të tjera sociale me formim të përgjithshëm nëpërmjet programeve universitare mësimore-shkencore të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik.”</i></p>



Adresa: “Rruga e Durrësit”. Nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

faqe 16




	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është i orientuar në përputhje me të paktën një nga fushat akademike të identifikuar më lart.			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	<p>Bazuar në shqyrtimin e Rregullores së Programit të Studimit (Rregullore të programeve të studimit në nivel Bachelor, Aneksi 3.5.1 në DVV), Planit Mësimor dhe dokumenta të tjerë në DVV, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i ofruar nga Universiteti EPOKA, është një program studimi i Ciklit të Parë me 180 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, i ofruar dhe realizuar në gjuhën angleze i organizuar me një kohëzgjatje normale 3 vite (6 semestra ku cdo vit ka dy semestra). Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë universitare Bachelor në “Informatikë Ekonomike”.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit, (shtojca 2.1 në DVV), GVJ arrin në përfundimin se programi është strukturuar dhe organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, sipas nivelit të kualifikimit të kërkuar në përputhje me Ligjin për Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor, udhëzimet e Ministrit të Arsimit, Sportit e Rinisë (MASR) dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Përmbajtja e programit të studimit është gjithashtu në përputhje me drejtimin akademik të Institucionit sic shprehet në Statutin e tij dhe me planet strategjike sic paraqiten në “Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit 2018-2022”.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.3

#### Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ana e Institucionit në platformën e ASCAL, GVJ konstaton se në Statutin e Institucionit dhe në Planin Strategjik të Departamentit të Administrimi - Biznesit paraqiten objektiva të përgjithshme të Institucionit dhe programeve të studimit që ai ofron (studentëve u sigurohen aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve të nevojshme për kërkime dhe inovacion në mënyrë që të zhvillojnë njohuri dhe procedura të reja, si dhe të integrojnë njohuritë nga fusha të ndryshme).</p> <p>Përsa i përket objektivave për formimin e studentëve në këtë program studimi, ato gjenden si informacione të përfshira në syllabuset e vecanta të lëndëve të programit të studimit dhe të publikuara në faqen e internetit të Institucionit, por fillimisht nuk ishin të materializuara dhe të përmbledhura në një dokument specifik të identifikueshëm në mënyrë të vecantë. Hartimi i një dokumenti të fokusuar në të cilin të jenë të përmbledhura përshkrimi i shkurtër i programit të studimit, misioni, qëllimi dhe objektivat për formimin e studentëve, si edhe dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që ata pritet të fitojnë në përfundim të programit Bachelor në Informatikë Ekonomike u diskutua nga</p>

	<p>ekspertët e GVJ gjatë vizitës në Institucion. Si rrjedhojë e kësaj kërkese, më pas nga Institucioni u hartua dhe u dorëzua në sistemin e ASCAL, dokumenti i titulluar: “Profili i Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike”. Në këtë dokument mund të gjenden të gjitha elementet e kërkuara në këtë kriter, prandaj GVJ e vlerëson pozitivisht reagimin dhe gatishmërinë e treguar nga Institucioni.</p> <p><a href="#">Shtojca 1.3 _statute-of-epoka-university.pdf</a></p> <p><a href="#">Shtojca 3.1 Framework Strategy and Action Plan 2018-2022.pdf</a></p> <p><a href="#">Programet lëndore.</a></p> <p><a href="#">Profili i programit të studimit bachelor në Informatikë Ekonomike.</a></p> <p><a href="#">BA BINF PROGRAM PROFILE.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se Institucioni deklaron në RVB kryerjen e analizës së tregut të punës për programet e ofruara të studimit, përpara hapjes së tyre, pas diplomimit të studentëve, dhe në baza periodike.</p> <p>Në vitin 2017 është zhvilluar një studim i detajuar i tregut për programin e studimit “Bachelor në Informatikë Ekonomike” (kjo edhe për faktin se është dhënë si rekomandim në akreditimin e mëparshëm). Ky studim paraqitet i plotë për nga elementët e nevojshëm si kërkesat dhe nevojat e punëdhënësve potencialë, mundësitë e punësimit të studentëve, zhvillimet e pritshme në sektorin specifik, komente dhe sugjerime nga pjesëmarrësit, etj.</p> <p>Në nivel fakulteti, RVB deklaron se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ka realizuar një studim mbi “Aftësitë e të diplomuarve dhe punësimi në tregun e punës: Pritshmëritë e të diplomuarve dhe perspektiva e punëdhënësve” dhe për këtë jep një referencë e cila po të ndiqet nuk ka akses lehtësisht. (Turan et al. (2016) ‘Graduate Skills and Employability at the Labour Market: Graduates’ Expectations and Employers’ Perspective).</p> <p>Gjithashtu në RVB deklarohet se nga ana e Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar (ZPKSD) kryhen në mënyrë periodike studime tregu pas daljes së studentëve (i fundit që gjejmë në DVV i takon qershorit të vitit 2019, shtojca 1.9). Ndër dokumentat në DVV haset edhe shtojca 6.12 “Pyetësor për kënaqsinë e kompanive” e cila në thelb është një përpjekje e Institucionit të vlerësojë sa të kënaqura janë bizneset me studentët e diplomuar nga EPOKA. Pavarësisht se ky pyetësor nuk është i fokusuar në programe të vecanta studimi, ai nxjerr në pah përpjekjet e Institucionit për t’u siguruar për suksesin e studentëve të tij dhe për studimin e vazhdueshëm të tregut të punës. <i>Referenca në RVB në lidhje me projektin Connect IT nuk ka vend në studimin e tregut të punës.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të</p>	<p>Komponentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, si objektivat formues, struktura dhe përmbajtja, rezultatet e të nxënit, sic u përmend edhe më lart, janë informacione që nuk gjenden të përmbledhura në një dokument të vecantë specifik por janë të përfshira në mënyrë të shkëputur në programet lëndore të vecanta. Pavarësisht kësaj, GVJ ka marrë kohë dhe i ka shqyrtuar me kujdes komponentët. Për sa kohë që nuk ka ndryshime të ndjeshme nga studimi i fundit i tregut i bërë në vitin 2017, mund të thuhet që</p>




punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	në tërësi elementët e programmit të studimit kontribuojnë për përfitimin nga ana e studentëve të dijeve, kompetencave dhe shkathtësive të kërkuara në tregun e punës dhe garantojnë lehtësi në punësimin e tyre. <i>Referenca në RVB në lidhje me letren e falenderimit nga UNIV Vjena dhe rankimin si nje nga 45 shkollat me te mira per mesimdhenie, nuk kanë lidhje me kete kriter.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.4</b> <b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	<p>Nga shqyrtimi në tërësi i plotësisë së dokumentacionit të dorëzuar, si edhe nga vizita në terren, GVJ konstaton disa elemente:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucioni ka të punësuar si staf akademik me kohë të plotë dhe të ftuar, një numër të konsiderueshëm pedagogësh.</li> <li>• Universiteti EPOKA është një Institucion që disponon burime infrastrukturore (godina dhe biblioteka fizike dhe virtuale) të bollshme për mbulimin e nevojave të studentëve dhe stafit.</li> <li>• Duke pasur “ndërkombëtarizimin” si objektivi, Institucioni ka punësuar staf të huaj dhe ka rritur përqindjen e përfaqësimit të personelit nga vende të tjera.</li> <li>• Gjithashtu pjesëmarrja në projekte shkencore ndërkombëtare nga ana e Universitetit është në nivele të konsiderueshme.</li> <li>• Së fundmi, niveli i punësimit të studentëve është në normë të lartë.</li> </ul> <p>Mbështetur në këta elemente GVJ gjykon se Universiteti EPOKA ka kapacitetet e duhura për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>Njësia kryesore, përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, Bachelor në Informatikë Ekonomike është Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i Universitetit EPOKA. GVJ konstaton se fusha e studimit e programit ka përputhshmëri me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore e cila është përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>Përsa i përket Kodifikimit kombëtar të programeve të studimit, siç parashikohet nga dispozitat e nenit 86 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ai ende nuk është aprovuar nga MASR. Pavarësisht kësaj, GVJ konfirmoi se Universiteti "EPOKA" zbaton kodifikimin e vet të programeve dhe lëndëve të studimit në përputhje me fushën e studimit.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën	Sipas të dhënave në DVV, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i Universitetit Epoka i cili është njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike


Adresa: "Rruga e Durrësit". Nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

faqe 19

<p>akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>përbëhet nga Departamenti i Financë-Bankës, Departamenti i Administrim Biznesit dhe Departamenti i Ekonomiksit.</p> <p>Departamenti i Administrim Biznesit është njësi bazë që mbështet ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Për këtë program studimi, Departamenti i Administrim Biznesit bashkëpunon me Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike që është pjesë e të njëjtit institucion duke shfrytëzuar kapacitetet humane të profesoratit, kapacitetet infrastrukturore laboratorike etj.</p> <p><a href="#">Shtojca 1.3 statute-of-epoka-university.pdf</a></p> <p><a href="#">Shtojca 2.3.1 univ org scheme EN nov 2018.pdf</a></p> <p><a href="#">Shtojca 3.1 Framework Strategy and Action Plan 2018-2022.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ, mbështetur në analizën e Statutit të Institucionit (më konkretisht Neni 23 i statutit), konstaton se Institucioni në tërësi ka parashikuar formalisht mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe bashkëpunimin mes njësive përbërëse organike të tij. Sipas Statutit, cdo njësi ka detyra dhe objektiva ku njësitë bazë organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore dhe njësitë kryesore koordinojnë aktivitetet e njësive bazë që ata përfaqësojnë. Njësitë administrative të përgjithshme të Institucionit mbështesin aktivitete të ndryshme të përgjithshme si infrastruktura, shërbimet e teknologjisë së informacionit, shërbimet e garantimit të cilësisë, menaxhimi i projekteve, etj.</p> <p>Përsa i përket analizës së punës së njësive institucionale, në këtë rast Departamenti i Administrim Biznesit, GVJ u ndal në shtojcat 1.12 dhe 1.13 ku paraqitet Raporti Vjetor i Departamentit (i fundit i takon vitit 2018 – 2019). Haset gjithashtu në shtojcën 1.15 të DVV, një “Plan mbi Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programit të Studimit”, i cili është një plan i përgjithshëm por jo specifik për këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe sipas konfirmimeve të kryera pas vizitës në Institucion, GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me Universitete partnere brenda dhe jashtë vendit, si edhe me institucione të tjera ku vend të rëndësishëm zënë njësitë ekonomike dhe kompanitë e biznesit.</p> <p>Një listë me universitetet dhe partnerët jo universitarë bashkëpunuese është dhënë në shtojcën 1.8 “Mbi Listën e Institucioneve dhe Organizatave Bashkëpunuese në Nivel Programi Studimi dhe Praktika Profesionale” dhe në tabelën 5 në shtojcat e RVB. Në këtë listë shihet se specifikohet në mënyrë</p>




	direkte se për cilat programe studimi janë të vlefshme këto marrëdhënie bashkëpunimi.			
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Në RVB të dorëzuar nga ana e Institucionit, Grupi i Punës shprehet se në fund të çdo viti akademik, Departamenti i Administrim Biznesit përgatit një raport të detajuar analitik në kontekstin e arritjeve të programeve të studimit, si dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke iu referuar Raportit Vjetor të njësisë bazë. Por GVJ, pas shqyrtimit të Raportit Vjetor vërejt se në këtë të fundit jepet një informacion i kufizuar vetëm për mobilitetet në kuadrin e programeve Erasmus + (faqja 29 e Raportit Vjetor), pa specifikuar nëse këto mobilitete lidhen me këtë program specifik studimi ose jo. <i>Gjithashtu në Raportin Vjetor listohen aktivitetet e pasura të njësisë bazë, por përsëri GVJ gjen lidhje të dobët mes këtyre aktivitetet dhe programit të studimit që po shqyrtohet, dhe sidomos mungon raportimi analitik i informacionit në lidhje me përfitimet nga marrëveshjet e lidhura.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Në këtë pikë, RVB e Institucionit, referon listën e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucione Brenda dhe jashtë vendit (shtojca 1.8 në DVV). Informacioni i dhënë në këtë dokument dhe në RVB, dhe për më tepër bazuar në diskutimet me studentët aktualë dhe të diplomuar nga programi, mjaftojnë që GVJ të formojë një opinion të plotë, se Institucioni vërtet ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi të frytshme në kuadrin e organizimit të praktikave profesionale.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në RVB deklarohet se Institucioni në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të studentëve dhe të diplomuarve ka themeluar disa qendra për udhëheqjen e disa aktivitetet zhvillimore shkencore dhe arsimore për të diplomuarit, si dhe për studentët aktualë, siç janë: Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm; Qendra Yunus për Biznes Social dhe Qëndrueshmëri; Qendra për Studime Evropiane; Qendra e Kërkimit Shkencor dhe Dizajnit në Shkencat e Aplikuara.  Në anën tjetër, klubet studentore janë gjithashtu një instrument tjetër që institucioni shfrytëzon për të zhvilluar më tej përfshirjen dhe interesat e studentëve.  Përsa i përket trajnimeve me studentët e diplomuar, Institucioni shprehet se trajnimet e ofruara prej tyre janë të hapura për të gjithë studentët dhe për ata të diplomuar specifikisht, angazhohet Zyra e Karrierës për t'i njoftuar ose nëpërmjet adresave email të Universitetit Epoka, ose nëpërmjet rrejteve sociale, për t'i ftuar në trajnime si edhe për të marrë mendimet dhe opinionet e tyre pas diplomimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1. Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në DVV, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i ofruar në Universitetin EPOKA, është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi (Ligji për Arsimin e Latë 80/2015) dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi i studimit është me kohë të plotë me një kohëzgjatje 3 vjet dhe 6 semestra (vjeshtë dhe pranverë), në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë universitare “Bachelor”. Programi i studimit zhvillohet në gjuhën angleze.</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të Programit të Studimit (shtojca 2.1), GVJ konstaton se disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; në kategorinë B, që janë lëndët bazë, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim.)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit të studimit (shtojca 2.1 në DVV), GVJ konstaton se tërësia e lëndëve të detyrueshme dhe atyre me zgjedhje të parashikuara në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ofron një mbulim të mjaftueshëm të disiplinave specifike në fushat e Biznesit dhe Teknologjisë Informatike dhe ofron larmi të përfitimit të njohurive përkatëse në këto fusha ndër të cilat mund të vecojmë formimin e aftësive profesionale në programim, algoritmikë, teknologji ueb-i, menaxhimin e bazave të të dhënave ndërthurur me njohuri mbi kontabilitetin, marketingun, organizimin e shoqërive, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni, specifikohet se Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i përket Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), dhe synon të mundësojë njohuritë themelore për metodat dhe parimet, si dhe aftësitë specifike në një larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit dhe më tej të Syllabuseve të Lëndëve, GVJ konstaton se në tërësi ky program planifikon të japë njohuri të kompletuara teorike dhe akademike në fushat e studimit Biznes dhe Teknologji Informacioni si edhe i aftëson studentët për punësim</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”. Nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)


Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

faqe 22




	<p>të mëtejshëm. Ndërthurja e lëndëve paraqitet në përgjithësi e kompletuar për të aftësuar studentët e programit të kuptojnë parimet akademike të të dyja disiplinave. Kjo u nënvizua edhe nga studentët në takimin që GVJ zhvilloi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Sipas Planit Mësimor të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ konstaton se në përgjithësi programi i studimit ofron një larmi disiplinash të detyrueshme dhe me zgjedhje duke synuar aftësimin e studentëve në kompetenca të avancuara. Në vitin e parë të studimeve, programi ofron më tepër lëndë të disiplinave bazë A, B dhe D (anglisht ose anglishte biznesi) e në vitet e tjera më së shumti lëndë të disiplinave B dhe C.</p> <p>Mbështetur sidomos në analizën të syllabuseve të lëndëve të programit, dhe pas kontakteve me studentët e programit, GVJ formoi opinionin se studentët kanë nxitjen nga ky program studimi të përfshihen në probleme komplekse në fushën e informatikës ekonomike.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike paraqitet i strukturuar në përputhje me Ligjin 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Elementët e programit të studimit janë në përputhje kryesisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM), nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" i ndryshuar me VKM nr. 879 dt. 18.12.2019. Ai është i organizuar në pesë disiplinat formuese (A – E), ka 180 kredite, zgjat tre vite akademike, mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, dhe është i detyrueshëm për frekuentim në masën 60% dhe për studentët e trajtuar me bursë të paktën 75% (Rregullorja e Programit të Studimit, neni 14.d; shtojca 3.5.1.)</p> <p>Syllabuset e lëndëve të programit të studimit paraqiten kryesisht në përputhje me aktet ligjore dhe konkretisht VKM nr.41 përsa i përket strukturimit të tyre. Një element që u konstatua se nuk zbatohet në mënyrë uniforme në të gjitha programet lëndore ishte detajimi i çështjeve në nëncështje dhe shpjegimi (rreth një paragraf) i çdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe, sipas kërkesave të shtojcës nr.2 të VKM 41). (Sa për të përmendur disa shembuj: MATH. FOR ECONOMICS AND BUSINESS II; BUSINESS ENGLISH; DATABASE MANAGEMENT SYSTEMS).</p> <p>Kjo mangësi u konfirmua edhe gjatë vizitës në Institucion si një çështje që pritet të përmirësohet me tej në vijim nga ana e Institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Sic konfirmohet nga shqyrtimi i shtojcës 2.1 të DVV - Planit Mësimor të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, shpërndarja e lëndëve dhe moduleve sipas kategorive, në ECTS për programin e studimit është si më poshtë:</p> <p><i>Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, ndarja në kategoritë është si më poshtë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Kategoria A</b> (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): – gjithsej <b>35 ECTS</b> (20% e totalit)</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Kategoria B</b> (lëndë të formimit karakterizues: gjithsej <b>93 ECTS</b> (52%))</li> <li>- <b>Kategoria C</b> (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): gjithsej <b>27 ECTS</b> (15%)</li> <li>- <b>Kategoria D</b> (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): gjithsej <b>19 ECTS</b> (10%)</li> <li>- <b>Kategoria E</b> (detyrimet përmbyllëse: projekti i diplomimit ose provimi përfundimtar gjithëpërfshirës): gjithsej <b>6 ECTS</b> (3%)</li> </ul> <p>Shtojca 2.1 BINF program curricula.pdf</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti EPOKA është akredituar për herë të parë si institucion sipas Urdhërit Nr. 260, datë 07.06.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe ka marrë akreditimin institucional periodik në bazë të Vendimit Nr. 92, datë 20.10.2017, të Bordit të Akreditimit. Aktualisht Institucioni është në proces riakreditimi institucional.</p> <p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i cili përbëhet nga tre njësi bazë. Njëra nga këto, Departamenti i Administrim Biznesit është përgjegjës për ofrimin e këtij program studimi.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative ofron gjithsej 13 programe studimi (tabela 3 në shtojcën e RVB): 5 programe studimi në nivelin bachelor, 3 programe studimi në Master i Shkencave, 2 programe studimi në Master Profesional dhe 3 programe në nivel të shkollës së Doktoratës.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i riformatuar në përputhje me sistemin e Bolonjës, i është nënshtruar akreditimit periodik të parë bazuar në Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 358, datë 25.09.2015 sipas të cilit kishte dy rekomandime. Analiza e GVJ mbi shkallën e përbushjes së këtyre rekomandimeve është bërë në hyrje të këtij Raporti.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit</p>	<p>Në RVB Institucioni raporton se njësia kryesore / bazë përgjegjëse për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e programit dhe praktikave në përputhje me objektivat e tij, dhe orienton si referim Statutin e Institucionit (neni 50) dhe shtojcën 2.4 politikën e Institucionit për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit. RVB gjithashtu deklaroi se Koordinator i programit të studimit punon nën mbikqyrjen e Përgjegjës të Departamentit të Administrim Biznesit dhe njëkohësisht ka mbështetjen e departamentit në fjalë.</p>






informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.

Duke qenë se në këto referenca GVJ nuk gjen informacion për caktimin e një personi konkret në rolin e koordinatorit të programit të studimit u pyet gjatë vizitës Institucion ku u informuam se koordinatori akademik i programit të studimit është një anëtar/e i personelit akademik efektiv të Departamentit të Administrim Biznesit. Për këtë pati konfirmim edhe gjatë intervistës me studentët e programit të studimit, të cilët theksuan mbështetjen dhe orientimin e vazhdueshëm të dhënë nga koordinatorja e programit të studimit.

**Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

**Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.

Mbështetur në kërkesat e nenit 23 të ligjit të A.L “Fakulteti organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente”, GVJ konfirmon se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i Universitetit EPOKA, përbëhet nga tre departamente/njësi bazë:

- Departamenti i Administrim Biznesit,
- Departamenti i Financë – Bankës dhe,
- Departamenti i Ekonomiksit.

Referuar të dhënave shoqëruese të RVB (Tabelat 1 dhe 2 në shtojcat e kësaj të fundit), si edhe pas konfirmimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Administrim Biznesit, i cili është edhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit (më specifikisht, ka minimumi 7 pedagogë të brendshëm nga të cilët të paktën 3 janë me tituj/grada).

Të dhëna analitike në lidhje me përbërjen e stafit të Departamentit të Administrim Biznesit në vitet që nga akreditimi i mëparshëm (viti 2015) paraqiten më poshtë:

Dep i Administrim Biznesit	2015-2016		2016-2017		2017-2018	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr		2		1	1	
Prof.As			1		1	
Dr	4	1	3	2	3	1
MSc	3	7	3	7	3	4
<b>Total</b>	<b>7</b>	<b>10</b>	<b>7</b>	<b>10</b>	<b>8</b>	<b>5</b>
<b>PNA</b>	<b>3</b>		<b>2</b>		<b>1</b>	

Dep i Administrim Biznesit	2018-2019		2019-2020		2020 – 2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1		1	1	1	
Prof.As	1		2	2	2	
Dr	3	2	3	2	4	
MSc	2	1	2	3	1	2
<b>Total</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>8</b>		<b>8</b>	<b>2</b>
<b>PNA</b>	<b>1</b>		<b>1</b>		<b>7</b>	



Cfarë bie në sy në ecurinë e numrave të personeit akademik, është pakësimi i stafit akademik me kontratë në vitin e fundit akademik, krahasuar me vitet e mëparshme. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pyeti për këtë pikë dhe u

	informua nga Përgjegjësi i Departamentit të Administrim Biznesit se kjo ka ndodhur për shkak se janë hapur pozicione pune dhe thirrje për rekrutim stafi akademik efektiv, thirrje që janë ende në proces dhe vendet vakante ende nuk janë plotësuar.																										
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Sic u përmend edhe më lart GVJ konfirmon se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative të Universitetit EPOKA, ka në përbërjen e tij tre departamente (Departamenti i Administrim Biznesit, Departamenti i Financë – Bankës dhe Departamenti i Ekonomiksit).</p> <p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar (tabela 1 në shtojcat e RVB), në vitin e fundit akademik <b>2020-2021</b>, Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative i Universitetit EPOKA nga 46 staf gjithsej, ka 23 Personel Akademik Efektiv (pra 79% të stafit total pa stafin ndihmes akademik), 6 Personel Akademik me Kontratë (23% të stafit total pa stafin ndihmes akademik) dhe 17 Personel Ndhmës Akademik (37 % e stafit total qe perfshin edhe ate ndihmes akademik). Për vitin <b>2020 – 2021</b>:</p> <table border="1" data-bbox="657 725 1311 1016"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Fakulteti i Shkencave Ekonomike</th> <th colspan="2">2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Prof.As</td> <td>4</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>10</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>MSc</td> <td>7</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td><b>Total</b></td> <td><b>23</b></td> <td><b>6</b></td> </tr> <tr> <td><b>PNA</b></td> <td colspan="2"><b>17</b></td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Për vitet e tjera akademike, nuk jepen të dhëna në RVB ne lidhje me numrin e stafit PAE dhe PAK për njësinë kryesore.</i></p> <p>Për këtë vit akademik vihet re një numër i lartë i personelit ndihmës akademik – 17 nga të cilët vetëm në Departamentin e Administrim Biznesit janë 7 staf.</p> <p>Të pyetur gjatë vizitës, GVJ u informua se institucioni implementon një program të njohur si Program për asistentë mësimorë, pra personeli ndihmës akademik.</p> <p>Sipas këtij programi, studentë të nivelit master me mesatare të lartë angazhohen në punë asistence akademike për pedagogët. Ata nuk japin mësim por asistojnë me detyra ndihmëse për orën – përgatisin ushtrime, konsultojnë studentët që kanë nevojë, propozojnë tema për detyra kursi dhe orientojnë studentët në kryerjen e këtyre detyrave, organizojnë administrimin dhe arkivimin e materialeve mësimore të lëndëve, etj. Studentet vetë fitojnë bursë por edhe paguhen për këtë punë. Angazhimi i tyre mund të jetë me kohë të plotë pra, 20 orë në javë, ose me kohë të pjesshme 10 orë në javë.</p>				Fakulteti i Shkencave Ekonomike	2020-2021		PAE	PAK	Prof.Dr	2		Prof.As	4		Dr	10	3	MSc	7	3	<b>Total</b>	<b>23</b>	<b>6</b>	<b>PNA</b>	<b>17</b>	
Fakulteti i Shkencave Ekonomike	2020-2021																										
	PAE	PAK																									
Prof.Dr	2																										
Prof.As	4																										
Dr	10	3																									
MSc	7	3																									
<b>Total</b>	<b>23</b>	<b>6</b>																									
<b>PNA</b>	<b>17</b>																										
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>																							


**Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar në DVV si edhe informacionet publike të Institucionit në faqen e tij të Internetit (Rregullorja e programit të studimit, Guida e Studentit; Plani Mësimor i Programit të Studimit) dhe konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike disponohen nga Fakulteti (njësia kryesore) dhe Departamenti (njësia bazë) si edhe janë publike dhe të mundshme për t'u aksesuar lirisht.</p> <p>Bazuar në diskutimet e kryera me pedagogët dhe studentët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi gjithashtu se studentët kanë informacion në lidhje me programin e studimit pasi njoftohen qysh në fillim të studimeve nëpërmjet Guidës Smart të Studentit, por edhe në fillim të cdo semestri nga pedagogët përkatës të lëndëve specifike. Sipas konfirmimit nga studentët e programit në fillim të cdo semestri studentëve iu vihen në dispozicion dhe ju prezantohen syllabuset për cdo lëndë që ofrohet.</p> <p>Sipas Rregullores së Institucionit, GVJ vëren se Plani Mësimor i programit të studimit miratohet me propozim të Fakultetit dhe njësive bazë në Senatit Akademik për secilin vit dhe u shpërndahet njësive kryesore, atyre bazë, stafit akademik, atij administrativ dhe i bëhet i ditur studentëve. GVJ konstatoi se një kopje e Planit Mësimor gjendet edhe në faqen e internetit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e Planit Mësimor të Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuar në module të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje; ai përmban praktikë profesionale e aktivitete formuese (orë laborator) sipas kërkesave të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni gjejmë të shprehur se studentët gjithashtu inkurajohen të bëjnë praktikë vullnetare brenda vendit e tyre ose jashtë vendit. Kjo praktikë u konfirmua nga studentët edhe gjatë vizitës në Institucion ku u shprehën se gjatë këtyre praktikave, apo internship-eve, ishin ndjerë të përgatitur nga ana teorike dhe profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>GVJ konstaton se organizimi i veprimtarisë mësimore vjetore të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin EPOKA shtrihet në tre vite akademike secili me nga dy semestra që kanë kohëzgjatje normale 14 javë. Programi i plotë shtrihet në 6 semestra, në të cilin trajtohen lëndët të cilat janë të vlerësuara me kredite sipas sistemit evropian, ECTS.</p> <p>Programi i studimit ofron gjashtë lëndë në çdo semester akademik me 4 / 5 / 6 ECTS për secilën lëndë për pesë semestrat e parë të studimeve. Në semestrin e gjashtë studentët marrin pesë lëndë, duke përfshirë edhe projektin e diplomimit ose provimin e përgjithshëm gjithëpërfshirës dhe ECTS janë gjashtë për secilin. Praktika mësimore është lëndë e detyrueshme me 5 ECTS e ofruar në semestrin e pestë, kurse mbrojtja e temës së diplomës ose dhënia e provimit gjithëpërfshirës bëhen në përfundim të semestrit të gjashtë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme</p>	<p>Për këtë kriter, në RVB, Institucioni deklaron se: "Departamenti i Administrimit Biznesit dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative publikojnë në faqen e internetit të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me përmbajtjen e</p>

<p>për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>programeve të studimit që ai ofron. Programi i detajuar i secilës lëndë që përmban ngarkesën e mësimi, orë brenda/jashtë auditorit, orët individuale të studimit, praktikat mësimore etj”.</p> <p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV në pamje të parë vëren se Plani Mësimor (shtojca 2.1) NUK i përmban elementet e kërkuara. Megjithatë, në RVB (në tabelat 10 në shtojcat e tij), jepen të dhëna të kërkuara për të gjitha vitet akademike që nga 2015. Pas vizitës së GVJ në Institucion, ky i fundit dorëzoi dhe u ngarkua ne sistemin e ASCAL, Plani Mësimor me të gjithë elementet e kërkuara.</p> <p>Nga shqyrtimi i informacionit në faqen e internetit të Institucionit, GVJ konstaton se informacioni që jepet në cdo program lëndor përmban elementet e nevojshme, si orët në auditor dhe jashtë tij, frekuentimin e programit, dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Këto forma të kontrollit të njohurive varjojnë në cdo lëndë të vecantë por në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në tabelën 15 në shtojcat e RVB:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 5 – 10%</li> <li>• Plotësimi i detyrimeve (lab/detyra kursi) 10 – 30%</li> <li>• Testimet gjatë vitit 20 – 45 %</li> <li>• Provimi përfundimtar 30 – 60%</li> <li>• <b>Totali 100%</b></li> </ul> <p>Në bazë të Rregullorës së Programit të Studimit, detyrim frekuentimi për nivelin bachelor është 60% e orëve mësimore në auditor, kurse për studentët përfitues të bursës, ky detyrim është 75% e orëve në auditor. Referenca nga faqja e internetit të Institucionit:</p> <p><a href="http://eis.epoka.edu.al/curricula/20/program">http://eis.epoka.edu.al/curricula/20/program</a>  <a href="http://epoka.edu.al/mat/Bussines%20administration/course-description/business-informatics.pdf">http://epoka.edu.al/mat/Bussines%20administration/course-description/business-informatics.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Përsa i përket pranimeve të studentëve në Institucion, në RVB të përgatitur thuhet se “në faqen e internetit dhe në Udhëzuesin e Studentit janë sqaruar në detaje të gjitha informacionet dhe rregullat që lidhen me kriteret e pranimit, transferimin e studimeve, pjesëmarrjen në mësim, provimet, sistemin e notave. Gjithashtu, para fillimit të vitit akademik mbahet java orientuese për studentët për të përcjellë para studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm që ata duhet të dinë në lidhje me universitetin, rregulloret e tij dhe programin e tyre të studimit”.</p> <p>GVJ shqyrtoi të dhënat e bëra publike në faqen e internetit të Institucionit dhe konstatoi se si kusht pranimi në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është diploma e shkollës së mesme me një mesatare të paktën 7 ose ekuivalente e saj si edhe niveli B1 i gjuhës angleze në një nga provimet e njohura (Cambridge, IELTS, etc), me përjashtim të rasteve kur student ka përfunduar shkollën e mesme në gjuhën angleze, ku përjashtohet nga detyrimi i fundit për të paraqitur një dokument që dëshmon mbrojtjen e gjuhës angleze.</p> <p>Në lidhje me transferimet dhe ekuivalentimet e studimeve, GVJ shqyrtoi dokumentacionin dhe vëren se Institucioni ka implementuar rregulla të qarta dhe transparente për transferimet (konkretisht lejohen vetëm në semestrin e III dhe të V të studimeve). U shqyrtuan gjithashtu edhe tabelat e RVB (tabela 21), dhe u pyet edhe gjatë vizitës në Institucion duke konfirmuar që për këtë program studimi</p>




	ka pasur 8 transferime në hyrje për studentët e vitit të dytë (në katër vitet e fundit akademike), dhe 2 transferime në hyrje për studentët e vitit të tretë, në vitin akademik 2019 – 2020.								
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar programet lëndore përkatëse të programit të studimit të cilat janë pjesë e dokumentacionit (një model syllabusi gjendet edhe në shtojcat e RVB). Referuar këtyre të dhënave GVJ konstaton se syllabusi i cdo lënde përmban informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me praktikat në auditor, seminarët (nëse ka) dhe orë laboratorit (nëse ka) në përputhje kjo me VKM nr.41 si edhe mënyrën e vlerësimit që ndjek çdo pedagog, e cila varion në një interval të lehtë nga një lëndë në tjetrën. Nota përfundimtare është rezultante e këtyre elementëve të vlerësimit: Provimet + detyra kursi/projekte individuale + pjesëmarrja aktive në procesin mësimor. Një model syllabus si referencë e japim në referencën më poshtë:  <u>BUS 114.pdf</u>								
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Referuar nenit 54 të Statutit të Institucionit, Përgjegjësi i njësisë bazë, pra në këtë rast përgjegjësi i Departamentit të Administrimit Biznesit ka si pjesë të funksioneve të tij edhe kryerjen e hapave të nevojshëm për rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Sipas konfirmimeve në Institucion, përpjekjet për përmirësimin e programit mund të vijnë edhe si iniciativë e pedagogëve të programit.  Si procedurë, rishikimet e programit, ndërmerren në fund të një viti akademik për t'i paraprirë organizimit të punës për vitin në vijim dhe pasi miratohen nga përgjegjësi i departamentit i cili e përcjell në dekanat, finalizon nga Komisioni i Rishikimit të Kurrikulave.  Në Shtojcat e RVB (tabela 11) paraqiten ndryshimet që kanë ndodhur në përmbajtjen e programit të studimit në dhe janë gjithsej 11 ndryshime, të cilat janë kryer përgjithësisht me një frymë të qartë përmirësimi dhe përditësimi të programit të studimit e cila vlerësohet pozitivisht nga ana e GVJ.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi II.4


**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Për këtë kriter, GVJ i është referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Ligji nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, neni 73 pika 1, i cili kërkon që programet e ciklit të parë të studimit, të organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre të jetë tri vite akademike.  GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin EPOKA është i hartuar dhe organizuar në lëndë e module, të

	vlerësuara në kredite, i shtrirë në tre vite akademike me nga 60 ECTS, pra 180 ECTS në total duke mundësuar përmbushjen e këtij kriteri.										
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>Duke gjykuar në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni, (Plani Mësimor i programit të studimit, programet lëndore, baza e literaturës, CV e profesorëve), GVJ mund të shprehet se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, mundëson aftësimin e studentëve me kompetencat e përfshira në programet lëndore dhe pajisjen e tyre me aftësi për t'u punësuar në treg.</p> <p>Të pyetur për shkallën e njohurive dhe aftësive që kishin fituar gjatë studimeve, studentët e programit gjithashtu u shprehën konfidentë për punësim të mëtejshëm në pozicione fillestare pune në fushën e informatikës në biznes.</p> <p>Një tjetër element për t'u vlerësuar në këtë kontekst është edhe mësimdhënia në gjuhën angleze cka lehtëson njohjen e studentëve me terminologjinë teknike e cila në këtë fushë është thelbësore të njihet në gjuhën angleze, si edhe u jep më shumë akses studentëve të mund të punësohen në tregun e punës jashtë vendit, por edhe në kompani të huaja që operojnë në vendin tonë.</p>										
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit që është pjesë e DVV, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në tre vitet akademike spas lëndëve dhe moduleve është përgjithësisht e mirë menduar dhe mundëson kryesisht arritjen e objektivave formuese të programit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. (Objektivat formuese të këtij programi studimi specifik dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional gjenden në programet e vecanta lëndore dhe renditen edhe në RVB të dorëzuar nga Institucioni).										
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.	<p>GVJ pasi shqyrtoi tabelat në RVB si edhe programet lëndore të lëndëve të ofruara në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin EPOKA, konfirmon se këto lëndë ofrojnë nivel përgjithësisht të kënaqshëm në përputhje me profilin dhe fushën e programit. Emërtimi i tyre paraqet ngjashmëri me programe ndërkombëtare të kësaj disipline, sipas njohjes që anëtarët e GVJ kanë me programe studimi ndërkombëtare në fushën e Informatikës Ekonomike.</p> <p>Por, nisur edhe nga diskutimi me studentët e programit, GVJ sugjeron shtimin e gamës së lëndëve me zgjedhje të ofruara për studentët, në mënyrë që ata të përziejdhin në bazë të interesave dhe prirjeve të tyre.</p>										
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Përsa i përket strukturës së programit, në tabelën 13 në shtojcat e RVB gjendet informacion në shkallë të përmbledhur në lidhje me ngarkesën totale të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Nga kjo tabelë shohim elementet e mëposhtme të ngarkesës totale:</p> <table border="0"> <tr> <td>• Leksione / Seminare</td> <td>1.623 orë</td> </tr> <tr> <td>• Seminare</td> <td>64 orë</td> </tr> <tr> <td>• Ushtrime / Laboratore</td> <td>338 orë</td> </tr> <tr> <td>• Kontrolli i vazhdueshëm / praktika në auditor</td> <td>2 orë</td> </tr> <tr> <td>• Praktikë profesionale</td> <td>96 orë</td> </tr> </table>	• Leksione / Seminare	1.623 orë	• Seminare	64 orë	• Ushtrime / Laboratore	338 orë	• Kontrolli i vazhdueshëm / praktika në auditor	2 orë	• Praktikë profesionale	96 orë
• Leksione / Seminare	1.623 orë										
• Seminare	64 orë										
• Ushtrime / Laboratore	338 orë										
• Kontrolli i vazhdueshëm / praktika në auditor	2 orë										
• Praktikë profesionale	96 orë										




	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diploma/ Provim Formimi 48 orë</li> </ul> <p><b>Totali 2.171 orë</b></p> <p><i>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se pavarësisht se emërtoheshin si leksione, në fakt seancat mësimore përfshinin edhe trajtimet e ushtrimeve dhe rasteve dhe ishte fleksibël për t'u organizuar në varësi të lëndës, herë duke i ndarë 1 leksion e 1 seminar, herë 1 leksion e 2 seminare.</i></p> <p>Raporti <b>Teori</b> (leksione) / <b>Praktikë</b> (sem+usht+proj+prakt prof) rezulton 811 orë teori (pra gjysma e orëve leksione+seminare) / 1360 ore, ose afërsisht <b>40% / 60%</b>.</p> <p>GVJ vlerëson pozitivisht peshën e konsiderueshme të orëve të praktikës ku përfshihen seminare, ushtrime, laboratore dhe praktika, por përmendim në mënyrë specifike përqindjen e konsiderueshme që zënë orët e laboratorit në totalin e orëve për programin mësimor (16%) cka është me rëndësi për specifikat që paraqet programi.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në lidhje me periodicitetin e përmirësimit të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit, RVB e përgatitur nga Institucioni referon se ato azhurnohen vazhdimisht nga lektori i lëndës në fillim të cdo semestri.</p> <p>Nga shqyrtimi që GVJ i bëri programeve lëndore të dorëzuara si pjesë e DVV, konstatojmë që ky kriter i lidhur specifikisht me pasurimin e literaturës së detyruar dhe ndihmëse që të jetë e 5 viteve të fundit përmbushet pjesërisht, pasi në disa raste u ndeshën edhe tekste të para pesë viteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Statistics I &amp; II, BUS 201 &amp; BUS 202, e vitit 2011.</li> <li>• Business Law, BUS 203, e viteve 2011 dhe 2013.</li> <li>• Marketing I, BUS 221, e vitit 2011.</li> <li>• Human Resource Management, BUS 335 e vitit 2011.</li> <li>• Web Programming, CEN323, e vitit 2012</li> </ul> <p>Janë vetëm disa nga shembujt që ndeshëm.</p> <p>Sugjerojmë përditësim në literaturë të të gjitha lëndëve pasi që Institucioni disponon marrëveshje bashkepunimi me shtëpi botuese prestigjioze të cilat kanë publikime cilësore të viteve të fundit për të njëjtët tituj dhe autorë.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në analizën e tërësisë së programeve lëndore për të tre vitet, si edhe ndryshimeve të vazhdueshme të bëra në përmbajtjen e tij, GVJ arrin në përfundimin se në përgjithësi përmbajtja e programit të studimit, përsa i përket lëndëve, kombinimit të tyre mes dy disiplinave ekonomike dhe informatike si edhe raportit teori / praktikë mundëson kryesisht përfundimin e dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave teknike të synuara për një program të ciklit të parë.</p> <p>Përsa i përket aftësive teknike në profesion, syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi paraqiten të kompletuara.</p> <p>Programet lëndore: <a href="#">BINF_Syllabuses_signed_and_sealed.pdf</a></p>




<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri syllabuseve të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike për të tre vitet konstaton se në vija të përgjithshme përmbajtja e programit të studimit mundëson si vijimin e mëtejshëm të studimeve (në programe brenda dhe jashtë vendit pasi sic u tha më lart, ka ngjashmëri me programe ndërkombëtare), ashtu edhe punësimin e menjëhershëm të studentëve në kompani vendase dhe të huaja brenda vendit.</p> <p><i>Megjithatë, në elemente të veçanta, programi mund të pasurohet në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve që ofron, dhe sidomos në gamën e lëndëve me zgjedhje në përbërjen e tij. Këto elemente do të përgatishin edhe më shumë studentët si për tregun e punës ashtu edhe për vijimin e mëtejshëm të studimeve.</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni specifikohet se lektorët e programeve së bashku me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar të Universitetit (ZPKSD) ruajnë marrëdhëniet e tyre me të diplomuarit e programit dhe përpiqen të marrin përshtypjet e tyre mbi rezultatet e fituara nga programi i studimit, sidomos duke pasur në fokus mënyrën se si ato përshtaten me praktikën reale të biznesit. Një çështje e tillë u paraqit edhe gjatë diskutimeve më përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës gjatë vizitës në Institucion, ku ata theksuan përkjekjet e tyre për “të gjurmuar” të diplomuarit qoftë nëpërmjet adresave email, por edhe nëpërmjet rrjeteve sociale.</p> <p><u>Shtojca 17. Study Of The Labor Market after the Exit of the Students.pdf</u></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.5. Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni në këtë kriter referohet se programi punëson një personel akademik cilësor në numër adekuat për të dhënë efektivisht kurrikulën dhe për të përmbushur kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar si edhe gjatë vizitave në Institucion konstaton se njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike është Departamenti i Administrim Biznesit por në mësimdhënie në këtë program studimi angazhohen edhe pedagogë nga njësi të tjera të Institucionit, si nga Fakulteti i Inxhinierisë.</p> <p>Nga shqyrtimi i tabelave me të dhëna, (dhe konkretisht tabelat 6 në shtojcat e RVB), konstatohet se Institucioni përmbush kërkesat ligjore në fuqi dhe më konkretisht, kërkesat e VKM Nr. 418, viti 2017, pasi Personeli Akademik Efektiv përballon më shumë se 70% të orëve mësimore të këtij programi studimi, ndërsa Personeli akademik me kontratë angazhohet në më pak se 30 % të orëve mësimore të programit të studimit (përjashtim bën vetëm viti 2015 – 2016 dhe viti 2019 – 2020, ky i fundit me një shmangie të parëndësishme nga niveli i kërkuar.</p>



Në mënyrë më të detajuar dhe referuar të dhënave (tabela 6, shtojcat e RVB), më poshtë jepet përbërja e stafit akademik për vitet akademike që nga akreditimi i fundit në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike:

- Për vitin akademik 2020 – 2021, kanë dhënë mësim dhe / ose janë planifikuar të japin mësim 29 pedagogë nga të cilët 23 PAE dhe 6 PAK (në raportet 79%/21%)
- Për vitin akademik 2019 – 2020 kanë dhënë mësim 30 pedagogë nga të cilët 20 PAE (ka një lapsus të vogël tek tabela 6.5 ku shënohen 19 dhe jo 20 PAE) dhe 10 PAK (në raportet 67%/33%)
- Për vitin akademik 2018 – 2019 kanë dhënë mësim 36 pedagogë nga të cilët 25 PAE dhe 11 PAK (70%/30%)
- Për vitin akademik 2017 – 2018 kanë dhënë mësim 31 pedagogë nga të cilët 22 PAE dhe 9 PAK (71%/29%)
- Për vitin akademik 2016 – 2017 kanë dhënë mësim 29 pedagogë nga të cilët 21 PAE dhe 8 PAK (72%/28%)
- Për vitin akademik 2015 – 2016 kanë dhënë mësim 22 pedagogë nga të cilët 13 PAE dhe 9 PAK (60%/40%)

Stafi akademik i programit të studimit	2020 – 2021		2019 – 2020		2018 – 2019	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1		2		1	
Prof.As.Dr	2	2	4	3	2	2
Dr/PhD	11	1	8	3	15	3
Msc	9	3	6	4	7	6
Total	23	6	20	10	25	11

Stafi akademik i programit të studimit	2017-2018		2016 – 2017		2015 – 2016	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1	1			
Prof.As.Dr	4	2	3	1	1	1
Dr/PhD	9	2	6	2	7	1
Msc	8	4	11	5	5	7
Total	22	9	21	8	13	9



Megjithatë, për vitet 2015 - 2016 dhe 2019- 2020, vitet kur konstatohet se PAE ka një % më të ulët se 70% të stafit akademik gjithsej, GVJ ka shqyrtuar edhe raportin e orëve mësimore që kryhen nga PAE kundrejt orëve që kryhen nga PAK për këtë program studimi. Referencë: Tabelat 12 në RVB.

Sipas kësaj analize GVJ konstaton respektivisht:

**Për vitin 2015 – 2016**, PAE realizojnë gjithsej 1744 orë mësimore kurse PAK 800 orë mësimore nga 2544 orë në total që ka plani mësimor; pra orët e realizuara nga PAE dhe PAK qëndrojnë në raportin (69%/31%) duke përmbushur kështu kërkesat e VKM Nr. 418.

**Për vitin 2019 – 2020**, PAE realizojnë gjithsej 3552 orë mësimore kurse PAK 960 orë mësimore, në total 4512 orë; pra orët e realizuara nga PAE dhe PAK qëndrojnë në raportin (78 % / 22 %) duke përmbushur kështu kërkesat e VKM Nr. 418.

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vuri re se një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, kishte grada e tituj dhe një pjesë e vogël ishin me titullin Master Shkencor, Msc. (referim edhe të dhënat e detajuara të raportuara në kriterin më lart).</p> <p>Nga shqyrtimi i CV të tyre, sfondi i formimit akademik, por jo vetëm (edhe ai praktik dhe kërkimor i personelit) i personelit shfaqet në përgjithësi, në përputhje me angazhimin e tyre në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i të dhënave të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, të angazhuar në realizimin e programit të studimit, GVJ mund të shprehet se fokusi profesional dhe formimi e niveli akademik dhe kërkimor i tyre është i kënaqshëm dhe i mjaftueshëm për të garantuar mbulimin e programeve dhe moduleve mësimore të programit të studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV të personelit u konstatua se ata i kanë fituar gradat shkencore dhe / ose titujt në disiplina që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me programin e studimit si menaxhim, marketing dhe inxhinieri kompjuterike.</p> <p>U vu re gjithashtu se personeli akademik në program merr pjesë në projekte shkencore, realizon kërkime shkencore dhe ka botime të konsiderueshme në konferenca dhe revista shkencore të fushave përkatëse (ekonomi dhe inxhinieri kompjuterike).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni, si edhe të dhënat në DVV dëshmojnë shumë marrëveshje të nënshkruara me biznese dhe institucione të ndryshme me qëllim kryerjen e praktikave mësimore. Në tabelën 5 në shtojcat e RVB, listohen Institucionet me të cilat Universiteti EPOKA ka marrëveshje bashkëpunimi, por jo të jitha për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p>GVJ, gjatë takimit me studentët konfirmoi mënyrën e instruktimit dhe udhëheqjes së tyre gjatë procesit të përgatitjes së diplomës dhe praktikës profesionale. Në lidhje me punimin e temës së diplomës Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar të cilën e referon në Rregulloren Themelore. Gjatë vizitës në Institucion (prill 2021), GVJ u informua se studentët e vitit të tretë kishin filluar të përgatiteshin për procedurat e diplomimit dhe se ishin të mirë instruktuar për këto procedura, qoftë për provimin e përgjithshëm, ose për përgatitjen e punimit të diplomës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga ana e GVJ gjatë vizitës në Institucion u vu re se orët mësimore të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin EPOKA, ofrohen në klasa të pajisura në mënyrë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor (tabela shënimesh, projektor, kompjuter PC në cdo sallë dhe softuerë përkatës). Me përjashtim të vitit të fundit akademik kur mësimi është zhvilluar online, dhe ku është përdorur “<i>multisim</i>” pasi vetë programi i studimit është dizenuar i tillë që kërkon angazhim të lartë në orë laborator. Me këtë mjet, pedagogët shprehen se arrijnë t’i mbajnë studentët të angazhuar në procesin mësimor.</p>






	Gjithashtu nga shqyrtimi i të dhënave të raportuata në RVB dhe konfirmuar në vizitë në Institucion, GVJ konfirmon se personeli akademik i programit të studimit punon me personel ndihmës akademik për realizimin e seminareve dhe orëve të zgjidhjes së ushtrimeve që realizohet në ambientet e universitetit. Personeli ndihmës akademik është shtuar ndjeshëm vitin e fundit akademik 2020 – 2021 (nga 1 që ishte një vit më parë në 7). Aktivitetet që kryhen nga personeli ndihmës akademik sipas konfirmimit që u krye në Institucion janë: mbështetja e lektorit të lëndës gjatë kohës së mësimdhënies me aktivitete integruese dhe të bazuara në praktikë, u komunikojnë studentëve materialet e lëndës, marrin nënshkrimin e listëprezencës së studentëve dhe ndjekin leksionet në klasë, në mënyrë që ata të kuptojnë atë që studentët duhet të dine, administrojnë materialet mësimore për këtorin dhe studentët, etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Sipas raportimit në RVB, konstatohet se Institucioni kujdeset të kushtojë vëmendjen e nevojshme cilësisë dhe inovacionit në mësimdhënie (Strategjia e Universitetit “EPOKA” 2018-2022).  Në RVB, raportohen gjithashtu trajnime të vazhdueshme nga Komisioni i Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, trajnime që konfirmohen edhe nga vetë stafi akademik. Për shembull, gjatë vitit akademik të fundit stafi ishte angazhuar në trajnime për përdorimin e platformës HyFlex e cila mundëson një mësimdhënie të integruar online për të ofruar sa më shumë lehtësira për studentët.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Duke shqyrtuar dosjen e dokumentacionit GVJ konstaton se janë tre elemente që janë implementuar nga Institucioni në cilësinë e mekanizmave të monitorimit për të kontrolluar aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik:  1. Sipas Statutit të Institucionit përgjegjësia kryesore për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies është Përgjegjësi i Departamentit i cili në fund të çdo semestri analizon punën e stafit. Në rast të situatave specifike, Përgjegjësi i Departamentit kontakton në momentin e parë me personelin akademik për t'i përcjellë reagimet. Raporti i përgatitur

	<p>nga Përgjegjësi i Departamentit më pas dorëzohet në Fakultet dhe pastaj i përcillet Rektoratit.</p> <p>2. Anketa që në fund të çdo semestri u shpërndahet studentëve përmes sistemit EIS, e cila kërkon vlerësimin e lektorit dhe strukturën e secilës lëndë. Këto të dhëna pasi mblidhen rezultatet i përcillen Zyrës së Rektorit nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë, e cila nga ana tjetër ndërmerr veprimet përkatëse korrigjuese ose planet e përpunuara për përmirësimin e mësimdhënies.</p> <p>3. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë i cili përbëhet nga të paktën 8 anëtarë (akademikë dhe administrativ) të cilët, ndër të tjera, bëjnë vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive arsimore dhe kërkimit shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Sic u përmend në kriterin 2 më lart, studentët përbëjnë një ndër elementet që aktivizohen si mekanizma monitorimi të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ diskutoi me studentët në lidhje me përfshirjen e tyre në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies dhe konfirmoi me ta se ata ishin vërtet pjesë e rregullt dhe e vazhdueshme e këtij procesi. Gjithashtu GVJ konstatoi se studentët përfshiheshin edhe në procedura të vlerësimit të komponentëve të tjerë të jetës universitare përtej mësimit dhe vlerësimit të dijeve.</p> <p>Shtojca 6.16 në DVV paraqet një model pyetësori për studentët në lidhje me kënaqësinë e tyre për elemente si aktivitetet ekstrakurrikulare, ambientet, biblioteka, sekretaria mësimore, transporti, ushqimi etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Për këtë kriter në RVB deklarohet se ka të dhëna në faqen e internetit të Institucionit, por informacionet që gjenden duke ndjekur referencat e dhëna, janë raporte të vlerësimit të brendshëm në kuadrin e akreditimeve të ndryshme dhe jo çfarë kërkon konkretisht ky kriter.</p> <p>GVJ nga shqyrtim e bëra, konstaton se rezultatet e vlerësimit publikohen në Raportin Vjetor të Institucionit, në shkallë të përmbledhur dhe jo specifike për programin e studimit. Raporti Vjetor është publik dhe gjendet në faqen e internetit të Universitetit EPOKA.</p> <p>Gjithashtu nga dokumentat e dorëzuar në DVV, u konstatua se Institucioni aplikon pyetësorë të vlerësimit të kënaqësisë në punë edhe për personelin akademik (shtojca 6.17 në DVV), mbështetur në pyetësorë të ngjashëm të realizuar më parë nga ASCAL në akreditimet e mëparshme, por nuk u gjetën rezultate për t'u diskutuar nga këto pyetësorë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në RVB e hartuar nga Institucioni referohet se Institucioni nxit dhe inkurajon përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, materiale dhe njoftime për të cilat gjenden edhe në DVV. Universiteti ofron mbështetje financiare edhe për anëtarët e personelit akademik për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe ngjarje të tjera shkencore sipas disa procedurave të mirëpërcaktuara (shtojca 3.7.9 – Direktiva për Promovimin e Publikimeve Shkencore e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2009).</p> <p>Për kërkimin shkencor dhe për pjesëmarrje në konferenca ka buxhet dhe gjithashtu për artikuj të publikuar, në varësi të cilësisë së publikimit dhe</p>

	<p>indeksimit të revistës apo konferencës ka një shpërblim që jepet nga Institucioni. Nxitja e cilësisë në kërkim nga personeli akademik shihet nga GVJ si një faktor që kontribuon drejtpërdrejt në rritjen dhe përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>Institucioni, konfirmuar edhe nga dokumentacioni, nxit studentët e doktoratës në projekte me fonde të brendshme (shtojca 3.7.9.b në DVV).</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Si rregull i përgjithshëm Universiteti Epoka aplikon si forma të zakonshme mësimdhënie leksionet, detyrat e kursit, esetë, projektet, praktikat profesionale (referuar sipas dokumentacionit të dorëzuar nga ana e Universitetit Epoka).</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, si edhe e dosjes së programeve lëndore, por edhe nga konfirmimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program specifik janë leksionet, orët e laboratorit, detyrat e kursit/esetë dhe praktikat profesionale.</p> <p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni referohet gjithashtu se përveç elementeve të mësipërme të realizimit të programit mësimor, Departamenti i Administrim Biznesit organizon udhëtime ose seminare në mbështetje të procesit mësimor. Disa nga këto aktivitete organizohen në kuadër të ndonjë lënde të caktuar dhe pasqyrohen në programin lëndor (p.sh. vizitat nëpër kompani), ndërsa disa aktivitete të tjera që mund të jenë më ndërdisiplinore organizohen nga departamenti dhe pasqyrohen në planin vjetor të veprimtarisë së departamentit.</p> <p>Referenca: <a href="#">Plani Mësimor i Programit të Studimit. Curricula BA BINF.pdf</a></p> <p><a href="#">Syllabus: BINF_Syllabuses_signed_and_sealed.pdf</a></p> <p><a href="#">BA BINF PROGRAM PROFILE.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe takimit me personelin akademik dhe me studentët, GVJ formoi përshtypjen se personeli akademik mendohej të ofronte sa më shumë raste praktike gjatë orëve mësimore dhe gjatë laboratoreve si dhe të trajtonin situata sa më aktuale në fushën e informatikës së biznesit. Kur krijohej mundësia ishin organizuar edhe vizita studimore pranë kompanive të ndryshme apo ishin ftuar lektorë të jashtëm për të organizuar workshop-e. Kjo larmi dhe kombinim i metodave të ndryshme të mësimdhënies mundëson nxitjen e angazhimit nga ana e sa më shumë studentëve.</p> <p>Po kështu edhe studentët u shprehën në përgjithësi konfidentë në lidhje me metodat e mësimdhënies që përdorshin me ta dhe konfirmuan që alternimi i leksioneve me laboratorët dhe rastet praktike i kishte inkurajuar gjatë studimeve</p>

	të tyre. Ata gjithashtu përmendën fleksibilitetin e ndërtimit të orëve mësimore, ku mendimi i tyre merrej parasysh dhe reflektohej nga pedagogët.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Në RVB të përgatitur nga Institucioni deklarohet se Universiteti EPOKA mbështet personelin e tij akademik për përmirësimin e kompetencave didaktike duke i përfshirë në trajnime që i aftësojnë ata në fushën akademike dhe kjo u konfirmua nga ana e GVJ gjatë diskutimeve me pedagogët e Institucionit.  Në nivel të njësisë bazë, Departamenti i Administrimit Biznesit organizon vizita në njësi ekonomike të ndryshme, ose ëorkshope me qëllimin e mbështetjes së procesit mësimor dhe asistencën e studentëve për të parë nga afër ambientet e punës në kompani dhe në terren. Departamenti ka organizuar disa aktivitete me përfaqësuesit e industrisë për të kuptuar më mirë pritshmëritë e tregut nga akademia në mënyrë që të ofrojë një metodologji më konkurruese dhe moderne të mësimdhënies. Informacioni për këto aktivitete dhe prezantime gjendet e raportuar në RVB por konfirmohe nga GVJ edhe në faqen e internetit të Institucionit.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Pavarësisht se orët në klasë, Institucioni i konsideron të gjitha si leksione në Planin Mësimor, nga GVJ u konstatua në të vërtetë gjatë diskutimeve me stafin se lektorët përfshijnë në klasat e tyre përdorimin e programeve profesionale, diskutimet në klasë, debatet, ligjëratat e hapura, studimet e cështjeve, prezantimet me gojë, projektet dhe esetë. Përsa i përket kompetencës së personelit akademik, studentët e programit të studimit u shprehën të kënaqur me nivelin akademik dhe aftësitë didaktike të demonstruara nga ana e pedagogëve si edhe me fleksibilitetin e tyre sidomos në kushtet e fundit të mësimdhënies online.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Sipas RVB për këtë kriter, procesi i vlerësimit të pedagogëve përfshin edhe studentët nëpërmjet pyetësorëve të cilët ata i plotësojnë në mënyrë elektronike dhe anonime në fund të çdo semestri. Anketa e Vlerësimit të Instrukturëve të Lëndës zhvillohet në baza semestrale. Ajo aktivizohet në sistem një muaj para fillimit të provimeve përfundimtare dhe mbyllet para shpalljes së notave përfundimtare të lëndës në sistem. Ky process vlerësimi i konsiderua si më i miri i mundshëm nga stafi i Institucionit, pasi studentët inkurajohen të japin opinionin e tyre para zhvillimit të provimit, kurse stafi pedagogjik vihet në dijeni të rezultateve të pyetësorëve, vetëm pasi ka vlerësuar me nota studentët.  GVJ konfirmoi gjithashtu me studentët, gjatë vizitës në Institucion, se ata inkurajohen të japin sugjerimet e tyre jo vetëm për nivelin e mësimdhënies së pedagogëve por edhe mbi kriteret e vlerësimit të kursit para se kjo e fundit të finalizohet në sistem (d.m.th. java e parë e semestrit përkatës kur bëhet edhe prezantimi i syllabuseve).
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	GVJ vëren se në Planin Mësimor të Programit të Studimit ka kryesisht leksione dhe pak ose aspak seminare. Ndërsa në RVB deklarohet se nga të gjithë lektorët ndiqet një qasje komunikimi e dyanshme e këtij programi studimi. Në takimin me stafin akademik disa nga pedagogët e angazhuar në këtë program, u shprehën se ata organizojnë studentët në grupe pune dhe i angazhojnë ata në diskutime mes njëri tjetrit. Gjithashtu, për të siguruar zbatimin me sukses të një procesi të tillë, aktivizimi i lartë gjatë orëve të mësimi përfaqëson një peshë domethënëse në vlerësimin total të shumicës së lëndëve. Në këtë mënyrë




	efektiviteti i procesit është më i lartë, dhe studentët përfitojnë duke shkëmbyer ide dhe mendime.			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Bazuar në pyetjet drejtuar studentëve të programit të studimit GVJ konstaton se një ndër format e mësimdhënies të zbatuara nga pedagogët e Institucionit ishte nxitja e studentëve që të merrnin pjesë aktive gjatë procesit. Personeli akademik i nxiste studentët të reflektojnë gjatë mësimdhënies, duke i caktuar secilit përgjegjësi të qarta për detyra specifike. Kështu studentët promovohen që të fitojnë aftësi shprehëse dhe argumentuese edhe në debatin mes njëri tjetrit.  Në përgjithësi GVJ formoi opinionin se kjo metodë mësimdhënie, inkurajon të menduarin e pavarur dhe kritik nga ana e studentëve si edhe i bën ata më të hapur dhe të aftë të artikulojë lirisht opinionet e tyre.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.3



**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike te nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit, studimit të faqes së internetit dhe sidomos gjatë konstatimeve gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Universiteti EPOKA ofron mjedise me infrastrukturën e nevojshme, (ndricim, sistem kondicionimi, ujë, wireless, bibliotekë për të lexuar apo studiuar dhe laboratorë) për të realizuar procesin mësimor. Këtu nuk bën përjashtim as programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p>Ambientet ishin të monitoruara me sistem kamera për të garantuar sigurinë e studentëve dhe stafit. Monitorimi respektonte një rregullore të posaçme të krijuar për këtë qëllim, e cila synonte edhe respektimin e privatësisë së studentëve. (shtojca 3.6.4 në DVV)</p> <p>Largësia e kampusit nga qyteti dhe qendrat e banuara është një çështje që nuk mund të anashkalohet por për të cilën Institucioni ka menduar si zgjidhje duke ofruar transport urban për studentët dhe stafin akademik dhe administrativ.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Në Universitetin EPOKA klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për të bërë funksional në tërësi procesin mësimor, si kompjutera, projektorë, tabela shënimesh Smart, etj. Kompjuterët në klasë dhe kompjuterët e vendosur në laboratorë përmbanin softuerët e nevojshëm, programet dhe paketat e nevojshme softuerike në lëndë specifike të këtij programi studimi. Gjatë kushteve të zhvillimit të mësimin online, pedagogët kishin mundësuar shfrytëzimin në remote të laboratoreve nëpërmjet paketave “multisim”, si një mundësi e përafërt për të angazhuar studentët.
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme	Në ambientet e Institucionit u verifikua se funksionon rrjeti wireless ku ka akses cdo student, personela akademik dhe guest jo vetëm nga ambientet e Universitetit por edhe jashtë tij. Paketat softuerike të përdorura për qëllime të

<p>për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>mësimdhënies janë Windows, MS Office, Adobe Reader, të mundësuar në platformën LMS.</p> <p>Studentët si rregull pajisen me adresë emaili në domain-in epoka.edu.al, e cila është me bazë në platformën Google dhe u ofron studentëve fleksibilitet në menaxhimin e burimeve mësimore. Institucioni ka funksional systemin e vet LMS të menaxhimit të mësimin, të quajtur EIS (Epoka Interactive System) i cili mundësonte realizimin e funksioneve të nevojshme të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore, GVJ konstatoi se në pothuajse të gjitha lëndët ofrohen tituj të larmishëm në literaturë (të detyrueshëm dhe të sugjeruar) në dispozicion të studentëve. Tekstet janë në përgjithësi prestigjioze dhe tituj të respektuar në fushat përkatëse. Sugjerimi i GVJ është vetëm përditësimi i tyre me botime të viteve më të fundit, të paktën nga ana formale në programet lëndore.</p> <p>Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, studentët u shprehën se literatura është e zgjeruar dhe atyre u vendosen në dispozicion tekstet e plota elektronike nga ana e pedagogëve.</p> <p>Konfirmimi i literaturës fizike në bibliotekë nga ana e GVJ mbështet konstatimet se titujt e vënë në dispozicion të studentëve nuk mungojnë për ofrimin e dijeve në këtë program studimi.</p> <p>Përveç teksteve akademike, vlen të përmendet këtu edhe aksesit që Institucioni ka në burime kërkimore si JSTOR, por të pyetur studentët e programit të studimit u shprehën që burime të kësaj natyre i kishin përdorur më rrallë sesa burimet teorike, si tekstet akademike, ç'ka është e kuptueshme për studentë të nivelit bachelor.</p> <p>Nga ana tjetër, pedagogët u shprehën se i përdorin gjerësisht burimet elektronike për të përgatitur punime kursi për studentët.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni gjendet informacioni se Biblioteka e Universitetit EPOKA ka kapacitet 100 vende, sipërfaqe 400 metra katrorë në përdorim dhe ka rreth 25.000 tekste fizike.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se biblioteka ka vërtet hapësira të përshtatshme për përdorim nga studentët. Materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave apo prenotimeve të studentëve sic u specifikua nga stafi që punonte aty. Vetë biblioteka e kampusit përdor një sistem informacioni i quajtur KOHA, dhe që mundëson menaxhimin e burimeve në bibliotekë.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sipas RVB dhe sipas deklaratave të përfaqësuesve të stafit akademik, universiteti EPOKA ka akses në bibliotekat online si JSTOR, dhe disa burime të tjera të shfrytëzueshme në internet si: Bio One, Cambridge Journals Online, Ebrary Academic Complete, EBSCO Academic Search Complete, Emerald Management e-Journal Collection, IOP Science, Multi-Science Journals Collection, OECD eLibrary, Oxford English Dictionary Online, Oxford Reference Online, ProQuest Central, Taylor &amp; Francis Library, Web of Knowledge.</p>




	Aksesi është vjetor në përputhje me kontratat e nënshkruara nga Institucioni.
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	<p>Në RVB specifikohet se për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, kur është e aplikueshme, lëndët hartohen në mënyrë të tillë që studentët të kenë dy orë teori dhe dy orë seancë laboratorit cdo javë sepse kështu ata mund të marrin përvojë praktike. Kjo nënkupton një nevojë të lartë për burime laboratorike për këtë program studimi dhe GVJ konfirmoi se studentët e Universitetit “EPOKA” kanë akses të pakufizuar në tre laboratorë kompjuterikë, në rrjete interneti wifi; dhe softuerët e nevojshëm.</p> <p>Pavarësisht situatës së mësimdhënies online, pedagogët, sic u konfirmua gjatë vizitës në Institucion, kishin mundur të përshtasin shfrytëzimin e softuerëve nëpërmjet paketave “multisim” duke lehtësuar shfrytëzimin e këtyre burimeve.</p>
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik dhe studentët për përdorimin e tyre.	<p>GVJ bazuar në shqyrtimin e DVV, si edhe konfirmuar gjatë vizitës në Institucion konstaton se Universiteti EPOKA përdor një kombinim të platformave të rëndësishme në funksion të mësimdhënies. Elementët e mëposhtëm garantojnë një mbulim të mjaftueshëm të të gjitha dimensioneve të nevojave për procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Platforma Learning Management System (LMS) me bazë në Moodle për koordinimin dhe organizimin e lëndëve online dhe për mirëmbajtjen e burimeve për cdo lëndë.</li> <li>2. Softuerin Turnitin që ndihmon përdoruesit të kuptojnë dhe shmangin plagjiaturën dhe të zhvillojnë të kuptuarit e tyre se si të citojnë burimet si pjesë e një argumenti akademik. Kjo paketë është shumë e rëndësishme jo vetëm për personelin akademik për vlerësimin e studentëve, por edhe për këta të fundit që të disiplinohen në punën vetiake të tyre.</li> <li>3. Sistemi i Automatizimit të Bibliotekave (Koha) që është një sistem i integruar i bibliotekave me burim të hapur. Koha është e bazuar në faqe uebi, kështu që nuk ka softuer për ta instaluar në kompjuterët desktop.</li> <li>4. Google Classroom për të aksesuar, koordinuar dhe organizuar materialet e lëndës në cloud, sidomos gjatë perudhës së fundit të mësimdhënies online.</li> <li>5. Webmail për shërbimet e edukimit dhe të gjithë studentëve dhe personelit akademik dhe administrativ pajisen me një adresë emaili nën domainin epoka.edu.al i cili është një llogari Google.</li> <li>6. HyFlex – në kushtet e mësimdhënies online, kjo platformë mundëson menaxhimin e mësimin nga auditori.</li> </ol>
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	<p>Universiteti Epoka përdor sistemin e informacionit EIS (Epoka Interactive System) i cili është një sistem interaktiv online ku përdoruesit mund të regjistrohen duke përdorur llogarinë e emailit. Ky sistem sigurisht përdoret edhe për studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p>EIS është një sistem modular i organizuar nga role dhe njësi përkatëse në universitet që ofron shumë funksionalitet edhe për personelin akademik edhe për studentët (por edhe për stafin ndihmës akademik dhe atë administrative). Personeli akademik ka akses në informacione rreth lëndëve aktuale dhe atyre të caktuara më parë. Ata mund të përditësojnë programin lëndor, të shohin pjesëmarrjen e studentëve në mësim, të vendosin dhe të finalizojnë nota, etj.</p>





	<p>Kurse studentët, mund të përdorin të dhënat e tyre personale dhe informacionin që lidhen me programin e tyre të studimit, mund të regjistrohen në lëndë, mund të shikojnë veprimtarinë akademike të vazhdueshme të lëndëve të regjistruara gjatë semestrit, të kontrollojnë pjesëmarrjen, datat e provimit, notat e përkohshme dhe notat përfundimtare. Gjithashtu, në sistem, ata mund të aksesojnë kurrikulën e programit, listën e notave, llogaritjen e notave, programin javor, kërkesat dhe njoftimet, etj.</p> <p>Nga intervistat e zhvilluara me personelin akademik dhe me studentët u mësua se sistemi EIS ishte gjerësisht i përdorur nga të dyja palët për të mirë koordinuar hapat gjatë semestrit, si materialet mësimore, vlerësimet gjatë vitit dhe ato përfundimtare, etj.</p>								
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit (shtojca 3.5.1 në DVV, neni 16), GVJ konstatoi se studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike të cilët kanë një mesatare mbi 3 (GPA) mund të zgjedhin të përgatisin projektin e diplomimit. Kjo ndodh në semestrin e gjashtë dhe të fundit të studimeve. Projektet e diplomimit mbulojnë tema kryesisht në fushat e studimit Biznes dhe Inxhinieri Informatike, të cilat specifikohen pas konsultimeve të vazhdueshme të studentëve me mbikëqyrësit.</p> <p>Cdo mbikëqyrës i caktuar për projektet e diplomimit organizon të paktën dy takime/prezantime me studentët pra arrin të ndjekë ecurinë e studentëve gjatë përgatitjes së projektit të diplomës. Gjatë prezantimit të pare që ndodh në fillim të semestrit, studentët japin një propozim dhe marrin sugjerime mbi temat e zgjedhura, ndërsa gjatë prezantimit të dytë studentët prezantojnë një përmbledhje të rishikimit të literaturës dhe metodologjisë së studimit të tyre, si dhe rezultateve nga analiza e tyre.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV, GVJ konstatoi se Institucioni ka orientime të shkruara për procedurën e përcaktimit të përzgjedhjes së temave të diplomave (shtojca 3.8.1 në DVV); për ecurinë e përgatitjes së temës së diplomimit (shtojca 3.8.1.b) dhe për formatin e përgatitjes së tezës së diplomimit (shtojca 3.8.1.c). Në shtojcën 3.8.4 të DVV jepet informacion në lidhje me shpërndarjen e numrit të studentëve mes përgatitjes së temës së diplomës dhe provimit përfundimtar gjithëpërfshirës.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Në përmbushje</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentacionin pjesë e DVV, konstaton ngritjen e dy strukturave të cilat bashkëpunojnë për promovimin e përmirësimin të vazhdueshëm dhe garantimin e cilësisë së mësimdhënies në Universitetin Epoka.</p>

<p>dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Senati Akademik i Universitetit ka krijuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë.</li> <li>2. Zyra e Brendshëm e Sigurimit të Cilësisë (ZBSC)</li> </ol> <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) dhe Zyra e Brendshëm e Sigurimit të Cilësisë (ZBSC) përbëjnë Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë të Universitetit (Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Manualit të Sigurimit të Cilësisë KPSC; Manuali i Sigurimit të Cilësisë të Universitetit Epoka). Universiteti identifikon ndryshimet për të siguruar suksesin e vazhdueshëm të programit të studimit edhe përmes rishikimit vjetor të performancës së programit të studimit, si edhe shqyrtimit të anketave të vlerësimit nga ana e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Sipas Politikës "Për përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit, (shtojca 1.15 në DVV), GVJ konstaton se departamenti është njësia bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron, që nga përzgjedhja e personelit akademik që angazhohet në mësimdhënie, pajisja e tyre me burimet e nevojshme përkatëse e deri tek shpërndarja optimale e ngarkesës mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Referuar RVB të përgatitur nga Institucioni në këtë kriter shihet se Universiteti Epoka është i interesuar të punësojë personel të larmishëm akademik, nga vende prejardhje dhe kultura, të ndryshme, duke pasuruar kështu programet me metoda të reja mësimore.</p> <p>Departamentet mirëpresin sugjerimet e lektorëve në lidhje me metodat inovative të mësimdhënies dhe pozicionohen në mbështetje maksimale për stimuj dhe qasje të tilla. Të pyetur për këto qasje, kjo u konfirmua edhe nga stafi akademik gjatë vizitës në Institucion.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i materialeve të dorëzuara si pjesë e DVV, konstatohet nga ana e GVJ se raportohet që personeli akademik kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor sidomos duke u inkurajuar të marrin pjesë në projekte shkencore (shtojca 3.2 në DVV).</p> <p>Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare, në projekte si dhe botime shkencore të stafit gjenden në tërësinë e dokumentacionit të dorëzuar dhe sikurse është referuar edhe më lart në këtë raport, kjo praktikë mbështetet financiarisht nga ana e Institucionit, mbështetje që përshkallëzohet sipas suksesit dhe cilësisë që demonstroi cdo pedagog.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Një nga objektivat kryesore të Universitetit është edhe përmirësimi i vazhdueshëm i veprimtarive mësimdhënëse dhe mësimnxënëse si dhe adoptimi i metodave inovative sic referohet në dokumentin e Politikës së Përmirësimit të Vazhdueshëm të Programeve të Studimeve (shtojca 1.15). Në funksion të kësaj përjasjeje, në DVV raportohen trajnime të ndryshme të stafit si për pjesën kërkimore, ashtu edhe për atë akademike (shtojca 3.9).</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion dhe takimeve me stafin GVJ mësoi se ata angazhohen në mënyrë periodike në trajnime të ndryshme duke apsur si traditë, trajnim vjetor tradicional në fund të semestrit I. Trajnimi i fundit për stafin</p>




	<p>akademik ishte në lidhje me përdorimin e HyFlex system për mësimdhënie nga auditori, pra trajnimet lidhen me nevojat specifike sipas kohës dhe situatës.</p> <p>Para tij, stafi kishte marrë pjesë në trajnime për tema të rëndësishme si Project management dhe si të përmirësosh përgatitjen e syllabus.</p> <p><a href="#">Shtojca 1.15 Policy on Continuous Improvement of Study Program.pdf</a>  <a href="#">Shtojca 3.9 Internal Quality Assurance Unit Department Staff Training Report Menu.pdf</a></p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>GVJ u informua gjatë diskutimeve me personelin akademik efektiv të angazhuar me këtë program studimi në vizitën në Institucion, se personeli akademik përgjegjës për zbatimin e programit të studimit zakonisht pasi paraqet syllabusin e lëndës përkatëse në klasë u kërkon studentëve që të japin sugjerime për organizimin e lëndës dhe përmirësimin e saj. Nëse sugjerimet vlerësohen si të dobishme për përmirësimin e mësimdhënies, lektori siguron zbatimin e metodave të kërkuara. Gjithashtu pjesëmarrja e personelit akademik në konferenca dhe trajnime të vazhdueshme konfirmon qasjen pozitive që Institucioni ka për përmirësimin e metodave të mësimdhënies.</p>								
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Në RVB të Institucionit specifikohet se lektorët e lëndës nxiten të zbatojnë metoda të reja mësimore në lëndët e tyre përkatëse, për t'u përshtatur me evoluime të zakonshme si: Ndryshimi i Tendencave të Tregut; Zhvillime të përsëritura të IT; Përhapja e Globalizimit; Sugjerimet nga Agjencitë e Akreditimit etj. Nëse lektori e shikon të nevojshme të rezantojë një lëndë të re me zgjedhje, atëherë si procedurë departamenti dhe njësitë përkatëse diskutojnë mbi sugjerime të tilla dhe bazuar në rezultatet e diskutimit marrin një vendim përfundimtar.</p> <p>Gjatë tre semestrave të fundit akademikë, impementimi i metodave të reja në mësimdhënie ka qenë kërkesë e realitetit të pamohueshëm, dhe si e tillë konstatohet të jetë aplikuar edhe nga Institucioni dhe personeli akademik i tij. Konstatimi gjatë vizitës në Institucion dhe intervistave me studentët dhe stafin akademik.</p>								
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi se mënyra e testimit të njohurive të studentëve përcaktohet në “Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor dhe Provimet”, “Udhëzimin: mbi zhvillimin e provimeve” (shtojcat 3.5.1 dhe 3.5.3 në DVV). Këto rregullore janë të publikuara në faqen e internetit të Institucionit dhe sic u verifikua edhe nga GVJ gjatë vizitës në Institucion, studentët kanë njohuri të kënaqshme mbi këto rregullore.</p>

	Një faktor që kontribuon në shkallën e njohjes së tyre nga ana e studentëve është se elemente të tyre përfshihen në syllabuse të lëndëve mësimore dhe diskutohen në javën e parë të çdo semestri akademik.			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentët e programit të studimit GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo lëndë/moduli me Objektivat e lëndës, Skica e lëndës, Rezultatet e Mësimit të lëndës dhe Metoda e Vlerësimit të lëndës nga titullari i lëndës/modulit. Këto elemente janë pjesë e programeve lëndore të cilat vendosen në dispozicion të studentëve duke u ngarkuar në sistemin elektronik të menaxhimit të mësimit ku ishin të aksesueshme gjatë gjithë vitit / semestrit akademik. Studentët, kishin madje të drejtë të propozonin ndryshime të vogla në përbërjen e metodologjisë së vlerësimit dhe referuan fleksibilitetin e stafit akademik për të pranuar këto kërkesa.			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ pasi shqyrtoi programet lëndore të disiplinave të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, vërejti se në to ka elemente të larmishme të kontrollit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve. Këto elemente janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• provimet dhe testimet e ndërmjetme dhe përfundimtare,</li> <li>• detyrat e kursit,</li> <li>• niveli i aktivizimit në seminare apo punë laboratorike,</li> <li>• vlerësimet mbi bazën e përgjigjeve të sakta, etj.</li> </ul> GVJ gjykon se përfshirja e një larmie të formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin njohuritë dhe kompetencat e fituara në njërin ose disa prej formave të zgjedhura të testimit. Vlen të theksohet edhe se Rregullorja e Provimeve parashikon se testimet e ndërmjetme dhe përfundimtare mund të realizohen në disa forma, si testime me shkrim, ose me gojë, provime në shtëpi, etj.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	
			X	


### Standardi III.6

#### Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>GVJ ka konstatuar nga analiza e programeve lëndore se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës mësimore dhe vitit akademik dhe është rezultante e këtyre elementeve (përgjithësisht) të shtrira gjatë gjithë vitit akademik (provime të ndërmjetëm, kuicet, praktikat, detyrat, projektet, seminarët, pjesmarrjen, studime laboratorike).</p> <p>Tabela 15 në shtojcat e DVV prezanton këto elemente vlerësimi të vazhdueshëm gjatë vitit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 5 – 10%</li> <li>• Plotësimi i detyrimeve (lab/detyra kursi) 10 – 30%</li> <li>• Testimet gjatë vitit 20 – 45 %</li> </ul>


	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi përfundimtar 30 – 60%</li> <li>• <b>Totali</b> <b>100%</b></li> </ul> <p>Shpërndarja e komponentëve të vlerësimit gjatë gjithë vitit / semestrit ul riskun e varësisë së vlerësimit final të studentit nga rrethana specifike kohore që shpesh janë jashtë ndikimit të studentit apo të Institucionit dhe nuk reflektojnë ecurinë dhe angazhimin real të studentëve në procesin mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe më pas konfirmuar edhe në vizitën në Institucion, GVJ konstatoi se Institucioni, në kushte normale mësimdhënie (pra jo online në kushte pandemie), përdor sisteme elektronike të vlerësimit dhe të testimit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Platforma Turnitin për të vlerësuar cilësinë e punimit dhe nderhmërinë akademike për detyrat individuale dhe punime tnë grup të studentëve.</li> <li>• Sistemin LMS të Institucionit, EIS për të anonimizuar provimet (në mes dhe në fund të semestrit), duke ulur shanset e abuzimit me identitetin e studentëve gjatë korrigjimit.</li> </ul> <p>Në kushtet e mësimin online, metodave të mësipërme u shtohen edhe menaxhimi i testeve nëpërmjet Google Forms apo MS Forms, ku pyetjet organizohen të përkëmbyera dhe korrigjohen automatikisht nga platforma, duke ulur mundësinë e abuzimit në vlerësim.</p> <p>Në përgjithësi, GVJ është e mendimit se ky kriter përmbushet nga ana e Institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sic verifikohet nga dokumentacioni në DVV, në Universitetin Epoka provimet realizohen nga lektorët e lëndëve (titullarët e lëndëve janë vetë lektorët sic edhe u konfirmua gjatë vizitës në Institucion) dhe vetëm projekti i diplomës, dhe provimet me gojë janë parashikuar të realizohen me një komision provimi të përbërë nga dy anëtarë (shtojca 3.6.3, udhëzimi “Mbi Provimet”). Mbikëqyrja e provimit në vetvete kryhet përveçse nga lektori i lëndës, edhe nga personel shtesë në rastet kur është e nevojshme.</p> <p>Gjithashtu, procesi i organizimit të provimeve, monitorohet nga një Bord Provimesh, një strukturë kjo e ngritur në vitin 2019, për të garantuar vlerësimin sa më të saktë të studentëve. Shqyrtimi i procedurës së provimeve nga një Bord Provimesh është një formë që Institucioni synon të përdorë për të ulur riskun e provimeve.</p> <p><i>Megjithatë, fakti që provimet përgjithësisht nënshkruhen vetëm nga lektori i lëndës, bën që ky kriter të vlerësohet pjesërisht i përmbushur nga ana e GVJ.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>GVJ konstatoi edhe më lart në këtë raport se ambientet e Universitetit Epoka ku zhvillohen teste janë të vrojtuar dhe të monitoruar pasi janë të pajisura me kamera sigurie. Procesin e monitorimit mbështete nga një rregullore e posaçme për këtë qëllim (shtojca 3.6.4 Mbi Monitorimin me CCTV në DVV).</p> <p>Gjithashtu, së fundmi, Universiteti Epoka ka implementuar një skemë anonimati për provimet me shkrim. Para provimeve, të gjithë studentëve u gjenerohet nga sistemi EIS, ID e Provimit të Studentit e cila duhet të shkruhet në hapësirën e duhur në fletën e provimit, kur këto të fundit zhvillohen në</p>

	<p>auditor. Këto ID u shpërndahen në mënyrë elektronike çdo student i përmes llogarive personale të EIS. Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, kjo procedurë konfirmohet nga studentët dhe pedagogët e programit të studimit.</p> <p>Në kushte të mësimdhënies online sigurisht që ky kriter është i pamundur të garantohet, por sic u përmend më lart, fakti që përdoren metoda testimi me korigjim automatik (Google Forms apo MS Forms), kompenson mungesën e sekretimit dhe kofidikimit të provimeve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas RVB në lidhje me këtë kriter gjejmë dhënie e informacionit të mëposhtëm: “Vlerësimi i njohurive në provime dhe testime, është i shoqëruar me komentet përkatëse të vlerësimit në mënyrë që studenti të jetë sa më i qartë dhe i vetëdijshëm për gabimet a pasaktësitë e tij. Gjithashtu, provimi i ndërmjetëm zgjidhet në klasë në javën pasi është zhvilluar.</p> <p>Të pyetur gjatë vizitës në Institucion, kjo procedurë konfirmohet nga studentët të cilët u shprehën se në cdo rast, vlerësimet e provimeve të tyre ishin të argumentuara nga ana e pedagogëve dhe ata ishin të qartë për pikat ku kishin nevojë të përmirësohen. Ata u shprehën se stafi akademik ishte i hapur për të bërë ballafaqimin e vlerësimeve dhe organizonin takime me studentët, pas shpalljes së notave, po para hedhjes së notave në procesverbal, ku vijnë studentët dhe kanë të drejtën të shohin provimet e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Kodi i Etikës, i Institucionit (shtojca 3.6.2.b në DVV) dhe Rregullorja mbi Provimet (shtojca 3.5.3 në DVV)”, parashikojnë masa të rrepta për të shmangur plagjiaturën dhe përshkruajnë masa disiplinore të mundshme në rastet kur konstatohen praktika kopjimi.</p> <p>Gjithashtu, përdorimi i platformës “Turnitin”, lehtëson këtë proces duke disiplinuar studentët të paktën në vlerësimin e detyrave me shkrim. Lektori përkatës i lëndës përcakton një prag për përqindjen e plagjiaturës që lejohet në punimin e studentëve.</p> <p>Sipas procedurave të parashikuara, në rast mosrespektimi të masave të parashikuara, studentët vlerësohen me një notë jo kaluese dhe një paralajmërim verbal ose me shkrim.</p> <p>Duke qenë se kjo praktikë u konfirmua edhe me personelin akademik të Institucionit duke mbështetur deklaratimet e dhëna në RVB, kriteri konsiderohet i plotësuar nga ana e GVJ.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Konfirmuar gjatë vizitës në Institucion, dhe në mbështetje të praktikave të parashikuara në Rregulloret e Institucionit, procedura e publikimit të rezultateve të provimit parashikon afate të cilat në përgjithësi ndiqen nga ana e Departamentit. Sipas rregullores “Mbi provimet”, të gjithë lektorëve u kërkohet të vendosin notat në sistemin EIS brenda një periudhe një javore.</p> <p>Gjithashtu parashikohen kontrole të përmbytjes së provimeve, pra nëse provimi i është përmbytur ose jo koncepteve të përfshira në programin lëndor, nga një strukturë specifike e njohur si Bordi i Provimeve, (shtojca 3.6.2 në DVV) dhe i cili vepron si pjesë e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. Roli i kësaj strukture të ngritur në fundin e vitit 2018 është që të garantojë zhvillimin në mënyrë të rregullt të të gjitha provimeve në Institucion.</p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, studentët u shprehën se rishikimi aplikohet vetëm për provimet e ndërmjetme, përfundimtare dhe notën finale, por jo për vlerësimet e detyrave apo të angazhimit në seminare. Rishikimi mund të kryhej deri në 3 ditë pas shpalljes së notës në sistem, por para finalizimit të saj. Studentët kishin mundësinë e përsëritjes së provimit, ku mundësia e parë jepej një javë pas provimit final, por ku nota maksimale që mund të merret është “shtatë”. Mundësi të tjera për përsëritje kishte në sezonin e ardhshëm ku nuk ka kufizim për notën maksimale që merret. Për përmirësimet e vlerësimeve, studentëve u jepej mundësia në vitin e fundit të sezonit.</p> <p>Bazuar në shqyrtimin e Rregullores mbi Provimet të Universitetit EPOKA (shtojca 3.5.3 në DVV), GVJ konstaton se nëse pasi vendoset nota përfundimtare për lëndën, studenti kërkon që të rishikohet vlerësimi i një lënde të caktuar, atëherë ndiqet një procedurë e paracaktuar për rishikimin e vlerësimit. Mbajtja e dokumentacioneve mbi rishikimet e notave të provimeve finale bëhet me Vendim të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative.</p> <p>Gjatë diskutimeve me studentët ata u shprehën se e kanë shfrytëzuar të drejtën e rishikimit të vlerësimit dhe kanë gjetur mirëkuptimin e pedagogëve për të ushtruar këtë të drejtë të tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas Rregullores mbi Provimet të Universitetit EPOKA (shtojca 3.5.3), çdo rast ankimimi nga studentët trajtohet duke kërkuar nga ky i fundit që të plotësojë dhe dorëzojë një Kërkesë për Ankesë të Notës në Zyren e Sekretarisë Mësimore brenda pesë ditëve nga shpallja e notave të provimit. Ankimimi i studentit vlerësohet më së pari nga lektori përkatës në lidhje me gabimet materiale. Gjithashtu, ankesat mund t'i drejtohen zyrës së koordinimit të studentëve, i cili mund ta dërgojë ankesën në Fakultet për shqyrtim. Pastaj Fakulteti mund të caktojë një ekip ad-hoc të hetimi për të hetuar ankesën dhe ja raporton përsëri në Fakultet. Pyetjet gjatë vizitës në Institucion konfirmojnë procedurën e përshkruar më lart.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<b>X</b>	

<p><b>Standardi III.7</b>  <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programeve lëndore, GVJ konstaton se realizimi dhe zhvillimi i programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike në Universitetin EPOKA mundësohet nga një kombinim i mënyrave të ndryshme të mësimdhënies si shembuj; punë në laborator për lëndët e fushës së informatikës; pyetje kritike për problem-zgjidhje; raste studimore; analizë e artikujve shkencorë. Kombinimi i këtyre teknikave është organizuar në mënyrë të tillë që u jep mundësinë studentëve të njohin teorikisht dhe praktikisht</p>








	fushën ku studiojnë si edhe të zhvillojnë aftësi të mira në profesionin e informatikës ekonomike.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ konstaton (nga shqyrtimi i Planit Mësimor dhe i syllabuseve të Programit të Studimit,) se ky program mundëson thellimin e njohurive në mënyrë të përgjithshme dhe specifike në fushën e teknologjisë së informacionit. Vetë specifikat e programit e garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në teknologjinë e informacionit dhe lidhjen e kësaj të fundit me biznesin dhe ndërmarrjet. Gjithashtu, për shkak se programi i studimit ofrohet në gjuhën angleze, garanton zhvillimin deri në fund të studimeve, të aftësive të mira të komunikimit të përgjithshëm në këtë gjuhë, si edhe zotërimin e terminologjisë së nevojshme për ndërveprim, në fushat e biznesit dhe informatikës.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	GVJ konstatoi se të gjitha programet lëndore të Programit të Studimit, Bachelor në Informatikë Ekonomike, kanë të përfshira një element të rëndësishëm i cili është “Learning Outcomes” (Rezultatet e të nxënit nga studentët, kjo në përputje edhe me kërkesat e VKM nr.41). Ky element liston përfitimet e pritshme nga cdo lëndë e programit. GVJ gjykon se përfshirja e këtij elementi në syllabus, orienton drejtimin dhe zhvillimin e lëndëve gjatë semestrit, duke ndihmuar stafin akademik të organizojë leksionet, diskutimet, testimet dhe orët e ushtrimeve. Në përfundim të semestrit, para provimit pedagogët kishin si praktikë pune të bënin një përmbledhje të lëndës ku paraqesin rëndësinë e cdo njohurie të marrë gjatë semestrit dhe lidhjen e tyre me rezultatet e të nxënit.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Në RVB të programit të studimit për këtë kriter Institucioni deklaron se cdo semestër, lektorët organizojnë orë përsëritjeje të programit në javën e shtatë dhe katërbëdhjetë të semestrit që korrespondon me periudhat para provimeve përkatëse të ndërmjetme dhe finale. GVJ gjatë vizitës në Institucion, konfirmon këtë praktikë e cila u konsiderua orientuese dhe vlerështuese nga ana e studentëve, jo vetëm për qëllime të përgatitjes për provim, por edhe në përgjithësi si përmbledhje e koncepteve kryesore të trajtuara në një lëndë të caktuar.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Gjatë shqyrtimit të faqes së internetit të Institucionit, GVJ ndeshi herë pas here në njoftime të cilat lidheshin me kryerjen e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar (por për disa nga të cilët mungonin informacione të detajuara mbi sfondin e tyre akademik apo kërkimor <i>Epoka University Online Open Lecture by Mr. Marc Pilkington</i> ). Këto orë të hapura referohen edhe në RVB të përgatitur nga ana e Institucionit. Mbështetur në të dhënat e publikuara në web, GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri nga ana e Institucionit.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Nga shqyrtimi i programeve lëndore, GVJ konstatoi se programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike i kushton vëmendje theksimit të kompetencave gjatë formulimit të tyre, pasi pothuaj në cdo syllabus u evidentua një seksion i veçantë “course contribution to program competencies”. Programi është i organizuar kryesisht me leksione dhe në lëndë të profilit të teknologjisë së informacionit është i kompletuar me orë në laborator. Nga ana tjetër, praktika profesionale është një lëndë e detyrueshme e cila zhvillohet në semestrin e pestë, dhe mundëson që studentët të arrijnë të zhvillojnë gjatë praktikës njohuritë e marra në vitet e studimeve të tyre. Gjatë

	vizitës në Institucion, GVJ pati mundësinë të konfirmojë kryerjen e praktikave profesionale nga ana e studentëve.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter deklarohet se metodat e mësimdhënies të përdorura nga personeli akademik përfshijnë projekte në grup dhe diskutime të krijuara për të zhvilluar aftësi të menduarit kritik dhe punë në ekip për zgjidhjen e problemeve. Kjo mënyrë e organizimit të orëve mësimore dhe procesin e të mësuarit, u konfirmua gjatë vizitës në Institucion edhe nga stafi akademik, por edhe nga studentët që ndjeheshin të lirshëm për t'u përfshirë në diskutime dhe punë në grup.			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Nga intervistat me personelin akademik të Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ konstaton se ata shprehen në favor të krijimit të një fryme bashkëpunimi në klasë. Ata janë të hapur të mbështesin idetë inovatore të studentëve, dhe vetë studentët e mbështetën këtë deklaratë.  Përsa i përket statistikave konkrete, në tabelën 22 në shtojcat e RVB vihet re se për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike deklarohen 7 studentë të aktivizuar për punime individuale të pedagogëve, por asnjë i angazhuar në projekte kërkimore, apo elemente të tjera. Në shtojcën 3.7.6 të DVV gjenden të detajuara të dhëna në lidhje me pjesëmarrjen e studentëve të programit në publikime shkencore.  Institucioni ofron mbështetje financiare për kërkime shkencore për studentët e nivelit të tretë të studimeve (shtojca 3.7.9.b në DVV), pra kjo deklaratë në RVB, për këtë kriter nuk lidhet me këtë program studimi specifik.  Mbështetja financiare për studentët aplikohet vetëm në rastin e bursave të cilat janë të lidhura me performancën akademike të studentëve dhe nuk jepen për zhvillimin e ideve inovatore të tyre.			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Nga shqyrtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit si edhe gjatë diskutimeve me Zyrën e Projekteve të Universitetit EPOKA, GVJ vëren se Institucioni ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në fushën e kërkimit shkencor dhe shkëmbimit të stafit akademik dhe të studentëve. Për këtë program studimi, nga tabela 20 në shtojcat e RVB vihet re sa ka pasur një mobilitet exchange të studentëve.			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga shqyrtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit si edhe gjatë diskutimeve me Zyrën e Projekteve të Universitetit EPOKA, GVJ vëren se Institucioni ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në fushën e kërkimit shkencor dhe shkëmbimit të stafit akademik dhe të studentëve. Për këtë program studimi, nga tabela 20 në shtojcat e RVB vihet re sa ka pasur një mobilitet exchange të studentëve.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.8

#### Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në DVV, GVJ konstaton se për procesin e diplomimit studentët e Programit Bachelor në Informatikë Ekonomike, i nënshtrohen ose një provimi të përgjithshëm, ose përgatisin një punim diplome. Studentët të cilët në fund të semestrit të 5-të të studimeve, kanë një mesatare të përgjithshme nën 3 (GPA) i nënshtrohen procedurave të ndryshme që cojnë në diplomim, në krahasim me studentët të cilët kanë një mesatare më të lartë. (Edhe

	<p>studentët me mesatare mbi 3 mund të zgjedhin provimin, pavarësisht se iu linte e drejta për të përgatitur temen e diplomës.) Procedurat e diplomimit specifikohen qartë dhe në mënyrë transparente në Rregulloret e Institucionit (Rregullorja mbi programet Bachelor dhe Rregullorja mbi Provimet).</p> <p>Sipas këtyre procedurave studentët që diplomohen, janë ata të cilët marrin të paktën 60 nga 100 pikë në provimin përfundimtar gjithëpërfshirës ose ata që përgatitin dhe mbrojnë një tezë që vlerësohet si e suksesshme nga komisioni.</p> <p>Këto informacione u konfirmua se gjenden të publikuara në faqen e internetit të Institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Në dy dokumenta: Rregullorja mbi programet Bachelor dhe Rregullorja mbi Provimet, shpjegohet në mënyrë të detajuar procedura e ndjekur për diplomimin në programin Bachelor në Informatikë Ekonomike, qoftë për studentët që i nënshtrohen një provimi të përgjithshëm gjithëpërfshirës, qoftë për studentët të cilët përgatisin një temë diplome.</p> <p>Procedura për cilëndo përqsaje parashikon asistencë nga pedagogët, udhëzime të qarta për studentët dhe materiale ndihmëse në funksion të këtij procesi. Në dokumentacion u gjetën edhe të dhëna në lidhje me shpërndarjen e studentëve me temë diplome apo me provim të përgjithshëm dhe mbikëqyrësit përkatës (shtojca 3.8.4.b në DVV).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas të dhënave të RVB, GVJ konstaton se provimi përfundimtar gjithëpërfshirës është një përmbledhje e disa nga lëndëve më kryesore që studentët kanë marrë gjatë studimeve të tyre në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Fondi i pyetjeve të provimit përmban pyetje nga disa lëndë të rëndësishme duke krijuar një “test bank“ me 350 pyetje me alternativa të shoqëruara me përgjigjet përkatëse:</p> <p>(<a href="http://ams.asc.al/ams/components/dokumentat/proceduraview.php?id=60854">http://ams.asc.al/ams/components/dokumentat/proceduraview.php?id=60854</a>).</p> <p>Nga këto, 70 pyetje bëhen pjesë e provimit të përgjithshëm përfundimtar, në një raport të paracaktuar sipas fushave dhe lëndëve kryesore. Këto informacione janë publike dhe të verifikueshme edhe në faqen e internetit të Institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Sipas RVB (Shtjca 3.8.4.b) dhe sipas konfirmimeve gjatë vizitës në Institucion studentët ishin të asistuar nga personeli akademik gjatë procesit të diplomimit, edhe kur i nënshtroheshin një provimi të përgjithshëm, dhe sidomos nëse përgatisnin një punim diplome, rast në të cilin cdo studenti i caktohej një pedagog mbikëqyrës që e ndiqte vazhdimisht ecurinë e tij.</p> <p>Studentët e intervistuar gjatë vizitës në Institucion u shprehën se atyre u dërgohet fondi i pyetjeve me përgjigje dhe përgatiten në bazë të tij duke qenë të informuar për peshën që do ketë cdo lëndë apo disiplinë kryesore në provimin përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga pyetje konkrete që iu drejtuan studentëve që po përgatisin punimet e diplomës, GVJ u informua se në këtë proces, Institucioni kishte vendosur në dispozicion, jo vetem pedagogët mbikëqyrës, por në varësi të nevojës së studentëve edhe lehtësira infrastrukturore, si psh aksesin në bibliotekë online. Gjithashtu pedagogët u shprehën të gatshëm të orientonin studentët jo vetëm në literaturë por edhe në hapat e nevojshme gjatë procesit të analizës së të dhënave.</p>


<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas verifikimeve nga ana e GVJ gjatë vizitës në Institucion, si edhe mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar, udhëheqësi i diplomës asiston studentin në cdo fazë të punimit të temës së diplomës duke nisur që nga caktimi i temës. Studentët kanë të paktën dy takime me udhëheqësit e tezave, një në fillim dhe një tjetër në fund. Duke e parë punimin në këto dje tapa, udhëheqësi i temës garanton cilësinë e punimit dhe rezultateve dhe jep miratimin e tij. Siç përcaktohet në Udhëzimin e Përgatitjes së Tezës (shtojca 3.8.1.c), mbikëqyrësi i tezës nënshkruan që ai vërteton se teza është "plotësisht e përshtatshme, në fushëveprim dhe cilësi" për shkallën përkatëse. Mbikëqyrësi i tezës nënshkruan edhe formularin e pranimit për paraqitjen e tezës para se të paraqitet para komisionit.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, GVJ gjatë punës së tij dhe bazuar në RVB (shtojca 3.8.7 në DVV), konstatoi se provimi vlerësohet nga FF në AA (sipas sistemit të notave të përdorur në Universitetin Epoka) kurse punimi i diplomës vlerësohet me pikë. Bazuar dhe në planin mësimor, provimi / tema e diplomës është 6 ECTS.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ konstatoi se në përfundim të studimeve studentët pajisen me diplomë dhe suplement diplome e cila është e licencuar nga MASR. Një model i diplomës është në dispozicion në Shtojcën 3.8.8 dhe një model i suplementit të diplomës është në dispozicion në Shtojcën 3.8.8.b.</p> <p>Studentët pajisen edhe me suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Sic konfirmohet gjatë vizitës në Institucion, kjo procedurë realizohet nga Sekretaria Mësimore nëpërmjet sistemit EIS.</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar nga Institucioni (RVB) specifikohet se në përfundim të studimeve, studentit pajiset, me diplomën dhe me suplementin e diplomës (të dhënat për diplomën dhe suplementin e diplomës gjenden në DVV). Bashkë me këtë i jepet edhe një kopje e Planit Mësimor i cili tregon në mënyrë të qartë të gjitha lëndët e detyrueshme dhe me zgjedhje të marra nga studentit gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, notën përfundimtare, kredite dhe ECTS përkatëse për secilën lëndë.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konfirmoi se Institucioni ruante të dhënat për studentët në format hard copy. GVJ kontrolloi me zgjedhje dosjet e dy studentëve në Sekretarinë Mësimore dhe konfirmon se Institucioni ka ruajtur kopje të dokumentacionit të studentit si formulari i regjistrimit, ecuria e studentëve, dhe të dhëna të tjera të mëparshme gjatë studimeve të tij.</p> <p>GVJ kontrolloi me zgjedhje edhe regjistra të notave duke konfirmuar procedura të rregullta edhe të kujdesshme të ndjekura ng Sekretaria mësimore e Institucionit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Asnjë përmbushje</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<p><b>Asnjë përmbushje</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
--	--------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---






#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ u njoh me dokumentacionin e paraqitur në dosjen e vetë vlerësimit (DVV) që përcakton se Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në Universitetin EPOKA. Dokumentacioni mbledhet në bazë të formularit “Full-time staff info form” për personelin akademik efektiv dhe në bazë të formularit “Part-time staff info form” për personelin akademik me kontratë. Në bazë të këtij formulari Zyra e Burimeve Njerëzore disponon një sërë dokumentash për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi, që përfshin librezën e punës, librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, kartën e identitetit, kopjen e noterizuar të diplomës së fundit të marrë, CV, etj.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me disa nga dosjet e protokolluara, të cilat u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme. Gjatë bisedës me përfaqësuesin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ u informua që dokumentacioni për të gjithë anëtarët e personelit mbahet në dosje fizike si dhe në dokumenta elektronikë nëpërmjet Sistemit Interaktiv Epoka (EIS).</p> <p>GVJ konstaton se sipas formularit “Full-time staff info form” apo “Part-time staff info form” kërkohet vetëm diploma e fundit e marrë nga anëtari i personelit. Këshillohet që dosja të përmbajë edhe diplomat e nivelit/niveleve të mëparshme të personelit akademik.</p> <p>Dokumentacioni përditësohet çdo vit ose sipas ndryshimeve individuale të dokumentacionit që mund të paraqiste personeli gjatë vitit. Përsa i përket informacionit për angazhimin e personelit në çdo semestër dhe vit akademik informacioni vjen nga Departamenti i Administrim Biznesit pasi ai përcakton ngarkesën në bazë të dokumentit “Directive on the teaching load” të Universitetit Epoka. Ky informacion nuk ndodhet në dosjet e Zyrës së Burimeve Njerëzore.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me përfaqësuesit e Zyrës së Burimeve Njerëzore si edhe Përgjegjës të Departamentit të Administrim Biznesit, GVJ u informua se departamenti bazuar tek nevojat që ka i përcjell kërkesën për personel të ri Bordit Administrativ. Pasi vendoset miratimi nga ky i fundit për pozicionet vakante departamenti ja kalon kërkesën për fillimin e procesit të rekrutimit Zyrës së Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë në bazë të kriterëve të përgjithshme dhe specifike që përcakton dokumenti “Regulation on staff recruitment” dhe kërkesës së departamentit njofton në website-n e Universitetit Epoka ose edhe në portale të tjera që njoftojnë vende vakante punësimi, llojin e pozicionit dhe përshkrimin e punës të pozicionit vakant, si dhe kriteret që aplikanti duhet të plotësojë për të aplikuar në pozicionin vakant. Që në njoftim përcaktohet që për pozicionet vakante për personel akademik kërkohet të paktën diplomë Master Shkencor ose ekuivalente, grada shkencore Doktor,</p>






	<p>titulli Profesor i Asociuar ose Profesor. Ndërsa për personelin ndihmës akademik kërkohet të paktën diplomë Master Shkencor ose ekuivalente. GVJ i verifikoi këto procedura edhe nëpërmjet faqes së webit:</p> <p><a href="http://www.epoka.edu.al/news-apply-for-a-teaching-assistant-position-2021-2022-academic-year-5540.html">http://www.epoka.edu.al/news-apply-for-a-teaching-assistant-position-2021-2022-academic-year-5540.html</a> .</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni realizon procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit duke u bazuar tek kriteret e përgjithëshme dhe specifike të përcaktuara në dokumentin “<i>Regulation on staff recruitment, Article 11</i>”. Për personelin akademik në këto kritere përfshihen diploma Master Shkencor ose ekuivalente, grada shkencore Doktor, titulli Profesor i Asociuar ose Profesor, përvoja e punës në mësimdhënie, kualifikimet brenda apo jashtë vendit, njohuritë për gjuhët e huaja, aktivitetet që lidhen me botimet shkencore, etj. Të gjitha këto kritere shoqërohen me një sistem pikësimi i cili shërben për procesin e vlerësimit që kryhet nga Komiteti Shkencor i departamentit. Mbi bazën e vlerësimit të dosjes si dhe nëse Komiteti Shkencor e vlerëson kandidatin si të përshtatshëm për vendin vakant, ai mund të kërkojë një intervistë paraprake me kandidatin. Gjithashtu kandidatëve të përzgjedhur që plotësojnë kriteret ju kërkohet të mbajnë një leksion të hapur përpara Komitetit Shkencor dhe mundësisht edhe studentëve.</p> <p>GVJ konstaton që në kriteret specifike të përcaktuara në rregullore për vlerësimin e aplikantëve për vendet vakante të personelit akademik nuk ka një përcaktim të qartë në lidhje me nivelin e rezultateve të shkollimit që kërkohet nga aplikantët. GVJ mendon se vendosja e një kriteri që lidhet me mesataren e rezultateve të diplomës Bachelor dhe Master do të ishte shumë e rëndësishme për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit.</p> <p>Megjithatë gjatë vizitës në institucion, në takimin që patëm me Përgjegjës të Departamentit të Administrimit Biznesit, u informuam që ky departament aktualisht është kujdesur që të përzgjedhë aplikantë që përveç përbushjes së kiterëve të përcaktuara të kenë rezultate të larta të shkollimit. Aktualisht në kohën e hartimit të këtij Raporti (prill-maj 2021) departamenti kishte shpallur 7 vende vakante për personel akademik por kishte përzgjedhur vetëm 2 midis aplikantëve të shumtë në numër, duke u përpjekur për të ruajtur cilësinë e personelit dhe në përputhje me kriteret e vendosura.</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi dhe u njoh me mjediset e punës dhe kushtet e tyre për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Këto mjedise ofronin kushte shumë të mira pune dhe të përshtatshme për kryerjen e detyrave të tyre profesionale. Zyrat dhe mjediset e tjera që lidhen me procesin mësimor ishin të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit si</p>

<p>personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>dhe të gjitha mjediset mbuloheshin nga rrjeti wireless që ofronte Internet për stafin dhe studentët.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ bëri në institucion me Përgjegjësën e Departamentit të Administrim Biznesit dhe me personelin akademik përgjegjës për këtë program studimi, u informua se institucioni angazhohet plotësisht për ti dhënë mundësi pedagogëve të kenë një kualifikim dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm.</p> <p>Për çdo vit akademik për secilin pedagog akordohet një fond i konsiderueshëm i cili shërben për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të pjesmarrjes së tyre në konferenca shkencore apo për botimin e artikujve në revista shkencore të indeksuara (<i>dokumenti 3.7.9 "Directive on the Promotion of Scientific Publications"</i>). Një arritje e rëndësishme në fushën e kërkimit e realizuar nga njëri prej pedagogëve të këtij programi studimi ishte botimi i artikullit në revistë me faktor impakti 6, gjë që nuk është arritur më parë në këtë fushë në të gjitha IAL në Shqipëri në këtë fushë. Gjithashtu nga dokumentat e shlytuara dhe takimi me personelin akademik, GVJ konstatoi që pedagogët e këtij programi studimi kanë një numër të konsiderueshëm pjesmarrjesh në botime shkencore gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorzuar në DVV, si dhe gjatë takimeve me pedagogët dhe Përgjegjësën e Departamentit të Administrim Biznesit, GVJ konstatoi se institucioni organizon vazhdimisht aktivitete në kuadër të kualifikimit të mëtejshëm profesional të personelit akademik, për përmirësimin e metodave të mësimdhënies, etj. Mund të përmendim Leksione të Hapura Online nga profesorë të huaj, trajnime të tilla si: "Open Forum: Bringing Creativity into 21st Century Classrooms", "Pedagogy in Online Teaching Collegial Insights" ose "Academic Training on Digital Education". Ky i fundit ishte një workshop në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies online, dhe për të zbutur tranzicionin nga mësimi në klasa në atë online që ndodhi gjatë pandemisë Covid-19 duke përdorur platformën Hyflex. Workshopi u organizua nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me Zyrën e Kërkimit dhe Projekteve, Zyrën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit dhe Qendrën për Edukim të Vazhdueshëm. Cikli vjetor i trajnimeve për zhvillim profesional të personelit akademik është përgjegjësi e Zyrës së Burimeve Njerëzore në zbatim të Planit Strategjik të saj në përputhje me Planin Strategjik të Universitetit EPOKA.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Mbështetur tek dokumentat e paraqitura në DVV (Tabelat 1 dhe 2 në shtojcat e RVB) si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Administrim Biznesit, i cili është edhe njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Për vitin akademik 2020 – 2021, Departamenti i Administrim Biznesit ka 8 personel akademik efektiv, 7 personel ndihmës akademik dhe 2 personel akademik me kontratë (të dhëna më të detajuara për numrin dhe kualifikimet e personelit akademik janë dhënë më herët në këtë raport Standardi II.2).</p>

	Një gjë për tu vlerësuar është angazhimi i një numri të lartë të personelit ndihmës akademik, për Departamentin e Administrim Biznesit janë 7 anëtarë. Siç është shkruar dhe më lart, GVJ konstaton se institucioni implementon programin për Asistentë Mësimorë, pra personel ndihmës akademik për student të nivelit master me mesatare të lartë të cilët angazhohen në punë asistence akademike për pedagogët. Siç na pohuan edhe pedagogët këta janë një ndihmë shumë e madhe për personelin akademik sepse asistojnë me detyra ndihmëse për orën e mësim, përgatisin ushtrime, konsultojnë studentët që kanë nevojë, propozojnë tema për detyra kursi dhe orientojnë studentët në kryerjen e detyrave, organizojnë administrimin dhe arkivimin e materialeve mësimore të lëndëve, etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ konstaton se Universiteti Epoka e zhvillon veprimtarinë mësimore në kampusin e vet të ndërtuar që në vitin 2011 dhe që ofron një infrastrukturë moderne, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi dhe numrin e studentëve në to, në përputhje me natyrën specifike të këtij programi dhe moduleve të tij. Në kampus ka edhe ambiente në shërbim të mësimit si bibliotekë, sallë interneti, si dhe ambiente kreativiteti për studentët, etj.  Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentacioni i dorëzuar në DVV (dokumenti 3.11. Përmbledhje - Tabela e Infrastrukturës), GVJ konstaton se në funksion të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë në dispozicion tre laboratorë kompjuterësh (E-011, E-015, E-B11), 4 auditore (E-012, E-110, E-214, E-314), 8 klasa (E-010, E-011, E-211, E-212, E-213, E-311, E-312, E-313) dhe një dhomë konference (E-B01).
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat në DVV (dokumenti 3.11. Përmbledhje - Tabela e Infrastrukturës), GVJ konstaton se klasat janë të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që garantojnë më së miri realizimin e procesit mësimor teorik e praktik. Gjatë kushteve të zhvillimit të mësimit online, pedagogët kishin mundësuar shfrytëzimin në distancë të laboratoreve nëpërmjet paketave “multisim”, gjithashtu gjatë kësaj periudhe institucioni ka përmirësuar infrastrukturën e teknologjisë në klasa për ti dhënë mundësi pedagogëve që të zhvillojnë mësim me auditor online ose të kombinuar, me student në klasë dhe online.
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e	Në funksion të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë në dispozicion tre laboratorë kompjuterash (E-011, E-015, E-B11). Gjatë vizitës në institucion, si dhe në bisedat me studentët dhe pedagogët GVJ konstatoi se këta laboratorë janë të pajisur me programe profesionale në përputhje me natyrën dhe modulet e këtij programi studimi. Mund të përmendim programet Windows

Adresa: “Rruga e Durrësit”. Nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

faqe 56





<p>nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>MS Office, SAP2000, ETABS, .Net Visual Studio C ++, Matlab, GNS3, Multisim 11, VMWare Workstation, MySQL \ Workbench, Eclipse, Python (x, y), Rhinoceros 4 SR8 + -MAX, SPSS, EViews, etj. GVJ u informua se bazuar në kërkesat e personelit akademik në fillim të çdo semestri Zyra Koordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICTC) i përditëson programet në laboratorët e kompjuterave.</p> <p>Gjithashtu, laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore janë të pajisura edhe me mjete të tjera të teknologjisë si dhe rrjet Interneti wireless, të cilat janë përmendur në detaje më parë në këtë raport.</p> <p>Të gjitha këto janë në mbështetje të realizimit të objektivave formues të këtij programi studimi.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në bisedat me Përgjegjësin e Departamentit të Administrim Biznesit, GVJ u informua se Universiteti EPOKA ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani dhe institucione të sektorit publik dhe privat brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë praktikat profesionale të studentëve me kohëzgjatje të ndryshme. GVJ e verifikoi këtë gjë edhe në dokumentat e dorëzuar në DVV (dokumenti 1.8 “<i>List of Institutional Cooperation</i>”). Gjithashtu u informua se për këtë vit akademik, 15 studentë kanë kryer praktikat e tyre profesionale si pjesë e projektit Connect IT në kuadrin e BE për Inovacionin, duke kontribuar në ndërtimin e inovacionit dhe efikasitetit të Ndërmarrjeve në Shqipëri. Këtë gjë e mbështet edhe dokumenti 1.16 “<i>Matchmaking Challenges – Connect IT</i>”.</p> <p>Gjatë takimit dhe intervistave me studentët GVJ u informua se përveç mundësisë që institucioni i jepte studentëve për të zgjedhur midis kompanive të listës së bashkëpunimit, atyre i ofrohej mundësia e intershipeve brenda zyrave dhe mjediseve të Universitetit EPOKA për të realizuar praktikën mësimore.</p> <p>Bazuar tek të gjitha më sipër GVJ është i mendimit se institucioni i ofron studentëve të gjitha mjediset dhe mundësitë për të realizuar praktika profesionale të një niveli shumë të mirë.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (dokument 42.2 “<i>Library Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards the Community</i>”), si dhe gjatë vizitës në mjediset e bibliotekës në Universitetin EPOKA, GVJ konstatoi se institucioni ka vënë në dispozicion të të gjithë studentëve dhe pedagogëve për mbështetje të procesit mësimor një bibliotekë e cila gjendet në katin e parë të ndërtesës A në kampus.</p>

	<p>Biblioteka ka një kapacitet prej 100 vendesh, sipërfaqe prej 400 metrash katrorë dhe përmban 25000 libra (fizikë) dhe 2000 revista akademike dixhitale.</p> <p>Të gjithë studentët kanë mundësi të barabarta në përdorimin e saj, sepse materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazoheshin për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave apo prenotimeve të studentëve. Sistemi i informacionit “KOHA” përdoret për menaxhimin e burimeve në bibliotekë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikkës së programit të studimit.</p>	<p>Siç e përmendëm dhe më lart biblioteka ka një fond të pasur literature fizike dhe elektronike. Literatura elektronike mundësohet nga burime të tilla si: JSTOR, Journals Cambridge Online, IOPscience, New England Journal of Medicine, OECD- iLibrary, Taylor &amp; Francis Library. Literatura e bibliotekës mund të gjendet në gjuhë të ndryshme si: shqip, anglisht, turqisht etj.</p> <p>Gjatë takimit me studentët GVJ u informuar se ata kryesisht përdornin literaturën bazë të lëndëve (tekstet mësimore), e cila ju vihej në dispozicion nga pedagogët në format elektronik dhe më pak bibliotekën.</p> <p>Megjithatë GVJ është i mendimit se fondi i bibliotekës ishte i përshtatshëm për mbulimin e të gjithë moduleve e veprimtarive mësimore të këtij program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti EPOKA i ka dhënë mundësi të barabarta dhe pa pagesë studentëve dhe pedagogëve të aksesojnë fondin e bibliotekës nëpërmjet linkut <a href="http://lib.epoka.edu.al/">http://lib.epoka.edu.al/</a>, gjithashtu ai është abonuar me të drejta të plota në JSTOR dhe çdo pedagogu dhe studenti i mundësohet kërkimi në këtë bazë të dhënash duke përdorur linkun <a href="http://www.jstor.org/">http://www.jstor.org/</a>.</p> <p>Gjithashtu institucioni është abonuar në bazën e të dhënave elektronike ERA, të menaxhuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe disa burime të tjera në internet si: Bio One, Cambridge Journals Online, Ebrary Academic Complete, EBSCO Academic Search Complete, Emerald Management e-Journal Collection, IOP Science, Multi-Science Journals Collection, OECD eLibrary, Oxford English Dictionary Online, Oxford Reference Online, ProQuest Central, Taylor &amp; Francis Library, Web of Knowledge. Të gjitha këto burime janë vënë në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve pa pagesë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e universitetit GVJ konstatoi se hapësirat e bibliotekës ishin të bollshme dhe të përshtatshme për përdorim nga studentët, dhe në to ofrohet pa kufizim akses në Internet nëpërmjet rrjetit wireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekat online që ju mundëson universiteti. Por nga ana tjetër në bibliotekë kishte vetëm 2 kompjutera. GVJ është i mendimit se ky është një numër shumë i vogël në krahasim me numrin e studentëve që mund të aksesojnë bibliotekën të të njëjtën kohë. Sugjerojmë shtimin e kompjuterave në bibliotekë në përshtatje me nevojat e studentëve dhe të stafit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bazë të RVB koleksioni i bibliotekës pasurohet nga blerjet e reja dhe dhurimet. Librat për t'u blerë zgjidhen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve, personelit administrativ dhe akademik. Koordinatorët e programeve dhe Përgjegjësi i Departamentit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e artikujve në bibliotekë për të mbështetur programin, duke përfshirë</p>






	<p>edhe buxhetin e planifikuar për të. Formulari i aplikimit për blerjet e reja duhet të miratohet nga përgjegjësi i njësisë kryesore dhe Administratori i Universitetit. Procedura e blerjes është e iniciuar dhe ndjekur nga njësia e bibliotekës nën koordinimin e Zyrës Koordinuese të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Në bazë të dokumentave të dorzuara rezultoi se institucioni ka bërë blerje librash apo ka marrë donacione:</p> <p><a href="http://www.epoka.edu.al/news-purchasing-of-books-in-the-framework-of-dimtv-project-5381.html">http://www.epoka.edu.al/news-purchasing-of-books-in-the-framework-of-dimtv-project-5381.html</a>; <a href="http://www.epoka.edu.al/news-the-university-of-tennessee-at-chattanooga-donates-around-300-books-to-epoka-university-s-library-5014.html">http://www.epoka.edu.al/news-the-university-of-tennessee-at-chattanooga-donates-around-300-books-to-epoka-university-s-library-5014.html</a> ).</p> <p>Megjithatë gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në DVV apo referencave në RVB për këtë kriter, GVJ nuk gjeti ndonjë dokument të një plani të detajuar të shtimit të zërave të bibliotekës apo periodicitetin e tij. Për këtë arsye GVJ sugjeron hartimin e një plani të detajuar vjetor për shtimin e literaturës që lidhet me këtë program studimi, duke pasur parasysh edhe sugjerimin më herët në këtë raport për përditësimin me literature të 5 viteve të fundit.</p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se aktualisht për shkak të kufizimeve të vendosura si pasojë e situatës së Covid-19 dhe mungesës së studentëve në kampus, orari i bibliotekës ishte më i reduktuar.</p> <p>Në kohën kur mësimi zhvillohet në kampus orari i bibliotekës është i përcaktuar sipas orarit zyrtar të institucionit: e hënë - e premte, ora 08:30 - 12:30 / ora 13:00 - 16:30. Ky orar shpallet në ambientet e institucionit në hyrje të bibliotekës. Siç u informuam edhe nga studentët këto orare ishin në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor.</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="550 1131 730 1198">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="730 1131 976 1198">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="976 1131 1189 1198">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1189 1131 1428 1198">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="550 1198 730 1243"></td> <td data-bbox="730 1198 976 1243"></td> <td data-bbox="976 1198 1189 1243" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1189 1198 1428 1243"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							



#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti EPOKA disponon një sistem qendror të menaxhimit të informacionit i cili është Sistemi Interaktiv Epoka (EIS). EIS është zhvilluar nga Zyra Koordinuese e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për të menaxhuar të gjitha informacionet që lidhen me studentët dhe veprimtarinë e tyre nga viti i parë i regjistrimit deri në diplomim. EIS është një sistem modular i organizuar me ndërfaqës të ndryshëm sipas njësive dhe roleve në universitet dhe informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar ku përdoruesit mund të regjistrohen duke përdorur llogarinë e email-it të universitetit dhe ta aksesojnë atë online nëpërmjet linkut:</p> <p><a href="https://eis.epoka.edu.al">https://eis.epoka.edu.al</a>.</p>

	Gjatë vizitës në sekretari GVJ konstatoi se ky është një sistem i integruar i cili lidh sekretarinë, pedagogët dhe studentët. Informacioni për studentët në sekretari mbahet edhe në regjistra fizikë gjithashtu.
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Ashtu siç e përmendëm edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, EIS është një sistem modular informacioni i organizuar për çdo njësi përkatëse në universitet që ruan informacionin në një bazë të dhënash të centralizuar. Këtë e gjë GVJ e konfirmoi edhe gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore ku na u demonstrua se EIS ofron shumë funksionalitete për menaxhimin gjithashtu të informacionit dhe dokumentacionit të personelit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe personelit me kontratë të angazhuar në këtë program studimi. Të gjithë anëtarët e personelit mund të përdorin informacionin e tyre personal, përditësojnë detaje të përgjithshme dhe CV-të dhe mund të menaxhojnë detyra dhe aktivitete që lidhen me punën sipas rolit të tyre dhe pozicionit të punës.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.  <b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	GVJ u njoh me funksionalitetet dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të informacionit EIS në Zyrën e Burimeve Njerëzore, në Zyrën e Financës, në Sekretarinë Mësimore, në takimin me studentët dhe personelin akademik. Nga intervistat e zhvilluara në të gjitha rastet GVJ konstatoi se EIS ishte i përdorur gjerësisht dhe koordinonte më së miri shkëmbimin e informacionit midis të gjitha palëve.  Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në DVV dhe tek vizitat në secilën nga njësitë në institucion GVJ konstatoi se EIS ofron për studentët në profilin e tyre përdorimin e të dhënave personale dhe informacionin që lidhet me programin e tyre të studimit. Ata regjistrohen nëpërmjet sistemit në çdo lëndë që do të ndjekin dhe mund të shikojnë veprimtarinë akademike të vazhdueshme gjatë semestrit. Studentët mund të kontrollojnë pjesëmarrjen, datat e provimit, notat e përkohshme dhe notat përfundimtare. Gjithashtu në sistem ata mund të aksesojnë kurrikulën e programit, listën e notave, llogaritjen e notave, programin javor, kërkesat dhe njoftimet. EIS si një sistem i integruar në të gjitha nivelet e universitetit i njofton studentët kur janë në "zonën paralajmëruese" në lidhje me çështje financiare ose akademike. Ai i aftëson studentët të krijojnë plane për lëndët në mënyrë që të sigurojnë diplomimin në kohë.  Për personelin akademik EIS ofron akses në informacione rreth lëndëve aktuale dhe atyre të caktuara më parë. Lektorët mund të përditësojnë syllabus-in, të shohin pjesëmarrjen e studentëve në mësim, të vendosin dhe të finalizojnë notat. Nga ana tjetër, këshilltarët akademikë kanë akses në informacionin akademik të studentëve të caktuar për këshillim dhe mund të aprovojnë regjistrimin e lëndëve studentore përmes EIS. Hapja e lëndëve sipas emërtimit të lëndëve në çdo semestër bëhet nga koordinatoret e departamentit dhe miratohet nga Administratorët e fakulteteve. Koordinatorët mund të monitorojnë veprimtarinë akademike të pedagogëve të departamentit përkatës përmes EIS.  Për Zyrën e Pranimeve EIS ofron mundësinë për të futur në sistem të gjitha informacionet e regjistruara paraprakisht për studentët dhe për të caktuar bursat. Pasi studenti ka përfunduar regjistrimin, të gjitha informacionet e

	<p>lidhura të futura nga Zyra e Pranimeve, menaxhohen nga Zyra e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Për Zyrën e Financës EIS mundëson administrimin dhe përcjelljen e të gjitha informacioneve financiare të studentëve në lidhje me tarifat e shkollimit dhe bursave.</p> <p>Pra mund të konkludojmë që EIS ka të integruar të gjitha platformat që mundësojnë komunikimin interaktiv midis studentëve dhe personelit të universitetit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Bazuar tek intervistat gjatë vizitës në institucion, sikurse edhe në dokumentat e DVV, GVJ konstatoi se sistemi EIS nëpërmjet integritit të informacionit midis njësive të universitetit, të përmendura edhe në kriteret më sipër të këtij standardi, mundëson gjenerimin e raporteve sipas nevojave dhe kërkesave të organeve drejtuese dhe titullarëve të institucionit.</p> <p>Në Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore na konfirmuan se sistemi EIS ju mundësonte gjenerimin e raporteve në kohë reale jo vetëm për drejtuesit e institucionit por edhe për të përgatitur raportet periodike si pjesë e kërkesave të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të Departamentit të Administrim Bisnesit përgjegjës për këtë program studimi, gjenden të qarta dhe të detajuara në faqen e web-it të universitetit (<a href="http://bus.epoka.edu.al/home-business-administration-261-272.html">http://bus.epoka.edu.al/home-business-administration-261-272.html</a>).</p> <p>Informacionet janë në gjuhën angleze dhe në disa raste edhe në shqip.</p> <p>Pavarësisht se gjuha e programit të studimit është anglishtja, GVJ këshillon publikimin e plotë të tyre dhe në gjuhën shqipe në përputhje me standardin e kërkuar.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në DVV, Universiteti EPOKA i përcakton në Statutin e saj çështjet që lidhen me buxhetin, financat dhe asetet (Chapter XIV: Article 110, 111, 112, 113). Sipas statutit hartimi i buxhetit përgatitet nga Administratori i Universitetit bazuar në një plan afatmesëm 3 vjeçar dhe nga propozimet e marra nga strukturat e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë. Ai aprovohet nga Senati Akademik pasi është miratuar nga Bordi i Administrimit dhe është i realizuar në përputhje me standardet ligjore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të</p>	<p>Evidenca të raporteve financiare të kostove të programit të studimit i gjejmë në dokumentat e dorëzuara në DVV (<i>dokumenti 49 "Data from the annual institutional financial report related to the costs of the Bachelor in Business</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit". Nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)



faqe 61

<p>realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p><i>Informatics Study Program</i>” dhe dokumentin 3.4 “Annual Reports” i fundit është për vitin 2018-2019).</p> <p>Bazuar në informacionet e mësipërme GVJ konstaton se institucioni harton raporte financiare të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tij. Plani i financimit të programit të studimit i përmban të gjitha zërat që përcakton standardi të tilla si financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative si dhe zëra të tjerë në përputhje me natyrën specifike të tij.</p> <p>Bazuar tek dokumentat që GVJ shqyrtoi gjatë vizitës në institucion, por edhe ato që u dorzuan me kërkesë të GVJ pas vizitës (dokument 2. “Deloitte-Raport i Audituesit të pavarur dhe Pasqyrat Financiare për Vitin e Mbyllur më 31 dhjetor 2018”) u konstatua që institucioni ka kryer auditim për vitin 2018.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas RVB dhe bisedës me Përgjegjësën e Departamentit të Administrim Bisenit GVJ u informua që Turgut Ozal Education sh.a (nën varësinë e të cilit është Universiteti EPOKA) kryen një audit vjetor të jashtëm në lidhje me situatën financiare dhe të gjitha raportet e detajuara mund të gjendet në zyrën e Drejtorisë së Përgjithshme të Turgut Ozal Education sh.a.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se në mbyllje të çdo cikli studimi institucioni dokumenton raportet financiare dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme për të garantuar mbarëvajtjen e programit të studimit. Sipas dokumentave të dorzuara në DVV dhe RVB këto raporte financiare hartohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Turgut Ozal Education sh. a. çdo vit dhe arkivohet në këtë Drejtori. Me përfundimin e raportit të hartuar, të dhënat dhe analizat i komunikohen Universitetit EPOKA, një kopje e tyre gjendet në Zyrën e Financës dhe një tjetër në Zyrën e Administratorit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Në bazë të raporteve financiare pjesë e raporteve vjetore (link-et më poshtë) të shqyrtuara gjatë vizitës në institucion, si dhe atyre të dorzuara në DVV (dokumenti “Pasqyra e të Ardhurave dhe Deklarata e Shpenzimeve e Institucionit”), GVJ konstaton se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi studimi.</p> <p><a href="http://epoka.edu.al/mat/administration/Annual_Report_2015-2016.pdf">http://epoka.edu.al/mat/administration/Annual_Report_2015-2016.pdf</a></p> <p><a href="http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2016-2017.pdf">http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2016-2017.pdf</a></p> <p><a href="http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2017-2018.pdf">http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2017-2018.pdf</a></p> <p><a href="http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019.pdf">http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019.pdf</a></p> <p><a href="http://epoka.edu.al/mat/administration/Annual_Report_2019-2020_(Albanian).pdf">http://epoka.edu.al/mat/administration/Annual_Report_2019-2020_(Albanian).pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Universiteti Epoka ka hartuar procedura dhe politika të qarta në lidhje me ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Këtë gjë GVJ e konstaton në Rregulloren e Universitetit e vënë në dispozicion (dokumenti “Basic Regulation, Article 32, 33, 34” <a href="http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf">http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf</a>). Këto politika dhe procedura janë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi përkatësisht me me Ligjin Nr. 80/2015, dhe udhëzimin e MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019 si edhe Udhëzimin e MASR, Nr. 17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikatat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me Përgjegjësën e Departamentit të Administrim Biznesit, Zyrën e Sekretarisë Mësimore dhe Zyrën e Koordinimit të Studentëve, GVJ u informua se numri i studentëve që pranohen në këtë program studimi propozohet nga Bordi Administrativ i Universitetit dhe miratohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të pranimit dhe të ndjekin procedurën e regjistrimit e publikuar në:</p> <p><a href="http://admissions.epoka.edu.al/cat-bachelor-integrated-programs-admissions-1923.html">http://admissions.epoka.edu.al/cat-bachelor-integrated-programs-admissions-1923.html</a>.</p> <p>Të gjitha procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Kjo gjë është e përcaktuar edhe në Statutin e Universitetit EPOKA Neni 117, i cili përcakton të drejta dhe detyrime të barabarta për të gjithë studentët e regjistruar në çdo program studimi të ofruar nga ky universitet.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të</p>	<p>GVJ konstaton se Rregullorja e Universitetit (dokumenti “Basic Regulation” Chapter 6) përcakton qartësisht të gjitha kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, të përparimit gjatë studimeve, të transferimit, të njohjes së studimeve të mëparshme, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Këto kritere dhe procedura janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për cilindo që është i interesuar nëpërmjet faqes së web-it të universitetit.</p>

<p>diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se informacioni publikohet gjithashtu në rrjetet sociale të faqeve zyrtare të universitetit. Gjithashtu të interesuarit mund të kontaktojnë Zyrën e Pranimet për informacione të mëtejshme.</p> <p>Studentët që në fillim të studimeve marrin broshurën “Student Guide” e cila përmban rregulloret dhe kriteret e ndryshme në lidhje me gjithë shkollimin e tyre, për strukturën akademike, kreditet, detyrimet, etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorzuar në DVV si dhe gjatë takimeve në institucion GVJ konstatoi se përpara çdo viti akademik Senati Akademik i Universitetit EPOKA aprovon kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kandidatëve për tu pranuar në ciklin e parë të studimeve në përputhje me urdhrin e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit si më poshtë:</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Studentët duhet të disponojnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diplomë të shkollës së mesme ose ekuivalente me të;</li> <li>2. Mesatare CGPA minimale të shkollës së mesme 7.00 nga 10.00 ose CGPA ekuivalente;</li> <li>3. Nivelin e aftësive në gjuhën angleze B1 sipas CEFR në një nga provimet e mëposhtme: <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Cambridge</li> <li>b. IELTS</li> <li>c. TOEFL Internet-based Test (iBT)</li> <li>d. TOEFL Paper-based Test (ITP)</li> <li>e. TOEIC</li> <li>f. GESE</li> <li>g. APTIS i cili është provimi i aftësive në gjuhën angleze dhe zhvillohet nga Kosullata Britanike në Shqipëri, pranë ambjeteve të Universitetit EPOKA.</li> </ol> </li> </ol> <p>Në rastet kur studenti ka mbaruar studimet në një shkollë të mesme ku mësimi zhvillohet tërësisht në anglisht, ai lirohet nga detyrimi për të paraqitur dokumentin e gjuhës angleze.</p> <p>Të gjitha informacionet janë publikuar në faqen e internetit të Universitetit EPOKA: <a href="http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html">http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html</a>.</p> <p>Të gjitha kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me VKM mbi përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve (VKM 295, datë 10.05.2019) si dhe Ligjin Nr. 80/2015, Udhëzimet e MASR dhe vendimet e Senatit Akademik të Universitetit EPOKA. Gjithashtu Universitetit EPOKA pranon studentët të huaj sipas kuotave të miratuara nga MASR, numri i të cilëve është i kufizuar. Ata duhet të plotësojnë kriteret e pranimet dhe ndjekin procedurën e regjistrimit të parashikuara në Rregulloren e Universitetit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takimin me studentët dhe pedagogët, GVJ u informua që Universiteti EPOKA zhvillon çdo vit akademik takime</p>






<p>interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>informuese me maturantët, disa muaj përpara maturës shtetërore dhe vendimmarrjes së tyre për të zgjedhur programet e studimit që duan të ndjekin. Gjithashtu në bazë të dokumentave të dorzuara në DVV, GVJ u informua se është Zyra e Pranimit ajo që organizon programet për planifikimin e karrierës për maturantët e shkollave të mesme. Njëpërmjet këtyre programeve studentët e interesuar për të studiuar në programet e studimit të Universitetit EPOKA ftohen të marrin informacione të detajuara për universitetin, kriteret e pranimit, kërkesat për regjistrim, etj. Më pas informacionet për programin e studimit të zgjedhur jepen nga Koordinatorin e programit dhe stafi akademik. Përveçse njëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me stafin e universitetit, kandidatët e interesuar për të studiuar në Universitetin EPOKA e marrin informacionin e nevojshëm njëpërmjet:</p> <p><a href="http://admissions.epoka.edu.al/home-enrollment-procedure-495-1927.html">http://admissions.epoka.edu.al/home-enrollment-procedure-495-1927.html</a>  <a href="http://eis.epoka.edu.al/curricula">http://eis.epoka.edu.al/curricula</a>  <a href="http://eis.epoka.edu.al/curricula/90/program">http://eis.epoka.edu.al/curricula/90/program</a></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="552 707 762 763">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="762 707 975 763">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="975 707 1187 763">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1187 707 1394 763">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td align="center"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorzuar në DVV (<i>Rregullorja e Universitetit: "Basic Regulation" Chapter 6</i>), si dhe në takimin me studentët dhe pedagogët, GVJ konstaton që Universiteti EPOKA ju mundëson studentëve akses të plotë në sistemin e informacionit EIS, ku ata mund të marrin të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe ato për kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Përveç sistemit elektronik të informacionit ku kanë akses vetëm studentët dhe personeli i institucionit, informacioni mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, është i hapur për të gjithë edhe në: <a href="http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf">http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf</a>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorzuar në DVV (dokumenti "Directive on Student Transfer"), GVJ konstaton se institucioni i aplikon procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme, studimeve të pjesshme, ose transferimeve të studentëve duke u mbështetur tek Rregullorja e Universitetit, Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, si dhe në kushtet e përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Gjatë intervistës me Përgjegjësin e Departamentit të Administrim Biznesit dhe përfaqësuesit e Zyrës së Pranimeve, GVJ u informua që transferimet mund të bëhen në semestrat 3 deri 5, dhe mund të njihen jo më shumë se 2/3 e lëndëve që studenti mund të ketë marrë në programin e mëparshëm të studimit. Transferimet lejohen nga programe të ngjashtme brenda universitetit ose jashtë tij. Studentët regjistrohen në Zyrën e Pranimit, plotësojnë formularin përkatës dhe e paraqesin atë pranë Zyrës së Sekretarisë Mësimore. Aplikimet shqyrtohen nga departamenti dhe i përcillen Dekanatit të Fakultetit për miratim përfundimtar. GVJ konstaton se të gjithë</p>



Adresa: "Rruga e Durrësit". Nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

faqe 65

	<p>studentët e interesuar mund ta gjejnë lehtësisht këtë informacion jo vetëm në Zyrën e Pranimit por edhe në faqen e web-it të universitetit:</p> <p><a href="http://registrar.epoka.edu.al/cat-rules-regulations-490.html">http://registrar.epoka.edu.al/cat-rules-regulations-490.html</a>.</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët, pedagogët dhe përfaqësues të Zyrës së Pranimeve GVJ u informua se që në fillim të vitit të parë akademik të studimeve të tyre studentët marrin broshurën “<i>Student Guide</i>” e cila është një udhëzues praktik me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit (kohëzgjatjen e studimeve, organizimin e programit, pjesëmarrjen në klasë dhe vlerësimin). Gjithashtu informacionin në lidhje me vlerësimin e dijeve studentët e marrin në fillim të çdo semestri për çdo lëndë nëpërmjet prezantimit që ju bëhet nga pedagogu i lëndës, si dhe nëpërmjet syllabusit që paraqet në detaje kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve. Këto informacione janë lehtësisht të aksesueshëm edhe nëpërmjet Rregullores së Universitetit në faqen e web-it të universitetit si dhe në Kurrikulën e Programit të Studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike:</p> <p><a href="http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf">http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf</a></p> <p><a href="http://eis.epoka.edu.al/curricula/90/program">http://eis.epoka.edu.al/curricula/90/program</a>.</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni i dorzuar në DVV, GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka përcaktuar të gjitha kriteret dhe procedurat për kryerjen e punimit të diplomës dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike. Këto kriteret dhe procedura gjenden në Rregulloren e Universitetit Article 56, si dhe në dokumentin “Directive on Graduation Works of Undergraduate Programs”. Studentët mund ti aksesojnë këto dokumenta lehtësisht nëpërmjet faqes së web-it të universitetit. Ata informohen për procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit edhe nga tutorët e tyre si dhe nëpërmjet dokumentit “Thesis Writing Guideline”.</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Ashtu sikurse është përmendur edhe në Standardin V.1 Kriteri 6 i këtij raporti, Universiteti EPOKA zhvillon çdo vit akademik takime informuese me maturantët, disa muaj përpara maturës shtetërore dhe vendimmarrjes së tyre për të zgjedhur programet e studimit që duan të ndjekin. Përveçse nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me stafin akademik të universitetit, dhe Zyrën e Pranimeve, kandidatët e interesuar për të studiuar në Universitetin EPOKA e marrin informacionin e nevojshëm nëpërmjet:</p> <p><a href="http://admissions.epoka.edu.al/home-enrollment-procedure-495-1927.html">http://admissions.epoka.edu.al/home-enrollment-procedure-495-1927.html</a></p> <p><a href="http://eis.epoka.edu.al/curricula/90/program">http://eis.epoka.edu.al/curricula/90/program</a></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

**Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ka një kohëzgjatje prej 3 vitesh dhe studentët në fund të diplomimit pajisen me 180 kredite evropiane (ECTS) dhe u jepet diploma Bachelor në Informatikë Ekonomike (<i>bazuar tek Statuti i Universitetit EPOKA Article 83, si dhe kurrikula e programit të</i></p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”. Nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

faqe 66






<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p><i>studimit</i>). Të gjitha informacionet në lidhje me strukturën e këtij programi studimi, organizimin dhe kohëzgjatjen ju vihen në dispozicion studentëve që në fillim të studimeve të tyre nëpërmjet Zyrës së Pranimeve me anë të broshurës “Student Guide” si dhe nga koordinatori i programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se gjishtashtu informacione të hollësishme studentët marrin edhe në fillimit të çdo semestri, nëpërmjet pedagogëve të lëndëve të cilët ju shpjegojnë programin lëndor, i cili përmban informacione rreth planit të studimit, metodës së vlerësimit dhe materialeve të lëndës, objektivave formuese, aftësive që fiton studenti, etj.</p> <p>Çdo informacion në lidhje me këtë program studimi përsa i përket strukturës, organizimit, kohëzgjatjes së programit, moduleve, lëndëve, përmbajtjes dhe veprimtarive formuese është lehtësisht i aksesueshëm edhe nëpërmjet faqeve të web-it të Departamentit të Administrim Biznesit:</p> <p><a href="http://bus.epoka.edu.al/home-business-informatics-261-273.html">http://bus.epoka.edu.al/home-business-informatics-261-273.html</a>  <a href="http://epoka.edu.al/mat/Bussines%20administration/course-description/business-informatics.pdf">http://epoka.edu.al/mat/Bussines%20administration/course-description/business-informatics.pdf</a>  <a href="http://eis.epoka.edu.al/curricula/90/program">http://eis.epoka.edu.al/curricula/90/program</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar tek dokumentacioni në DVV si dhe tek RVB, konstatohet se Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar informon studentët për praktikën dhe mundësitë e punësimit. Kjo zyrë në bashkëpunim me Departamentin e Administrim Biznesit mban lidhje me organizatat publike dhe private me qëllim orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Ajo organizon çdo vit Panairin e Karrierës për të prezantuar tek studentët mundësitë e punësimit që ofrojnë organizatat e ndryshme. Gjithashtu edhe në faqen e web-it <a href="http://cpao.epoka.edu.al/home-seventh-career-fair-2020-1593-2974.html">http://cpao.epoka.edu.al/home-seventh-career-fair-2020-1593-2974.html</a> janë të afishuara një sërë ofertash punësimi ose intership-ji. Megjithatë në takimin e zhvilluar me studentët ata na pohuan se shumicën e pozicioneve që kërkonin njohuri të informatikës ata nuk i përballojnë dot ose vetë ofruesit nuk preferojnë të diplomuar të kësaj dege sepse njohuritë e tyre janë shumë të përgjithshme. Sugjerojmë një thellim të njohurive në lëndët e Informatikës në mënyrë që njohuritë e fituara nga programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike të përputhet me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Nga ana tjetër ashtu sikurse është cilësuar edhe më herët në këtë raport, konstatohet se nga ana e Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar (ZPKSD) kryhen në mënyrë periodike studime tregu pas daljes së studentëve (i fundit që gjejmë në DVV i takon qershorit të vitit 2019, shtojca 1.9). Ndër dokumentat në DVV haset edhe shtojca 6.12 “Pyetësor për kënaqsinë e kompanive” e cila në thelb është një përpjekje e Institucionit të vlerësojë sa të kënaqura janë bizneset me studentët e diplomuar nga Universiteti EPOKA, por pa bërë lidhje të drejtpërdrejtë me programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike.</p> <p>Në lidhje me këtë kriter RVB referon Rregulloren e Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar (Shtojca 5.1) e cila nuk gjendet në DVV.</p> <p>Pas vizitës së GVJ në Institucion, ky i fundit dorëzoi dhe u ngarkua në sistemin e ASCAL, dokumenti „Career Planning Office Procedures“ në Shtojcën 6, të cilin GVJ e merr në konsideratë.</p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe në takimin me studentët dhe pedagogët, GVJ u informua dhe konstatoi që Departamenti i Administrim Biznesit në fillim të semestrit të çdo viti akademik shpall në ambiente publike orarin mësimor: ditën, orën, sallën dhe personelin akademik përkatës për realizimin e programit mësimor. Informacion më i detajuar në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, etj, studentëve ju jepet drejtpërdrejt edhe nga pedagogët e tyre.</p> <p>Në lidhje me këtë kriter RVB referon Shtojcën 5.3.4 4 “Udhëzues Praktik i Studentit” e cila nuk gjendet në DVV.</p> <p>GVJ merr në konsideratë në shpjegimin e komenteve në lidhje me këtë kriter që dokumenti i referuar nga GVB në Shtojcën 5.3.4.4 „Udhëzues Praktik i Studentit“ është dokumenti „Smart Student Guide“. GVJ sugjeron që referimi të bëhet në gjuhën angleze meqë përkthimi në shqip është një përshtatje.</p>			
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Ashtu sikurse është evidentuar edhe më parë në këtë raport, mbështetur edhe në intervistat me studentët, GVJ konstaton se institucioni përdor sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit EIS. Studentët kanë akses të plotë në informacionin e tyre personal dhe informacionin që lidhet me programin e tyre të studimit. Nëpërmjet sistemit EIS ata mund të regjistrohen në lëndët e ndryshme, të kontrollojnë statusin e tyre akademik gjatë semestrit, datat e provimeve, notat e ndërmjetme dhe notat përfundimtare. Nëpërmjet sistemit EIS, studentët njihen me kurrikulën e programit, llogaritjen e notave, programin javor, kërkesat dhe njoftimet, etj. Çdo informacion në lidhje me këtë program studimi dhe ecurinë e studentëve në të është lehtësisht i aksesueshëm nëpërmjet EIS si në mjediset e universitetit dhe në distancë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

<p><b>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses</p>	<p>GVJ u informua se statistikat vjetore i mban Sekretaria Mësimore, mesataret në hyrje dhe në dalje, rekordet për të larguarit, transferimet, etj. Kjo zyrë disponon regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave. GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat ruhen në formë të shkruar (hard copy) si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit EIS.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion përfaqësues të zyrës së sekretarisë na vunë në dispozicion regjistrin themeltar të studentëve për këtë program studimi. Gjithashtu GVJ u njoh me statistikat për numrin e studentëve e të diplomuarve, largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit, statistika këto lehtësisht të verifikueshme në regjistrin themeltar. Bazuar në dokumentin: “Quality of</p>

të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

enrolled and graduated students (Table 21)” tabelat e mëposhtëme paraqesin për gjashtë vitet e fundit akademike përkatësisht:

Tabela 1: Numri i të regjistruarve dhe mesatarja përkatëse

Viti akademik	Student të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje CGPA
2015-2016	55	9.48/10
2016-2017	77	9.14/10
2017-2018	65	9.16/10
2018-2019	87	9.28/10
2019-2020	135	9.3/10
2020-2021	137	9.24/10

Tabela 2: Numri i të diplomuarve dhe mesatarja përkatëse

Viti akademik	Numri i studentëve të diplomuar	Nota mesatare GPA
2015-2016	32	3.13/4.0
2016-2017	34	2.87/4.0
2017-2018	41	3.05/4.0
2018-2019	66	2.8/4.0
2019-2020	55	2.86/4.0
2020-2021	-	-

Tabela 3: Numri i studentëve të transferuar dhe atyre të larguar

Viti akademik	Student të transferuar	Studentë të larguar
2015-2016	0	4
2016-2017	0	6
2017-2018	2	10
2018-2019	2	13
2019-2020	4	13
2020-2021	2	5

**Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.

**Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Sekretaria e Universitetit Epoka operon në përputhje me nenin 101 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 duke disponuar dokumentacionin e procesit mësimor që përkakton ligji. Të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi i tyre dhe deri në diplomim regjistrohen në procesverbalet e provimeve të cilat ngarkohen në sistemin elektronik të menaxhimit të informacionit EIS dhe regjistrohen më pas në regjistrin e notave në “hard copy”.

GVJ i shqyrtoi këto informacione gjatë vizitës në institucion në takimin me përfaqësuesit e zyrës së Sekretarisë Mësimore.

Sistemin i brendshëm të informacionit EIS është i ndërtuar në module dhe i mundëson ndërfaqës dhe raporte të personalizuar të gjithë pjestarëve që kanë akses në të. Nëpërmjet tij menaxhohen të dhënat statistikore të studentëve në lidhje me gjithë veprimtarinë e tyre mësimore që në hyrje deri në dalje. Në këtë sistem kanë akses studentët në llogaritë e tyre personale, pedagogët sipas moduleve apo lëndëve që drejtojnë si dhe sekretaria, e zyra të tjera të universitetit. Sekretaria mësimore dhe zyrat e tjera që kanë akses në këto të dhëna i përpunojnë dhe përdorin të dhënat personale të studentëve bazuar në parimin e kofidencialitetit

	dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. I gjithë informacioni në sistem është lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar që kanë akses në të.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Gjatë takimit me përfaqësues të zyrës së Sekretarisë Mësimore GVJ u informua që kjo zyrë harton raporte periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Ajo raporton numrin e studentëve aktualë dhe të diplomuar periodikisht çdo vit akademik si të dhëna statistikore të kërkuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Këto raporte gjenden edhe në dokumentacionin e dorzuar në DVV:</p> <p>(<a href="http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2017-2018.pdf">http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2017-2018.pdf</a>  <a href="http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019.pdf">http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019.pdf</a>)</p> <p>Në këto raporte nuk paraqitet ndonjë tregues ose analizë për shkallën e cilësisë së punësimit të tyre dhe masat që duhen marrë në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p>Sipas RVB Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar është njësi përgjegjëse për të siguruar bazën e të dhënave të saktë dhe të plotë të studentëve të diplomuar duke kontaktuar ata me telefon, përmes postës ose nga rrjetet sociale. Ajo zhvillon çdo vit Anketën e studentëve të diplomuar të Epokës dhe rezultatet e krijuara dërgohen në programin përkatës të studimit dhe publikohen në faqen zyrtare të zyrës. Megjithatë GVJ nuk evidentoi të dhëna të tilla në faqen e sugjeruar nga RVB: <a href="http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-2018-1457-2596.html">http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-2018-1457-2596.html</a>.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve dhe angazhimi i tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të Universitetit Epoka bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi (neni 98 dhe 99 i Ligjit Nr. 80, 2015) dhe garantohet nëpërmjet Statutit të Universitetit EPOKA (neni 15, 16, 29, 34 dhe 35). Studentëve ju jepet e drejta të kenë përfaqësues në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Senatin Akademik;</li> <li>- Bordin e Etikës;</li> <li>- Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë;</li> <li>- Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore.</li> </ul> <p>Përfaqësuesit e studentëve në këto organe zgjidhen nga Këshilli Studentor i Universitetit EPOKA. Ky këshill është organi më i rëndësishëm studentor i universitetit, i përbërë nga përfaqësues të studentëve të zgjedhur përmes një procesi të përgjithshëm zgjedhor në mënyrë demokratike, modalitetet për</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me	

Adresa: "Rruga e Durrësit". Nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

faqe 70

<p>rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>zgjedhjen e anëtarëve si dhe për organizimin dhe funksionimin e tij përcaktohen në nenin 118 të Statutit të Universitetit EPOKA.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se përfaqësimi i studentëve në Senatin Akademik, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Këshillin e Etikës siguron përfshirjen e studentëve në vendimmarrjen që lidhet me çështje që i përkasin procesit akademik. Ndërkohë që përfaqësimi i tyre në Komisionin e Përhershëm për Marrëdhëniet Studentore siguron përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve në dhënien e rekomandimeve për Senatin Akademik për çështje të ndryshme që lidhen me aktivitet jashtëshkollore të kryera nga klubet studentore, jetën e studentëve në ambientet universitare dhe shërbimet e ofruara për ta, kryerjen e praktikës nga studentët, marrëdhëniet me studentët e diplomuar, etj.</p> <p>Në bazë bisedave me përfaqësuesit e studentëve dhe Koordinatorin e programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, GVJ konstaton se përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse të universitetit është reale dhe konkrete duke adresuar shqetësimet dhe nevojat e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit në DVV (<a href="#">Annex 2.1 BINF program curricula.pdf</a>; <a href="#">Annex 2.2 Statuti Uni EPOKA shq.pdf</a>) programi i studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike ka 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatje normale tre vite akademik ose gjashtë semestra. Barra akademike për studentët për çdo semestër është 30 ECTS. Kreditet minimale europiane për një lëndë janë 5 ECTS dhe maksimumi 6 ECTS. GVJ konstaton se gjatë hartimit dhe përmirësimit të këtij programi studimi, ngarkesa e mësipërme akademike është marrë në konsideratë. Gjithashtu siç është përmendur edhe më herët në këtë raport (Standardi V.2, Kriteri 1 dhe 2) procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve apo dhe njohjet e studimeve të mëparshme janë të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme nga studentët.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Bazuar tek RVB dhe dokumentacioni i dorzuar në DVV, GVJ konstaton se institucioni që prej vitit 2018 - 2019 realizon vlerësimin e departamenteve për secilin program studimi (bazuar në dokumentin “EPOKA University Policy: On Continuous Improvement of Study Programs”). Ky vlerësim përfshin informacionin e treguesve kryesorë të performancës për secilin program studimi. Gjithashtu në dokumentacionin e dorëzuar gjejmë procedurat për përmirësimin e kurrikulave (<a href="#">52.2 Curricula change procedure.pdf</a>) por GVJ nuk konstatoi në DVV asnjë dokument apo analizë për rishikim të programit të studimit në bazë të ndonjë propozimi nga studentët apo në bazë të analizës së bërë nga rezultatet e anketave. As në RVB nuk jepet një referencë e tillë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në bazë të RVB, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon seanca informuese për studentët të cilët inkurajohen të plotësojnë Anketat e Vlerësimit të Instrukturëve të Lëndës, të cilat i mundësojnë departamentit një informacion të rëndësishëm që përdoret për përmirësimin e veprimtarive mësimore. Në RVB nuk ka referencë për raportet e vlerësimit dhe këto raporte nuk gjenden në DVV, në mënyrë që GVJ të evidentojë specifikisht mendimet apo shqetësimet e studentëve në lidhje me kontrollin e dijeve apo çështjeve të tjera dhe reflektimet e institucionit për përmirësimin e tyre.</p>




	Kurse përsa i përket rishikimit të provimeve, në takimet me studentët GVJ u informua që studentëve ju jepet mundësia të diskutojnë në lidhje me procesin e vlerësimit, dhe kanë mundësi të ankimojnë rezultatin e marrë në provime, bazuar tek Rregullorja e Universitetit, duke kërkuar rishikim të vlerësimit brenda 1 jave nga marrja e rezultatit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përkrahje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Ashtu sikurse është përmendur edhe në Standardin V.2 të këtij raporti, GVJ konstaton se institucioni ka njësi të posaçme, e cila është Zyra e Pranimeve, në shërbim të informimit të studentëve. Që në fillim të studimeve të tyre studentët pajisen me broshurën “Student Guide” e cila është një udhëzues praktik me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit të tyre. Gjithashtu sipas RVB në dispozicion të studentëve është Dekani i Studentëve, i cili pranon kërkesat apo shqetësimet e studentëve për çështje të ndryshme akademike sipas një procedure dhe formulari standard. Kërkesat shqyrtohen nga Dekani i Studentëve, Administratori i Universitetit ose njësi të tjera administrative që janë nën Administratorin. Pas vlerësimit të kërkesës, Zyra e Dekanit të Studentëve informon me e-mail studentët me vendimin e marrë në lidhje me kërkesën e tyre.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Gjatë takimit me pedagogët në institucion GVJ u informua se stafi akademik është i angazhuar plotësisht në këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Gjithashtu në takimin me studentët na u konfirmua një gjë e tillë duke pohuar se këto këshillime ishin shumë ndihmuese për ta.  Në bazë të RVB dhe takimeve në institucion, në Zyrën e Sekretarisë Mësimore dhe Zyrën e Koordinimit të Studentëve, GVJ konstaton se këto zyra në bashkëpunim me fakultetet organizojnë në fillim të vitit akademik Ditët e Orientimit për studentët e vitit të parë, kurse Zyra e Pranimeve i pajis ata me “Student Guide” që përmban informacione të hollësishme për jetën e studentit, nga regjistrimet deri në diplomim.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe	Nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar studentët informohen në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Sipas RVB kjo zyrë shërben për të orientuar studentët në punësimin e tyre si dhe për të mbajtur një dialog të Universitetit me botën e biznesit.  GVJ konstaton se Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar ju vjen në ndihmë studentëve me këshilla në kuadër të planifikimit dhe nisjes së karrierës së tyre, duke ju mësuar atyre si të përgatisin një CV, një letër motivimi

Adresa: “Rruga e Durrësit”. Nr. 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

faqe 72



orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	apo si të përballen në intervistat e punës apo intervistat gjatë Panairit të Karrierës. Ajo është organizuese e Panairit të Karrierës që prej 7 vitesh. <a href="http://cpao.epoka.edu.al/home-seventh-career-fair-2020-1593-2974.html">http://cpao.epoka.edu.al/home-seventh-career-fair-2020-1593-2974.html</a> .			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjatë takimit me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar, GVJ u informua se ata kontaktojnë me studentët e diplomuar për tu marrë informacione në lidhje me punësimin e tyre dhe sugjerime në lidhje me përmirësimin e programit për t'ju përshtatur kërkesave të tregut të punës. Ata na informuan që kjo zyrë nëpërmjet Vrojimit të Studentëve që zhvillon çdo vit mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Në faqen e web-it të kësaj zyre: <a href="http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-2018-1457-2596.html#">http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-2018-1457-2596.html#</a> ka informacion vetëm për shkallën e punësimit në % të studentëve në vitin 2019, dhe shpërndarjen e tyre në sektorë të ndryshëm publik apo privat. Në dokumentacionin e dorzuar në DVV apo në RVB nuk ka asnjë referencë për ndonjë raport apo analizë të kryer nga kjo zyrë lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstaton se Universiteti EPOKA ka hartuar politika dhe ka ngritur struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015. Struktura kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë i cili përbëhet nga nën-njësitë e tij si: Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve. Struktura dhe funksionimi i njëjësive përkatëse janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit EPOKA (Article 35&37 Shtojca 6.13), në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e PCQA (Shtojca No 6.1) si dhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë të Universitetit EPOKA (shtojca No. 6.15), të disponueshme edhe në adresën: <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance -documents-1404.html">http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance -documents-1404.html</a> .



	Gjithashtu, universiteti ka krijuar Politikën e Cilësisë (shtojca No. 6.7) që mbulon politikat në lidhje me parimet dhe standardet kryesore të sistemit të menaxhimit të cilësisë në përdorim në Universitetin EPOKA.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>GVJ në bazë të dokumentave të dorzuara në DVV konstaton se sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në Universitetin EPOKA, i përbërë nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe njësitë e tij, Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordin e Provimeve operon në përputhje me Statutin e Universitetit EPOKA, Rregulloren për Funksionimin e KPSC si dhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë së Universitetit EPOKA:</p> <p>(<a href="http://aeqi.EPOKA.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html">http://aeqi.EPOKA.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html</a>).</p> <p>Në bazë të dokumentave:</p> <p>(<a href="#">Annex 6.1-Regulation On the Organization and Functioning of the PCQA revised.pdf</a>; <a href="#">Annex 6.2-Directive Acad Admin Perfor Assess Quality Improv.pdf</a>; <a href="#">Annex 6.3-Policy on Continuous Improvement of Study Program.pdf</a>; <a href="#">Annex 6.7-Quality Policy.pdf</a>; <a href="#">Annex 6.15 Quality Assurance Handbook.pdf</a>)</p> <p>GVJ është i mendimit që institucioni zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe sistemi i ngritur është funksional.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që fokusi kryesor është evidentimi dhe ndjekja e problematikave të lidhura me cilësinë e mësimdhënies, vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, organizimi dhe ndjekjen e zhvillimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi. Në bazë të dokumentit “Regulation on the Organization and Functioning of the Permanent Commission on Quality Assurance, Article 4”, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë përbëhet nga 8 anëtarë (sipas Raportit Vjetor 2019 – 2020 të Universitetit EPOKA janë 11 anëtarë) ku 2 janë përfaqësues të studentëve dhe alumni dhe 1 është ekspert i jashtëm. Studentët janë gjithashtu të përfshirë në përgatitjen e Raporteve të Vlerësimit të Brendshëm, të hartuara në kuadër të akreditimit të institucionit dhe programeve të studimit.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	<p>Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 92, datë 20. 10. 2017 është vendosur Akreditimi Institucional i Universitetit EPOKA, me vlerësim përfundimtar pozitiv, me kohëzgjatjen prej 4 (katër) vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së Akreditimit Institucional është 19.10.2021. UEPOKA është në proces riakreditimi institucional.</p> <p>Gjithashtu me Urdhër Nr. 358, datë 25.09.2015 është bërë akreditimi i programit Bachelor në Informatikë Ekonomike për periudhën 25.09.2015 – 25.09.2021. Bazuar tek dokumenti “Epoka University Policy on Continuous Improvement of Study Programs”, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi Universiteti EPOKA realizon Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë përmes vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë	Në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Universiteti EPOKA ka hartuar politika dhe procedura periodike që synojnë përmirësimin e programeve të





<p>dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>studimit që ofron. Në bazë të dokumentave (“Epoka University Policy on Continuous Improvement of Study Programs”, “Epoka University Quality Policy”) GVJ konstaton se Universiteti organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të performancës së programeve të studimit. Kjo analizë mbështetet tek baza e të dhënave të vlerësimit sipas departamenteve, e cila përfshin indikatorë të performancës në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor, përgjegjësitë ndaj shoqërisë, etj, si dhe tek raportet vjetore të departamenteve dhe çdo masë tjetër strategjike që ndërmarrin ato. Nëpërmjet rishikimit periodik të performancës së programeve të studimit, Universiteti Epoka synon të sigurojë suksesin e vazhduar të programeve të studimit që ofron.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Sipas Statutit të Universitetit EPOKA Neni 35, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë është organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik. Senati Akademik ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe njësitë e tij mbështetëse: Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordin e Provimeve. Megjithatë përgjegjësia për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike fillon nga Departamenti i Administrim Biznesit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Sipas RVB dhe dokumentave të tjera të dorzuara në DVV, GVJ konstaton se institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. Siç e thamë më lart për monitorimin dhe rishikimin e këtij programi Departamenti i Administrim Biznesit bazohet në dokumentin “Policy on Continuous Improvement of Study Programs” Aneks 6.3. Propozimi i departamentit për përmirësimin e kurrikulës fillimisht shqyrtohen nga Dekanati. Më pas vendimi mbi propozimet për përmirësimin e programit të studimit dërgohet në Komisionin e Zhvillimit të Kurrikulave, kalohet për shqyrtim në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, më pas Senati Akademik merr vendimin përfundimtar mbi përmirësimin e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përdor metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. Në dokumentin “Regulation on the Organization and Functioning of the Permanent Commission on Quality Assurance” është parashikuar veprimtaria e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, e cila ndër të tjera fokusohet tek përgatitja e standardeve dhe metodologjisë për hartimin e formateve për sondazhet studentore dhe të stafit, bazuar tek dokumenti</p>

	<p>“Quality Assurance Handbook”. Vlerësimi i procesit mësimor bëhet nëpërmjet pyetsorëve formati i të cilave përcaktohet në dokumentat:</p> <p><u><a href="#">Academic Staff Satisfaction Survey.pdf</a></u>; <u><a href="#">Course Instructor Evaluation Survey.pdf</a></u>; <u><a href="#">Student Satisfaction Survey.pdf</a></u>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe mbështetur tek bisedat me pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe direktiva të qarta për vlerësimin e ecurisë dhe mbarëvajtjes së programeve të studimit. Vlerësimi kryhet përkatësisht nëpërmjet:</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Anketës së Vlerësimit të Lektorit të Lëndës që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri për të vlerësuar pedagogun dhe përmbajtjen e kursit.</li> <li>• Anketës së Studentëve në lidhje me shërbimin që organizohet nga Zyra e Koordinimit të Studentëve.</li> <li>• Anketës së Alumni që kryhet çdo vit akademik nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar për të zbuluar zbatueshmërinë dhe praktikitetin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara nga programi i studimit.</li> <li>• Anketimit të kompanive punëdhënëse që kryhet çdo vit akademik nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentët e Diplomuar për të marrë informacionet e duhura mbi performancën e të diplomuarve të Universitetit EPOKA në tregun e punës.</li> <li>• Anketimit të pedagogëve që kryhet çdo vit akademik nga Zyra e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë për të marrë opinionet e tyre në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet në Universitet.</li> </ul> <p>Sipas RVB në bazë të rezultateve të pyetsorit të studentëve çdo departament përgatit një raport i cili përfshin të dhëna sasiore, cilësore, analiza dhe plan veprimi. Gjithashtu institucioni realizon Raportin Vjetor të Bordit të Provimeve për cilësinë e përmbajtjes së provimit dhe vlerësimit. Institucioni ofron analiza vjetore për vlerësimin e progresit të programeve të studimit, të cilat përfshijnë të dhëna për aspektet akademike dhe performancën e studentëve, siç janë niveli i kalueshmërisë dhe mësimdhënia. Këto raporte janë pjesë e raporteve vjetore të përgatitura nga Universiteti dhe nga Departamentet përkatëse.</p> <p>Në RVB thuhet se Rezultatet e vlerësimeve të përmendura janë dokumentuar dhe janë paraqitur në Departamentet përgjegjëse për programet e studimit, Dekanat, Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Rektorat dhe në Senatin Akademik.</p> <p>Megjithatë GVJ nuk gjen asnjë dokument apo reference në RVB për raportet e sipërpërmendura. Të gjitha referencat që citohen në RVB kanë të bëjmë me strategjitë, politikat apo direktivat që lidhen me monitorimin dhe shqyrtimin e programeve të studimit dhe performancës së tyre. Bazur tek Raporti Vjetor 2019 – 2020:</p>

	(http://epoka.edu.al/mat/administration/Annual_Report_2019_2020.pdf) GVJ konstaton se Universiteti EPOKA gjatë vitit akademik 2019- 2020 mori pjesë në renditjet prestigjioze të Universiteteve të kryera nga QS Rankings, Webometrics dhe U -Multirank. Ky është një informacion për tu vlerësuar, por në RVB nuk ka asnjë referencë për këtë fakt.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	


### Standardi VI.3

#### Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ konstaton se Universiteti EPOKA kryen në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, në kuadër të vetvlerësimit institucional në funksion të procesit të akreditimit. Institucioni realizon analiza vjetore për vlerësimin e progresit të programeve të studimit, të cilat përfshijnë të dhëna për aspektet akademike dhe të dhëna për performancën e studentëve, siç janë niveli i kalueshmërisë dhe mësimdhënia. Këto raporte janë pjesë e raporteve vjetore të veprimtarisë të përgatitura nga universiteti dhe nga departamentet përkatëse. Raportet përfshijnë gjithashtu rezultate të anketave të studentëve dhe raportet e vlerësimit të brendshëm.  Të gjitha dokumentat që mbështesin konstatimet e mësipërme gjenden në:  <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html">http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html</a>  <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html">http://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html</a>  <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html">http://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html</a>
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Ashtu siç është përmendur edhe më parë në këtë raport (Standardi VI.2) institucioni përdor metoda e instrumente të posaçme dhe të përshtatshme për kryerjen e vlerësimit të këtij programi studimi. Vlerësimi i procesit mësimor bëhet nëpërmjet pyetësorëve formati i të cilave përcaktohet në dokumentat: <a href="#">Academic Staff Satisfaction Survey.pdf</a> ; <a href="#">Course Instructor Evaluation Survey.pdf</a> ; <a href="#">Student Satisfaction Survey.pdf</a> .  Metodat dhe instrumentat e përdorura përcaktohen nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe njësitë përbërëse të tij nëpërmjet “EPOKA University Quality Assurance Documents” që gjenden në: <a href="http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html">http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html</a> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si	GVJ u informua gjatë takimit me pedagogët, Përgjegjësin e Departamentit të Administrim Biznesit, por edhe studentët se në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit, institucioni përdor përveç metodave të standardizuara të kontrollit, siç

<p>vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>janë pyetsorët e studentëve dhe formularët e vlerësimit për performancën e pedagogëve edhe metoda të drejtpërdrejta si p.sh. vëzhgime të zhvillimit të orëve të mësimi në auditor apo zhvillimin e leksioneve të hapura. Gjithashtu në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies institucioni realizon një sërë aktivitete për trajnimin e pedagogëve për përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies sidomos atyre që ofrohen përmes platformave online.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Përveç metodave të drejtpërdrejta të kontrollit për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike, përdoren edhe metoda të tërthorta nëpërmjet intervistave dhe sondazheve, kryesisht të fokusuar tek alumni pas diplomimit të tyre si dhe tek kompanitë punëdhënëse për të vlerësuar përputhshmërinë e programit të studimit me nevojat e tregut të punës dhe shkallën e punësimit të të diplomuarve. Anketa e Alumni dhe ajo e Kompanive kryhet çdo vit akademik nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar.</p> <p>Gjithashtu siç është përmendur më sipër në Standardin VI.2 institucioni realizon sondazhe dhe intervista me studentët dhe pedagogët që lidhen me aspekte të tjera të shërbimeve dhe mardhënieve të tyre në Universitetin EPOKA, përveç atyre që lidhen drejtpërdrejt me mësimin. Nga këto mund të përmendim: Anketën e Studentëve në lidhje me shërbimin që organizohet nga Zyra e Koordinimit të Studentëve; Anketimin e pedagogëve që kryhet çdo vit akademik nga Zyra e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë për të marrë opinionet e tyre në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet në Universitet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Ashtu siç është përmendur edhe në Standardin VI.1, Universiteti EPOKA ka hartuar politika dhe ka ngritur struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Struktura kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë i cili përbëhet nga nën-njësitë e tij si: Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve. Struktura dhe funksionimi i njëjësive përkatëse janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit EPOKA (Article 35&amp;37 Shtojca 6.13), Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e PCQA (Shtojca No 6.1) si dhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë të Universitetit EPOKA (shtojca No. 6.15). Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë përbëhet nga 11 anëtarë (sipas Raportit Vjetor 2019 –</p>




	2020 të Universitetit EPOKA) ku 2 janë përfaqësues të studentëve dhe alumni, dhe 1 është ekspert i jashtëm. Në bazë të Statutit të Universitetit EPOKA Neni 35, në këtë komision institucioni përfshin aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë të këtij programi studimi.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në bazë të dokumentacionit të dorzuar në DVV dhe sipas RVB, struktura, funksionimi dhe detyrat e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe nën njësite të tij përcaktohen në Statutin e Universitetit EPOKA. Përveç këtyre organeve edhe departamenti është përgjegjës për mirëfunksionimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve përkatëse të studimit. Gjatë takimit me pedagogët, studentë dhe Përgjegjës të Departamentit të Administrim Biznesit, GVJ u informua se të gjithë pedagogët janë të angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtij programi studimi, duke përfshirë edhe mendimet, sugjerimet dhe nevojat e studentëve të tyre. Nga këto takime GVJ konstaton se ka një përfshirje aktive të anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ si dhe studentëve të këtij programi studimi për sigurimin e brendshëm të cilësisë.			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Megjithatë në RVB nuk ka ndonjë evidencë të qartë për përgjegjësitë dhe detyrat konkrete të individëve të tjerë (pedagogë, studentë) të angazhuar në sigurimin e cilësisë përveç atyre të organeve të përhershme të zgjedhura.			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë kanë respektuar integritetin akademik dhe kanë shmangur pabarazinë dhe diskriminimin. Kjo është reflektuar si në realizimin e pyetësorëve të studentëve i cili ruan anonimatit e tyre, apo të pedagogëve të cilat kanë qenë gjithmonë në përputhje me rregullat për ruajtjen e privatësisë dhe integritetit akademik.			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ është i mendimit se Universiteti EPOKA ka përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë bashkëpunorë dhe ekspertë të jashtëm si në mënyrë direkte edhe indirekte. Ashtu siç është përmendur më sipër në këtë standard, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë ka një anëtar ekspert të jashtë. Gjithshtu në mënyrë indirekte institucioni përdor ekspertizën dhe mendimet e kompanive që anketohen përmes pyetësorit që lidhet me reagimet e tyre për nivelin e njohurive dhe përshtatshmërinë e këtij aspekt studimi me nevojat e tregut. Një tjetër kontribut për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe përmirësimin e programit të studimit mund të konsiderojmë leksionet e hapura që institucioni organizon duke ftuar ekspertë të fushës së teknologjisë së informacionit, të cilët japin kontributin e tyre në këtë aspekt, projektet e përbashkëta apo marrëveshjet e bashkëpunimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton se të gjitha dokumentat në të cilat janë përshkruar politikat, strategjitë dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë program studimi, janë transparente dhe të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit në zyrat përkatëse të institucionit ose nëpërmjet faqes së web-it të universitetit. Këto dokumenta janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Statuti i Universitetit EPOKA</li> <li>• Dokumenti “Quality Assurance Handbook”</li> <li>• Dokumenti “Regulation on the Organization and Functioning of the Permanent Commission on Quality Assurance”</li> <li>• Dokumenti “Directive on Academic and Administrative Assessment and Quality Improvement”</li> <li>• Dokumenti “Policy on Continuous Improvement of Study Program”</li> <li>• Dokumenti “Quality Policy”</li> <li>• Dokumenti “Directive "On the Functioning of the Exam Board”</li> </ul> <p>Të gjitha këto dokumenta janë të aksesueshme në:</p> <p><a href="http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html">http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ konstaton se universiteti EPOKA ka bërë publike të gjitha rezultatet e vlerësimeve periodike që lidhen me vlerësimin e brendshëm apo të jashtëm. Të gjitha dokumentat dhe informacionet e publikuara respektojnë, lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Këto dokumenta gjenden lehtësisht në faqen e web-it të universitetit. Gjithashtu universiteti bën publike edhe të gjitha raportet vjetore në rang universiteti apo njësie bazë.</p> <p><a href="http://aeqi.EPOKA.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html">http://aeqi.EPOKA.edu.al/home-internal-evaluation-reports-1479-1480.html</a>  <a href="http://aeqi.EPOKA.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html">http://aeqi.EPOKA.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html</a>  <a href="http://aeqi.EPOKA.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html">http://aeqi.EPOKA.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html</a>  <a href="http://epoka.edu.al/mat/Bussines%20administration/Annual_Report_2018-2019_academic_year_BUS_department.pdf">http://epoka.edu.al/mat/Bussines%20administration/Annual_Report_2018-2019_academic_year_BUS_department.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Ashtu sikurse e kemi përmendur edhe në Standardin VI.2 të këtij raporti në RVB thuhet se rezultatet e vlerësimeve të realizuara në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë dokumentuar dhe janë paraqitur në Departamentet e Administrim Biznesit, Dekanat, Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Rektorat dhe në Senatit Akademik.</p> <p>Megjithatë GVJ nuk gjen asnjë dokument apo reference në RVB për raportet e sipërpërmendura. Referenca “Politika për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit në Shtojcën Nr. 6.3” që citohet në RVB ka të bëjë me strategjitë, politikat apo direktivat që lidhen me përmirësimin e performancës së programit të studimit. Ndërsa referenca “Plani i Veprimit në përgjigje të rekomandimeve nga ASCAL në Shtojcën Nr. 6.16” është e gabuar.</p> <p>Pas vizitës së GVJ në Institucion, ky i fundit dorëzoi dhe u ngarkuan në sistemin e ASCAL, dokumentat „Department Report on Course Instructor Evaluation Survey and Action Plan“ në Shtojcën 13 dhe „Action Plan in Response to the Recommendations of Accreditation Board” në Shtojcën 15, të cilat GVJ i merr në konsideratë. GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimeve të realizuara në kuadër</p>



	të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në Informatikë Ekonomike janë dokumentuar dhe janë paraqitur në Departamentet e Administrim Biznesit.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar tek RVB Senati Akademik i Unviersitetit EPOKA ka miratuar Direktivën "Për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë". Ai përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, planifikon, koordinon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë mësimore dhe kërkimore shkencore dhe vlerëson efektivitetin e tyre, si dhe vendos për problemet më të rëndësishme të institucionit në lidhje me mësimdhënien ose kërkimin shkencor. Propozimet për të ndryshuar kurrikulat i përcillen Senatit duke marrë parasysh parimin vertikal hierarkik: Departamenti – Fakulteti - Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulës - Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë - Senati Akademik. GVJ konstaton se institucioni ka marrë masa për të siguruar efektivitetin e procesit të përgjithshëm të sigurimit të cilësisë. Një tregues për këtë janë ndryshimet që kanë ndodhur në përmbajtjen e këtij programi studimi që janë gjithsej 11 ndryshime (Dokumenti Changes in the Curriculum, compared to accredited program Table 11), të cilat janë kryer përgjithësisht me një frymë të qartë përmirësimi dhe përditësimi të programit të studimit (mendim i shprehur edhe më sipër në këtë raport, Standardi II.3).			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton në bazë të dokumentit "Quality Assurance Handbook" si dhe mbështetur tek RVB se institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin e tyre dhe ndërgjegjësimin në lidhje me sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Këto seanca të informimit organizohen në fillim të vitit akademik nga Njësia e Brendëshme e Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotë përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Plotë përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Informatikë Ekonomike”, “Universiteti EPOKA”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi ofrohet në gjuhën angleze duke i sjellë kështu studentët më afër terminologjisë së fushës dhe sektorëve profesional përkatës të biznesit dhe teknologjisë së informacionit.
2. Stafit akademik ka në përbërjen e tij profesorë që kanë publikime të rëndësishme dhe të indeksuara në fushat përkatëse të studimeve.
3. Infrastruktura e ofruar (kampusi, laboratorët, sallat e mësimi) janë moderne dhe me facilitete për të garantuar një proces mësimnxënie efektiv, modern dhe afër risive më të fundit teknologjike.
4. Stimujt e ofruar për publikime dhe referate shkencore për personelin akademik e nxisin këtë të fundit të pasurojë sfondin kërkimor i cili është në funksion të aktivitetit të pasur akademik.
5. Organizimi i trajnimeve të shumta për stafin akademik në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, sidomos në kuadër të mësimdhënies online është një faktor që përmirëson cilësinë totale të mësimdhënies në Institucion.
6. Përdorimi i një sistemi elektronik të menaxhimit të informacionit (EIS), i cili është me module të integruar duke mundësuar komunikimin interaktiv midis studentëve dhe personelit të universitetit.

**Pika të dobta:**

1. Programeve lëndore (syllabuseve) ju mungonte detajimi i çështjeve dhe kapitujve të lëndëve në nën-çështje të veçanta përbërëse në përputhje me kërkesat e VKM 41 të ndryshuar. Gjithashtu literatura e përdorur në disa prej lëndëve të programit të studimit, nuk i përket pesë viteve të fundit.
2. Lëndët me zgjedhje të ofruara për studentët paraqiten me zgjedhje të kufizuara, duke mos përfshirë fusha të interesit të zhvillimit teknologjik të viteve të fundit.
3. Mungesa e një plani të detajuar për shtimin e titujve të bibliotekës sipas kërkesave të departamentit apo të programit të studimit.
4. Publikimi jo i plotë në gjuhën shqipe i të gjithë informacioneve në faqen e web-it të universitetit.
5. Mungesa e një sërë dokumentash mbështetëse dhe referuese në hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit të Brendshëm.

**Rekomandime:**

1. Pasurimi i programeve lëndore dhe më konkretisht i çështjeve dhe kapitujve me nënçështje, të lidhura edhe me faqet përkatëse në literaturën bazë të detyrueshme, në përputhje me kërkesat e VKM 41, shtojca 2. Përditësimi i literaturës në programet lëndore me tekste universitare të publikuara në pesë vitet e fundit.
2. Zgjerimi i gamës së lëndëve me zgjedhje duke përfshirë sa më shumë lëndë të fushës së biznesit dhe teknologjisë së informacionit me zhvillime të viteve më të fundit në këtë aspekt.
3. Hartimi i një plani të detajuar për shtimin e titujve të bibliotekës, sipas kërkesave të departamentit apo programit të studimit.
4. Publikimi i plotë i të gjithë informacioneve në gjuhën shqipe, në faqen e web-it të universitetit.

5. Të referohen dhe plotësohen me saktësi dokumentat mbështetëse të Raportit të Vetvlerësimit të Brendshëm.

### **Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in “Economic Informatics” of the “EPOKA” University**

#### **Strengths and affirmations:**

1. The Study Program “Bachelor in Business Informatics” is delivered in the English Language and therefore introduces to the students the concepts and terminology exactly as they are used in the respective professional sectors of Business and Information Technology.
2. Many professors from the academic staff who teach in this study program, have important and cited publications in scientific journals and conferences related to their relevant study fields.
3. The Campus Infrastructure (labs, clases, library, etc) are recently refurbished and equipped with the necessary facilities, fixtures and equipments to offer an effective and, technology-oriented learning and teaching process.
4. Incentives provided for qualitative scientific publications and presentations for the academic staff encourage them to expand their research background which in turn contributes to a higher quality teaching and academic activity.
5. The Institution organizes frequent and content diversified trainings for the academic staff in the framework of continuous improvement of the teaching process, recently having a special focus on the online teaching skills and capabilities, that increases the overall quality of the teaching process.
6. The use of a customized, fully integrated, module-based Learning Management System (e.g., Epoka Interactive System) facilitates an effective and streamlined communication process between staff and students throughout the entire learning process.

#### **Weaknesses:**

1. The contents of the syllabus of the courses offered in this Study Program were not fully detailed regarding the topics and the related sub-topics as required by the latest Decision of Council of Ministers, no 41. Also, the required literature in some of the courses of the Study Program “Bachelor in Business Informatics” is more than five years outdated.
2. The elective courses, even though many in number, in general do not seem to reflect the most recent changes and advances in the field of Information Technology and its impact in economics and business.
3. The lack of a detailed plan for adding recent textbooks and publications to the Library list, according to the requirements and needs of the department that delivers this study program.
4. The webpage of the Institution does not contain all the information in the Albanian Language.
5. Lack of several supporting and referring documents in the Internal Self-Evaluation Report.

#### **Recommendations:**

1. The contents of the syllabuses of this Study Program should be further detailed with the missing sub-topics (and the respective page numbers from the required literature) as required by the Anex 2 of the Decision of Council of Ministers, no 41. The literature in the syllabuses of several of the courses

of this Study Program should be updated to include academic textbooks published in the last five years.

2. The addition of some elective courses that would reflect the most recent changes and advances in the field of Information Technology and its impact in business activities.
3. The Institution should prepare a detailed plan to enhance the number of textbooks and publications in the Library according to the requirements and needs of the department and the study program.
4. The careful revision of the webpage of the Institution, to publish all the missing documents in the Albanian Language.
5. The revision of the referring and supporting documents in the Internal Self-Evaluation Report to enhance completeness and accuracy of the references.

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Asnjë përmbushjen	Përmbushjen pjesërisht	Përmbushjen kryesisht	Përmbushjen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

